

## LUAN RAMA

# Jam shkrimtar i apasionuar pas historisë

Bisedoi Andreas Dushi

### NJË LETËR NGA PIKTORI I MADH FATMIR HAXHIU

Nga Enver Kushi

(fq. 8)

### SHËNIME PËR LIBRAT

#### NJË PIETÀ SHQIPTARE

Rreth studimit "Pikëllim në një foto të vjetër" të Qerim Vrionit

Nga Alisa Velaj

(fq. 13)

Rrezatime kuptimore dhe estetike të "Mështeknajës..." së Lindita Ahmetit

Nga Ali Aliu

(fq. 10)

Libri i ri i Visar Zhitit

Të gjallët që jetojnë së brendshmi në "Dorëshkrimet e fshehta të burgut"

Nga Minella Aleks

(fq. 12)


Botim i ri nga Pika pa Sipërfaqe

"VITA NUOVA" NGA DANTE ALIGHIERI


Përgatiti dhe përktheu Arben Dedja

(fq. 4)

(fq. 2)



Skicë nga Bujar Kapllani



Bekim Fehmiu ishte seks simbol, ishte shqiptar, megjithëse aktor në gjuhë të huaja, ishte një shkrimtar që u përket të dy popujve

## AKTORI QË REFUZOI TË LUAJË PARA VRASËSVE

Nga MILJENKO JERGOVIÇ  
Gazeta kroate "Jutarnji List"

(fq. 6)

### BIBLIOTEKË

Ismail Kadare

(fq. 16)

*Dosja e Orfeut*

Muç Xhepa

(fq. 18)

*Fletorja misterioze*

Rexhep Ferri

(fq. 11)

*Sëmundja e zjarrit*

Artur Spanjoli

(fq. 17)

*Rrëfimet e një dashnori*

Erina Çoku

(fq. 17)

*Lufta për frymë*

Jeffrey Archer

(fq. 17)

*Letra*

### LETRAT E M. BULLGAKOVIT DREJTUAR STALINIT

Përgatiti dhe përktheu  
Agron Tufa

(fq. 19)

### VIOLINA E INGRESIT

Dr. Bledar Kurti



(fq. 22)

### PYETËSORI "LIBRAT E JETËS SIME"

#### NURIE EMRULLAI:

Libri që mendoj se është i nënvlerësuar? "Mosmarrëveshja" e Kadaresë - është vepër që duhet patjetër të lexohet

(fq. 11)

# LUAN RAMA

## Jam shkrimtar i apasionuar pas historisë

Bisedoi Andreas Dushi

*Zoti Rama, karriera juaj zë fill qysh në gjysmën e viteve '70 kur, si skenarist, punuat pranë kinostudios së atëhershme "Shqipëria e re". Si e kujtoni atë periudhë e, meqë edhe këto kohë është rihapur një debat mbi rolin dhe vlerën e filmave shqiptarë të para '90 i cili ngrihet mbi raportin mes aspektit estetik dhe atij propagandistik, cili është komenti juaj?*

- Kinostudio dhe teatri kanë qenë vatra krijuese ku artistët shqiptarë kanë mundur të shpalosin talentet e tyre. Skena dhe ekrani ishin mjediset ku arti shqiptar mund të shprehej në sintezën e vet: dramaturgjia, aktrimi, muzika, fotografia, piktura, etj. Ja pse edhe pse në një kohë totalitare me ulje-ngritjet e veta në Shqipëri u krijuan vepra që për nga vlerat artistike dhe realizmi i tyre do të mbeten në historinë e artit shqiptar. Askush nuk mund ta mohojë dhe ta fshijë këtë pasi do të bëhej e njëjta gjë siç ndodhi pas çlirimit kur u ndaluan vepra të autorëve nacionalistë. Thirrjet për ndalimin e filmave të realizuar para vitit 1990 më kujtojnë thirrjet dhe "gjuetinë e shtrigave" të makartistëve në Amerikë kundër regjisorëve, skenaristëve dhe aktorëve progresistë të Hollivudit apo "underground"-it. Në Amerikë, me kalimin e furisë makartiste, gjithçka erdhi në vendin e duhur. Shkolla e Lee Strasberg, etj. vazhdoi epopenë e madhe të teatrit dhe formimit të aktorëve. Sigurisht, filmi si art masiv, i mbështetur fuqimisht nga propaganda partiake vuajti shumë nga ideologjia. Tepër e vështirë në mos e pamundur të krijoje në liri. Ata që tentuan për pak liri u dënuan apo futën në burgje siç ishte rasti i regjisorëve Viktor Stratobërdha, Mitat Fagu, etj. Censura ishte krijuar si një skemë piramidale, çka e kam shpjeguar gjatë në librin tim të botuar e ribotuar në Francë "Udha e gjatë në tunelin e Platonit". Kontrollat mbi realizimin e një filmi ishin të njëpasnjëshme: ministria e Arsimit Kulturës, zyra e Propagandës së Komitetit Qëndror, shefi i Propagandës dhe së fundi lideri suprem. Çdo tentativë apo shkarje nga vija e Partisë censurohej, hiqej, goditej. Atëherë për të ekzistuar, krijuesi pranonte të bënte kompromisin, autocensurën, vendoste diku fotografinë e liderit, shtonte një komisar në një film të luftës, etj., për të shpëtuar veprën e

tij. Pa këto kompromise asgjë nuk do të arrihej. Tashmë filmat, pjesët teatrale, artet figurative të asaj kohe, shihen si dëshmi të kohës. Pa një film të tillë, brezat e ardhshëm nuk do arrijnë ta kuptojnë kohën totalitare. Pra filmat marrin një frymë dokumentare dhe bëhen të vlefshëm për të kuptuar njeriun por dhe absurditetin e vetë kohës. Ekspozita për artet e kohës totalitare organizohen ngado në Perëndim. Askush nuk ka frikë se mos infektohen të rinjtë. Letërsia dhe artet figurative por dhe kinematografia pas Revolucionit të Tetorit, me Ejzenshtainin, etj, pavarësisht propagandës, janë kontribute të vlerave artistike botërore.

*Kapërcyellin mes diktaturës dhe demokracisë, si e përjetuat? Mendoni se, po të mos kishin ndodhur ndryshimet e mëdha të '90 dhe liria t'i ishte servitur shqiptarëve*

*si diçka e panjohur, do të ishit marrë kaq shumë me letërsinë dhe të shkruarën në përgjithësi?*

- Fillimi i viteve '90, me ndryshimet politike në Shqipëri ishte një shpresë e madhe për letrarët dhe artistët e rinj. Sistemi politik kishte dështuar dhe lajmet e ndryshimeve në Lindje sollën zgjimin e madh. Të gjithë kërkonim më shumë liri të fjalës, udhëtimit, të njohjes së kulturave të tjera, pra të qenit europianë. S'kishte pse një libër të Orwell apo Kafkës e Solzhenicinit ta lexonim brenda një nate për ta përcjellë fshehurazi tek miqtë tanë. Ishim si ilegalë të kulturës. Sigurisht, kjo "ulje tensioni" erdhi si rezultat i politikave të mëdha midis Perëndimit të fuqishëm dhe Lindjes së rrënuar ekonomikisht. Në vitet '70 e më pas një gjë e tillë nuk mund të ndodhte. Shëmbujt e revoltave të




shtypura në gjak në Budapest dhe Pragë ishin të gjalla. Pra ndryshimet politike në fillimin e viteve '90 dhanë mundësinë që dogma të flakej dhe që e shkuara të shihej me një sy kritik.

*E njihnit frëngjishten që herët dhe, për rrjedhojë, lexonit në atë gjuhë. Prandaj kishit akses në disa materiale të cilët shumë njerëz s'i dekurtonin dot. Ndaj më ngacmon sinqerisht koncepti që gjatë diktaturës keni pasur për lirinë... Si mund ta shpjegoni?*

- Krijuesi, artisti, gjithnjë është ballafaquar me konceptin e lirisë çka Kadareja e ka shprehur qartë në librin e tij "Ftesë në studio". Në fakt, të gjitha përpjekjet artistike të bëra në emër të lirisë. Edhe kur ajo mungon, është liria e brendshme që e mundëson. Shkrimtari, artisti, filozofi, është i lirë edhe duke qenë në burg. Jusuf Vrioni më tregonte në Paris për lirinë e tij në burg. Ishte liria e ndërgjegjes, koha kur në vetminë e qelisë ai recitonte poezitë e Rembosë. Vilson Blloshmi ishte i lirë në vetvete kur përkthente natën vargjet e Bodlerit, për çka dhe do ta akuzonin. Poeti do të vritej. Big Brother ekzistonte vërtet por ai nuk mund të shikonte thellësinë e shpirtit. Unë shkoja shpesh në Bibliotekën Kombëtare, bibliotekën e kinostudios apo të Lidhjes së Shkrimtarëve. Përmes miqve, lexoja aty "Nouvelle revue Française", që drejtohej nga Louis Aragon, "Cahiers du cinema", "Bianco e Nero" etj, shikonim në arkivin e filmit filma të ndaluar të kohës së ekspresionizmit gjerman, romantizmit francez, neo-realizmit italian të viteve '50-'60, të "Nouvelle Vague" me autorët francezë gjatë viteve '60-'70, etj ku ndesheshim me ide të reja, siç ndodhi me filmin *Horishima mon amour* mbi pikëtakimin e tragjedisë së Hiroshimës me tragjedinë e Luftës së Dytë Botërore, ku dashuria e një vajze franceze me "armikun" e Francës, një ushtar gjerman ishte shkatërruese për fatin njerëzor. Kjo ishte për mua një lloj lirie. Por këtë nuk e kishin të mundur të gjithë. Shumica e kishte të pamundur të lexonte letërsinë disidente, të shihnin koleksionet e librave të mrekullueshëm me tablotë e Van Gogh, Modilianit, Pikasos, Shagallit, etj, për çka Maks Velo do të dënohej me burg.

*Jeta juaj, prej vitesh tanimë, është e ndarë mes Shqipërisë dhe Francës. Përveçse ambasador zyrtar për disa kohë, jeni edhe ambasador kulturor i Shqipërisë në Francë, prandaj, nga pozita ku gjendeni sot, si i gjykoni përkthyerjet kulturore mes këtyre dy shteteve?*



- Pikëtakimet kulturore mes Francës dhe Shqipërisë nuk kanë munguar. Ato kanë vazhdimësinë e tyre. "Pranvera Frankofone" në Tiranë është një festë e madhe e kulturës me ekspozita, koncerte me artistë francezë, me pikëtakime të autorëve shqiptarë e francezë. Po kështu mund të flasim për përkthimet e letërsisë së sotme franceze në gjuhën shqipe ku kemi mjaft autorë të zgjedhur e modernë. Po kështu, në Francë e veçanërisht në Paris, kemi artistë shqiptarë që jetojnë dhe krijojnë, instrumentistë si violinistë, pianistë, violonçelistë, artistë të skenës dhe ekranit, etj. Po kështu kemi shkrimtarë që botohen nga shtëpitë botuese franceze por ekzistenca e një qendre të madhe kulturore do të sillte manifestime më të mëdha në këtë drejtim. Kjo do kërkonte një mbështetje shtetërore. Po kështu botuesit shqiptarë, prej dy dekadash nuk janë të pranishëm në Panairin e Librit në Paris. Nuk kemi manifestime madhore siç do të ishin "Viti i Shqipërisë në Francë" (traditë e shumë shteteve që organizojnë në Francë), veprimtari këto polivalente në disa fusha të artit e kulturës. Këto kërkojnë financime dhe biznesi shqiptar nuk e ka atë patriotizëm që të shpenzojë për kulturën e vendit.

Përsa i përket jetës midis Shqipërisë dhe Francës, personalisht më ngjan si jeta e një mesazheri pasi një pjesë e madhe e krijimtarisë time është frymëzuar pikërisht nga kjo lidhje e pikëtakim kulturash e historish, pasi jo pak lidhje kanë ekzistuar historikisht midis Francës e Shqipërisë, veçanërisht që nga shekulli XVI kur stradiotët shqiptarë krijuan kalorësinë e lehtë franceze të quajtur nga historianët francezë "la chevalerie albanoise". Këto lidhje kanë spikatur në fillimet e shekullit XX me emigracionin shqiptar në vitet '20-'30, kohë kur në vendin tonë lindi përpjekja e "neoshqiptarizmit". Njoh krijues shqiptarë që edhe pse jetojnë diku në Perëndim ata vazhdojnë të jetojnë vetëm me botën e tyre shqiptare pa u përzjerë me botën ku kanë shkruar dhe pa treguar ndonjë interes për të, p.sh. për të përcjellë diçka nga kultura dhe letërsia e këtij vendi në Shqipëri, apo anasjelltas diçka personale në kulturën e tyre. Njoh të tjerë që jetojnë në një mjedis metisazhi kulturash që marrin e japin me njëra-tjetrën. Në këtë kuptim ata bëjnë një jetë më të pasur pasi bëhen mesazherë kulturash. Më pëlqen kjo e dyta. Është një zgjidhje personale që i përshtatet globalizmit të sotëm. Sot shoqëritë ballkanike po bëhen gjithnjë e më shumë kozmopolite. Kufijt e hapur janë një domosdoshmëri jetike.

*Pjesa e bibliotekës ku gjenden veprat tuaja përfshin thuajse të gjitha gjinitë. Pak më lart përmendëm essetë, por duhet të themi se keni botuar edhe dy romane, Santa Quaranta dhe Camera obscura – Origjina e botës. Gjithashtu, ka një mori librash të tjerë përkthyer prej jush nga frëngjishtja në shqip e anasjelltas. Ju, personalisht, në cilën gjini të të shkruarit ndiheni më mirë?*

Përveç këtyre dy romaneve kam botuar dhe romanin "Kohë pa kohë" (Tre romane në një), "Dalia", "Një mungesë e gjatë", apo "Dashuri e nëmur në Maligrad" e botuar në gjuhën maqedone, në Shkup. Është e vërtetë që kam shkruar në shumë gjini të ndryshme letrare. Pasioni i shkrimit si duket ka qenë më i fortë se idea për tu përqëndruar në një gjini të vetme Kam botuar tre vëllime poetike në shqip e frëngjisht e megjithatë i them vetes se poet është ai që jeton vetëm me poezinë. Ricos, Neruda, etj., ishin poetë



që jetuan vetëm me poezinë. Në fakt, dy vitet e fundit po botoj romane e tregime. Vlerësimet e disa kritikëve të huaj për librin "Epistolari i Zaratës" të botuar në anglisht, frëngjisht, italisht dhe së fundi në greqisht kanë bërë t'i drejtohem më shumë prozës, siç është së fundi dhe në librin me tregime "Dua të më bësh të bukur" apo librin e sapo përfunduar "Fëmija i Bulevardit Stalin", diçka autobiografike, meqë jam lindur, rritur, e martuar në Bulevardin Stalin, në zemër të kryeqytetit, mjedis që atëherë ishte një mikrokozmos i shoqërisë shqiptare të viteve '50-'80 me fitimtarë, të mundur e të dënuar arbitrarisht.

*Veprat tuaja kanë kryesisht një sfond historik, por përtej tyre ka edhe libra tërësisht historikë, botuar sidomos kohët e fundit, si Shqipëria në kohën e luftimeve bizantino-normande, Kalorësit e Stuhisë apo Bonjour d'Albanie. Po t'u duhej të bënit një kategorizim, do ta përfshinin veten të shkrimtarët apo të historiani?*

- Unë jam një shkrimtar që është i apasionuar pas historisë. Bota njeh shumë të tillë, emra që kanë hyrë në historinë e letërsisë botërore. Një nga përdoruesit ishte Stefan Zvjajg, pasioni i të cilit ndaj historisë e shtyu drejt personazheve të historisë botërore. Pikëtakimi në Paris me piktorin me origjinë shqiptare Abedin Dino dhe njohja me të, më ngacmoi të shkruaja librin "Dino – shtegtari i Portës Sublime". Për Jean Moreas apo

"Jani nga Morea", këtë poet arvanitas dhe themelues të simbolizmit francez u frymëzova pikërisht në Paris; udhëtimet e udhëtarëve franceze gjatë shekullit XIX më ngacmuan të shkruaja librin "Bujtës të largët". Nëse iu kushtova librit "Shqipëria në luftën normando-bizantine", kjo sepse duke lexuar 15 libra e kronistës bizantine për luftat e atit të saj, bazileusit të Konstantinopojës Aleksis I, përshkrimet e saj të betejave në Shqipëri ishin një zbulim i hatashëm për mua. "Paqja e Devollit" e nënshkruar në vitin 1115 në malet e Shqipërisë, ishte atëherë një nga ngjarjet më të mëdha të botës kur ndodhte armëpushimi mes dy fuqive më të mëdha të kohës. Një libër tjetër për historinë është "Konsullatat franceze në Shqipëri gjatë shekujve XVII-XIX", etj. Historia ofron shumë tema e personazhe të admirueshme për të shkruar, fate tragjike të hatashme. Do doja të shkruaja një roman për Merkur Bua Shpatën një nga stradiotët më të lavdishëm që spikati në historinë europiane gjatë shekullit XVI. Romani historik është i vështirë pasi kërkon një dokumentim të hollësishëm të kohës, atmosferës, afreskut historik, shoqëror e kulturor. Floberit, për të shkruar "Salambon", iu desh të studjonte për një kohë të gjatë në Bibliotekën Kombëtare të Parisit; po kështu do ndodhte me Zola për romanin e tij "Zherminal". Romanet e Aleksandër Dyma janë një pikëtakim mjaft i bukur mes historisë dhe letërsisë.


*Edhe në letërsinë për fëmijë, kontributi juaj është i çmuar, veçanërisht si autor i një serë librash të kolanës së botuar nga "Albas" "Më quajnë..." ku, në vetën e parë tregohet jeta Ismail Qemalit, Dora d'Istrias, Skënderbeut e deri te ajo e Aleksandër Moisiut. Sa e rëndësishme mendoni se është njohja e fëmijëve me personat kyç të historisë tonë?*

- Figurat historike paraqesin interes të veçantë për botën e fëmijëve. Përmes një gjuhe të thjeshtë ata mësojnë rreth historisë së popullit të tyre, një lloj biografie historike të Shqipërisë përmes personazheve më spikatëse. Kështu, letërsia ndihmon në aspektin e formimit identitar. Një gjeneratë e re pa një bagazh historik kombëtar është në një lloj udhëkryqi. Duhet gjithnjë të dimë se nga vijmë për të parë nga e ardhmja. E kaluara, veçanërisht për ne shqiptarët që u kemi rezistuar pushtimeve të shumta shekullore mbi dymijëvjeçarë, bëhet kështu frymëzuese për brezin e ri. Nëse kam shkruar edhe libra për mbretëreshën ilire Teuta, për Ismail Qemalin apo artistë si Tefta Tashko, Ibrahim Kodra, Eqrem Çabej etj, kjo që fëmijët të mbështeten në një traditë historike, pra të kenë një krenari historike për ti bërë ballë sfidave të kohëve moderne.

*Tanimë në rolin e përkthyesit, dua t'ju pyes se si e shihni: A është bërë mjaftueshëm për njohjen e kulturës dhe letërsisë shqipe në Francë?*

- Nëse në dekadat para vitit 1990 njohja e kulturës, e letërsisë dhe arteve tona ishte diçka e pamundur përveç letërsisë së Kadaresë dhe një lloj folklori, gjatë këtyre 30 vjetëve të fundit mund të them se duhej bërë më shumë. Përveç Kadaresë dhe tre-katër shkrimtarëve të tjerë, letërsia shqipe nuk është bërë e njohur. Ne kemi shkrimtarë shumë të mirë në Shqipëri por për tu përcjellë në Francë apo në një vend tjetër të madh perëndimor, rruga është tepër e vështirë. Shkrimtari i njohur dhe tepër origjinal Zija Çela vetëm sivjet arriti të botohej në frëngjisht dhe kjo falë ndihmës së Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit. Të tjerë, madje, shkrimtarë të rinj dhe mjaft të talentuar kanë mbetur vetëm në hapësirën e librit në shqip. Problem ka qenë dhe është mungesa e

(Vijon në faqen 5)



**JETA E RE  
E DANTE ALIGHIERI-T****I**

Në atë pjesë të librit të kujtesës sime para së cilës pakogjë u lexuakëshka, gjendet kaptina: *Incipit vita nuova*.<sup>3</sup> Nën këtë kryerresht gjë të shkruara fjalët të cilat kam për qëllim t'i kopjoj në këtë ble e, në mos të gjitha, së paku thelbin e tyre.

**II**

Nëntë<sup>4</sup> herë bash pas lindjes sime qielli i dritës me rrotullim të vet ish kthyer në të njëjtën pikë pothuaj, kur syve të mi u shfaq së pari vasha e lavdishme e mendjes sime, e cila prej të shumtëve u quajt Beatrice, edhe prej atyre që nuk e kuptonin pse ashtu quhej. Ndërkaq kish qenë ajo aq gjatë në këtë jetë, sa qielli i yjëzuar lëvizur kish kah lindja të dymbëdhjetën pjesë të gradës, pra ajo m'u shfaq pothuaj në fillim të motit të saj të nëntë dhe unë e pashë pothuaj në fund të së nëntit motit tim. Më erdh e veshur me më të fismen e ngjyrave, të përkorë dhe të duhur, me të kuqen alle, ngjeshur e qëndisur brezin siç ia kënda moshës së saj të njomë. Atyari, dhe them atë që është, shpirti jetësor, i cili banon në më të fshehtën dhomë të zemrës, aq fort filloi të fërgëllojë sa shihej ajo llahtari edhe në dejet më të imta; dhe duke u dridhur foli këto fjalë: *Ecce deus fortior me, qui veniens dominabitur michi*.<sup>5</sup> Atyari shpirti frymor, i cili banon në dhomën e lartë në të cilën tërë shpirtat shqisorë sjellin ndjesitë e tyre, fort u mrekullua e, duke i folur veçmas shpirtave pamorë, tha këto fjalë: *Apparuit iam beatitudo vestra*.<sup>6</sup> Atyari shpirti natyror, i cili banon në anën ku haja bluhet, zuri të qajë e tha mes lotësh këto fjalë: *Heu miser, quia frequenter impeditus ero deinceps*.<sup>7</sup> Mund të them se qysh atëherë Dashuria<sup>8</sup> fitoi fronin në zemrën time, e cila shpejt u bë besnike, dhe ai mbretëroi me aq siguri e madhësi falë forcës që i kallte përfytyrimi im, sa më mbetej veç t'i përmbushja kënaqësitë. Shpeshherë më urdhëronte të rreksha ta shoh këtë engjëllyshe; dhe unë në fëmijërinë time rëndom vajta ta kërkoj, dhe aq fisnike e hirplotë më ngjante në të sjella sa, padyshim, asaj i shkonin fjalët e Homerit: "Jo bijë njeriu, po bijë hyu qenka". Dhe ndonëse shëmbëllesha e saj, që pa prapë strukej meje, i falte Dashurisë guxim për të më sunduar, prapë kish veti aq të kulluara sa kurrë nuk la që Dashuria të më zotëronte pa këshillën besnike të arsyes për ato gjëra ku kjo këshillë do të ish dobipurëse. E meqë të zgjatesh për veprat e gjakimet e gjitha djalërie ngjakësh përrallje, po i lë ato mënjane; dhe, duke kapërcyer mjaft gjëra të cilat mund të nxirreshin nga gjedhja ku e

3 Fillon jeta e re.

4 Për numerologjinë e *Jetës së re* mund të shkruhet një kapitull i tërë. Gjithsesi, numri që përmendet më shpesh aty (njëzet e dy herë) është numri nëntë, me gjithë simbolizmin që ai mbart;  $9 = 3 \times 3$  ose  $3^2$ , dhe trashitë është pastaj numri i *Komedisë Hyjnore*.

5 "Ja një zot më i fortë se unë, që vjen të më sundojë".

6 "Pa u shfaq hirësia juaj".

7 "Ah qyqari, që tash e tutje do të më pengojnë!".

8 *Amore* (në italisht emër i gjinisë mashkullore) = *Dashuria* (në shqip emër i gjinisë femërore). Nuk është thjesht çështje gramatikore: tiparet dhe sjelljet e personazhit *Amore* janë tipike mashkullore. Fillon kështu, midis tekstit origjinal dhe shqipëruetit (me krye në hil), një tërhiq-e-mos-e-këput e gjatë dhe e ndërlikuar që, shpresoj, duke e lënë të hapur gamën gjinore të Dashurisë, t'i japë më shumë universalitet dhe modernitet tekstit shqip.

**VITA NUOVA**

## nga Dante Alighieri

Përgatiti dhe përktheu Arben Dedja

**Fjalë ftuese**

Viti 2021 është ai i shtatëqind vjetorit të vdekjes së Dante Alighieri-t (Ravenë, natën midis 13 dhe 14 shtatorit 1321), të parit gjeni që Italia i fali botës, në sërën e ndritur të atyre që aq na janë të afërt sa, tashmë, u mjafton vetëm emri i pagëzimit (Dante, Giotto, Leonardo, Michelangelo, Raffaello, Tiziano, Galileo...).

Thonë që njëherë e pyetën Borges-in (atë pyetje pak budalle e fëmijërore që s'lënë njeri të famshëm pa ia bërë) se cili ishte, sipas tij, libri – me kusht që të ish një dhe i vetëm – që nesër pasnesër duhej hedhur e shpëtuuar me një anije kozmike për t'i folur sa më mirë e bukur botëve të tjera për ne, njerëzorët dhe Borges-i, menjëherë e pa hezitim, u përgjigj që sipas tij ky libër duhet të ish *Komedia Hyjnore*, kjo poemë prej 14.233 vargjesh që, duke përmbledhur rrugëtimin fantastik, fantazmagorik e përtejtokësor të Poetit nga thellësitë e lemerisura të vesit e mëkatit deri lart te Krijuesi, rrëfen si asgjë tjetër thelbin tonë të vërtetë. Sigurisht, po të pyesnim një spanjoll do të së thotë që libri që duhet shpëtuuar është *Don Kishoti i Mançës*, rusi do të propozojë *Lufta dhe paqja*, gjermani *Faust-in*, anglezi veprën e Shekspir, francezi, ndoshta, *Të mjerët* e Hugo-it apo *Recherche...*-n e Proust-it; por puna është që në këtë lojë vetëm një libër mund të shpëtohet... dhe atëbotë *Komedia Hyjnore* duket vërtet e patëdytë.

Sot gjuha italiane është njëra nga gjuhët më të studiuara në botë, ndonëse, për numër folësish, nuk mund ta konsiderojmë gjuhë të madhe (nuk hyn te 20 gjuhët më të folura në botë; shqipja është përtej vendit të 100-të). Arsyeja kryesore pse ndodh kështu, do të thosha, është prestigji i letërsisë së saj, aradheja është e gjatë, por prijësi është padyshim zotëria që po përmendim.

E pra, përveç *Komedisë Hyjnore*, kësaj kryevepre (edhe kaq, është pak ta quash), ndërkaq të përkthyer gjerësisht në shqip nga duar mjeshtrash, Dantja na ka lënë edhe libra të tjerë, si traktatet *Convivio* (në gjuhë vulgare, në italisht, pra), *De vulgari eloquentia* (në latinisht, por që trajton probleme të italishtes) – të dyja shkruar aty midis viteve 1303 dhe 1304-1307 dhe lënë pa u kryer, sepse pikërisht atëherë e gjer në vdekje Poeti iu përkushtua *Komedisë*, si edhe një traktat tjetër, *De monarchia* (në latinisht, ky i përfunduar), i padatur siç duhet pse studiuesit janë në mospajtim të plotë, që merret me natyrën e monarkisë si formë qeverisëse dhe me marrëdhëniet mes dy pushteteve absolute të kohës: Perandorisë dhe Papatit.

Por kryevepra tjetër e vërtetë e Dantes është libërthi rinor *Vita nuova* (1292-1293 ose 1294), shkruar pa i mbushur të tridhjetat, ku ai përmbledh vargjet për Beatrice (Biçe<sup>1</sup>) Portinari-n, duke i shoqëruar ato me rrëfimin (në prozë) të rrethanave që e kishin frymëzuar (dhe raporti poezi-prozë është krejt në ekuilibër: kemi të bëjmë me një zhanër të

1 Besoj në Firence e thërrisnin të gjithë Biçe, se është e njohur mania e florentinëve për t'i shkurtuar emrat. Edhe vetë emri Dante nuk është tjetër pos një kontraksion i "Durante".

rrallë e të vështirë letrar, që quhet *prozimetër*). Rrëfimi është autobiografik, është kronika e një dashurie, rilexim kritik i vargjeve djaloshare për të vluarën e zemrës.

Beatrice vdiq, njëzetepesëvjeçare, më 8 qershor 1290 (sipas kalendarit julian) dhe Dantes iu desh një jetë e tërë për ta mundur dhimbjen, për ta përpunuar zinë. Ngjarjet që tregohen në libër janë thuar inekzistente. Fëmijë nëntëvjeçar, Dantja sheh për herë të parë Beatricen, disa muaj më të vogël se ai, dhe dashurohet, me një dashuri fëmijërore, platonike. Nëntë vite kalojnë përpara se të shihen përsëri, rastësisht, në rrugë: Dantja – një adoleshent i paqetë, Beatriceja – tashmë grua e martuar (me kalorësin Simone de' Bardi). Një çast e vështrimet u kryqëzohen dhe... Beatriceja e përshëndet. Ia dëgjonte zërin për herë të parë. Kaq! E sheh pastaj në kishë, vjedhurisht; në një dasmë; shkon në vakinë e vdekjes së të atit të saj, Folco Portinari, po s'që punë se, në ceremonitë mortore të Firences së asaj kohe, gratë dhe burrat qëndronin të ndarë. Tregon edhe do gjëra të tjera, me fjalë të gjata, të ndërvarura, sa mendimi qëndron gjithmonë pezull mes kuptimit e moskuptimit, me një lojë numrash, i ndërthur të gjitha këto me vargje që u fijejon idetë duke kumtuar, ashtu shkarazi, poemën e madhe që do të shkruajë – lumturinë e dhjetëra brezave të botës që pasoi. Rrëfimi, ama, bëhet simbolik tek mbushet me vasha, gjithandë me vasha (ç'melhem për shpirtin tonë në këtë kohë talebanësh!), ca syresh të ashtuquajturat vasha-shqyt, si pasqyra gati për t'u copëtuuar, me ëndrra e fantazmagori, me shqisa e organe shqisorë në trazim, me vegime e imazhe të idealizuara, sipas mënyrës së stilnovistëve.<sup>2</sup> I nisur gjithnjë nga realiteti Dantja shpall të vërtetën intelektuale ku ka mbërritur: *Dashurinë*, që, nga përvojë personale, lartohet në vegël përsosmërie morale. Ne, post-romantikëve, ndoshta na vjen çudi që ai rreket t'ia fashitë mujtë e ta nxitë Dashurinë gjithnjë të arsyetë, por nuk duhet harruar që kemi të bëjmë me njerëz të një kohe tjetër.

*Jeta e re* është e ndarë në dyzet e dy kaptina, me tridhjetë e një poezi (njëzet e tri tingëllima, dy tingëllima të dyfishta, një baladë, një *stanza* – fragment i një *canzone*-je –, një *stanza* e dyfishtë – fragment nga një tjetër *canzone* – dhe tre *canzoni*). Poezitë janë përzgjedhur për t'u bërë pjesë e libërthit nga buqeta e begatë e poezive të tij rinore; po mjaft syresh Dantja i la jashtë (ato u përmblodhën pas vdekjes në vëllimin *Rime* – pesëdhjetë e katër poezi, kryesisht tingëllima, + njëzet e gjashtë të tjera, që sot jepen si me autorësi të dyshimtë).

Pra më në fund, i nxitur edhe nga ky përvjetor, i flaka skrupujt dhe po e sjell në shqip këtë *Jetë të re*. Sprovat e para i pata bërë qysh nga mesi i viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, por gjithkush ka kalvarin e vet (të gjatë, tejet të gjatë) dhe e di që të gjesh kohë sot e gjithë ditën për t'i zbratur nga supet gurët e përditshmërisë e të ngjitesh lart për të thëthitur pak ajër alpin, duhet të jesh ca i marrë.

Padovë, *Dantedi e Dytë* (2021)

[ad]

2 Kam shkruar për ta në parathënien dhe shënimet që shoqërojnë poezinë e shqipëruar të Calvalvanti-t (Guido Cavalcanti, *Poezia*, Tiranë 2007, Ombra GVG).

marrin trajtën, po kthehem te fjalët që në kujtesën time janë shkruar nën kryerradhe më të vlëra.

**III**

Pasi shumë ditë kaluan, sa plot nëntë vite u mbushën nga e shfaqura që përshkrova e fisnikmadhes, ndodhi që shi të fundmen e këtyre ditëve kjo vashë e mahnitshme m'u rishfaq, veshur krejt të

bardha mes dy fisnikesh pak më të rritura dhe, duke kaluar nëpër aksh rrugë, i ktheu sytë te vendi ku rrija zemërfiraksur dhe me atë njerëzi të pashprehshme për të cilën sot është shpërblyer në jetën e amshuar,<sup>9</sup> më përshëndeti aq mrekullisht, sa m'u bë atëbotë se ia pashë lumturisë sinorët. Ishte sak ora e nëntë e ditës kur ajo përshëndetja e dashur më mbërriti; dhe ngaqë qe hera e parë që fjalët e saj

9 Dantja e thotë që në krye të herës që Beatriceja ka vdekur.

fluturuan meje, aq u dalldisa sa si i pirë u ikja njerëzve dhe, duke iu drejtuar qoshkut vetmitar të dhomës sime, zura të mendoj atë mirësi. E për të duke menduar një gjumë qengjash ia behu, ku m'u shfaq një vegim-çudi: m'u bë se pashë një re ngjyrë zjarri në dhomën time e, mbështjellë në të, dalloja një bujar, të frikshëm për kë e shihte; por me hare në vetvete, që ish aq i mrekullueshëm; e që foli e më tha shumë gjëra, ndonëse pakogjë kuptoja

sosh, e mes tyre: *Ego dominus tuus*.<sup>10</sup> Më ngjante t'i shihja në krahë njëzë që culle flinte, lehtaz e mbështjellë me një shpërgë ngjyrë alle; të cilën, me shumë vëmendje tek e vështroja, njoha vashën e të përshëndeturit, që një ditë më parë begenisi e më përshëndeti. E në njërin dorë më ngjau që mbakësh diçka të flakëruar dhe m'u duk sikur më thosh këto fjalë: *Vide cor tuum*.<sup>11</sup> Dhe si rrodhi do kohë, m'u bë se e zgjoi atë që flinte dhe e detyroi me çmos të hante nga gjëja që në dorë i shkrumbohej; që ajo e hëngri ngurafët. Pak më pas hareja ia la vendin një vaji farmak dhe, duke qarë kësisoj, i mbështolli ai krahët përreth vashës së tij; dhe së toku ngjanin të ngjiteshin kah qielli. Mbiatù gjumi im fërfëllak nuk e mbajti dot ngashërimin që më kaploi; u tret dhe... u zgjova. Zura të vramend fill dhe zbulova që ora kur ai vegim m'u shfaq qe e katërta e natës, pra tamam e para e nëntë orëve të fundit të natës. Duke menduar për çka pashë, vendosa t'ua bëj këtë me dije më të ndriturve vjershetarë të kohës dhe, meqë tash së voni edhe unë e kisha nxënë artin e të thururit fjalë e vargje, thashë të krijoj një tingëllimë për të përshëndetur tërë besnikët e Dashurisë; dhe duke i lutur të ma shpjegojnë vegimin, u shkrova për ç'kisha parë në gjumë. Dhe ia nisa atëbotë kësaj tingëllime që fillon me: Çdo shpirti-pre.

Çdo shpirti-pre e zemre dhënë hijeshisë që vargjet e tanishme ia përcjell në pritje të shkoqitjes, prapë i sjell rixha prej zotës së tyre, Dashurisë.

Gati një tretë e orëve u bitis e kohës që një yll shkëndrit në qiell, kur m'u shfaq Dashuria, meje sjellë, q' thelbin kur ja ndërmond më lemeris.

<sup>10</sup> "Unë jam ytzot".  
<sup>11</sup> "Shihe zemrën tënde".

Gazplotë më ngjante Dashuria, marrë zemrën time në dorë e kish në krahë vashën përgjumur në shpërgë kuq larë.

Enkas e zgjonte e prej zemrës zjarr frikësore përkorshëm i jep të ha e pastaj davaritej duke qarë.

Kjo tingëllimë ndahet në dy pjesë; ku në të parën përshëndes e pres përgjigje, në të dytën shpreh cili është ai/ajo për të cilën duhet të më përgjigjen. Pjesa e dytë fillon kështu: *Gati një tretë*.

Shumë ia kthyen kësaj tingëllime e në mënyrë të larmishme; e ndër të tjerë edhe ai që e quaj mikun tim për kokë, që thuri një tingëllimë që ia fillonte: *Do e shihnit, sipas meje, çdo vetijëz*.<sup>12</sup> Ky shkëmbim qe guri i miqësisë tonë, kur ai mësoi që isha unë që ia dërgova asodore. Asnjëri nuk dha dot atëherë për ëndrrën një gjykim të njëmendët, tani fare i qartë edhe për më syleshin.

<sup>12</sup> Ky mik (për kokë) është Guido Cavalcanti; dhe ja tingëllima:


Do e shihnit, sipas meje, çdo vetijëz e gazin e të mirën që vlon thellë, sikur ta njihnit zotën e këndellë që botën e përndershme qeveris,

e rron pastaj shi ku vjen fundi i zisë, duke gjykuar në t'mendjes kështjellë; xheç shkelur ëndrrash që gjindjen mbështjell dhe pa dhimbje zemërat mbodhis.

Ty zemrën ta rrëmbu, duke parë që vasha vdekur të desh ty pa pra: dhe atë konte me zemrën me llahtarë.

Kur e pe ti të ikte rrënimtar, gjumi i ëmbël u këput u vra, i mundur nga i tiji kundërshtar.

Vini re që rimat janë njëloj me ato të tingëllimës së Dantes. Ndodhte rëndom në poezinë e korrespondencës të stilnovistëve.




(Vijon nga faqja 3)

përkthyesve nga shqipja në frëngjisht. Francezë që njohin mirë shqipen janë të pakët. Lumturisht kemi Tupen, por kjo nuk mjafton Shpresoj në një mbështetje më të madhe të shtetit për përkthimet, pasi botuesit e huaj që të përzgjedhin, duhet ti lexojnë dhe që ti lexojnë më parë duhen përkthyer. Pa patur sigurinë e botimit, përkthyesit nuk angazhohen.

*Jeta mes dy kulturave e dy gjuhëve, ku njëra është shumë më e madhe se tjetra, si ka ndikuar në krijimin e identitetit tuaj artistik?*



- Mendoj se po të isha në Shqipëri do kisha një identitet tjetër, ndryshe nga i sotmi. Njeriu, identiteti, është një proces në krijim të vazhdueshëm ku rolin primar e kanë origjina, gjuha, kultura, përjetimi shoqëror. Tridhjetë vjet në Francë nuk janë pak, prandaj dhe krijimet e mia, përveç kinematografisë, u zhvilluan në Paris. Dhe kjo si pasojë e ballafaqimit me një kulturë tjetër, mjaftë të pasur e cila krijon shije e koncepte të reja, bëhet shkollë dhe vitet janë si shkollë ku ti ngjitesh gjithnjë. Në Shqipërinë ateiste nuk e njihja Biblën. Themelet e kristianizmit i gjeta në letërsinë dhe artet, në veprat e artistëve të mëdhenj të botës nga Da Vinçi e Mikelanxhelo tek Wermeer, Brughel, Delacroix, Goya, Van Gogh, Degas etj, veprat e të cilëve i kam parë drejtpërdrejt në muzeumet e Francës, Italisë, Belgjikës, Hollandës e Spanjës. Rrymat dhe shkollat artistike si impresionizmi, post-impresionizmi e më pas kubizmi, surealizmi, dadaizmi etj., i kam parë në Luvër apo në muzeun e Orsejës. Dhe ky ballafaqim vlen për të gjitha format e krijimit artistik. Por ajo që krijon identitetin artistik të një krijuesi është vetë procesi krijues Aty ndihet Fjala, fryma e tij. Aty e kupton se ç'përfaqëson ai dhe sa nacional dhe origjinal është. Mitrush Kuteli p.sh. u ballafaqua me kulturën perëndimore, por individualiteti i tij është thellësisht shqiptar, siç ndodhi dhe me Shagall e të tjerë. "Bëma e mëkatit" ka një frymë floberiane (Tre tregimet, etj) çka mund ta përcaktojmë si Floberi shqiptar. Mësimi i teknikave, stileve, formave, padyshim na ndihmon. Unë jam shumë i ndjeshëm ndaj letërsisë së Marguerite Duras por asnjëherë s'kam mundur të shkruaj si ajo. Pra këtu jami në një gjendje frymëzuese të vazhdueshme, pasi kontaktet me letërsinë dhe artet janë të përditëshme, dinamike, ku gjithnjë mëson diçka të re. Çdo ditë është një zbulim i ri por i një niveli të lartë,



pasi në Francë kanë krijuar dhe krijojnë shkrimtarë e artistë nga e gjithë bota. Jo më kot Franca ishte dikur metropoli i kulturës botërore, ndërkohë që sot kemi disa metropole të kulturës. Pra erudicioni, përfitimi i një kulture, është një plus për një shkrimtar ngado që vjen. Përse e pëlqejmë Borghes? Sepse erudicioni i tij gjatë leximit na hap shumë dritare. Lexuesi ka nevojë për dritaret e dijes.

*Ndërkohë, në nëntor është botuar, nën kujdesin tuaj, albumi me veprat e piktorit të njohur Omer Kaleshi. Si ishte për ju kjo punë dhe, duke qenë se nëpërmjet jush mund të marrim informacion, si është sot Omer Kaleshi?*


- Libri voluminoz "Omer Kaleshi nga A në Zh" është një lloj konkluzioni mbi jetën dhe veprën e këtij piktori me origjinë shqiptare dhe mjaft të lidhur me Shqipërinë. Një libër i formatit të madh botuar falë mbështetjes së ALBAS në Tiranë. Për të kam botuar disa libra në shqip dhe frëngjisht dhe në mesin e këtij viti edhe librin "Omer - fruta dhe erotike" mbi tablotë e tij "nature morte". Një hemorragji cerebrale e goditi fort vitin e kaluar dhe isha unë që e gjeta në atelier pas dy ditë e gjysmë të shtrirë. Që atëherë ai vazhdon të jetë në një klinikë mjekësore. Kjo goditje e ka shkëputur nga krijimtaria por sa herë që shkoj ai më flet veç për pikturën dhe ekspozitat që do të hapë. "Një piktor që nuk pikturon është i vdekur" më thotë. Dhe ja pse kërkon të ngrihet sa më parë për të shkruar pranë kavaletit të tij. Të shpresojmë!...



# AKTORI QË REFUZOI TË LUAJË PARA VRASËSVE

NGA MILJENKO JERGOVIÇ

marrë nga gazeta kroate "Jutarnji List"  
Përktheu nga origjinali Xhelal Fejza



**B**ekim Fehmiu ishte seks simbol, ishte shqiptar, megjithëse aktor në gjuhë të huaja, ishte një shkrimtar që u përket të dy popujve.

Libri "Shkëlqim dhe tmerr" një ditë ka për të qenë shumë i rëndësishëm dhe i famshëm, ndërsa kultura dhe letërsia serbe kanë për t'u mburrur me faktin që në periudhën e tmerrit të saj, një shqiptar shkroi një vepër shëlbyese. Atëbotë Serbia do të jetë krenare me Bekimin.

Në vitin 2001, në galerinë e arteve Velkoviç në rrugën Birçaninova në Beograd, takova Brankën dhe Bekimin. Ajo: aktore e madhe teatri, zonjë fine dhe delikate beogradase, në fytyrën e së cilës atë mbrëmje nuk shiheshin gjurmë të kohëve të vështira dhe rrethanave të pakëndshme në të cilat gjendej. Ai: prej më shumë se një dhjetëvjeçari jashtë vëmendjes së publikut, për protestë, me një fytyrë e cila dukej ndryshe nga ajo të cilën kemi njohur nëpërmjet filmave. Ishte mplakur bukur, por ndërkohë fytyra e një seks simboli të filmit

jugosllav dhe european ishte shndëruar në një fytyrë asketi. Sikur Ahmed Nuredini<sup>1</sup> të kishte arritur të plakej, apo më mirë të themi sikur Mesha Selimoviçi ta kishte plakur personazhin e tij, në film ishte shumë i përshtatshëm për ta luajtur Bekim Fehmiu. Por me siguri që nuk do ta luante, sepse Bekimi kishte vendosur, pikësëpari për protestë për shkak të raportit ndaj shqiptarëve në Beograd dhe Serbi, dhe pastaj edhe për shumë gjëra të tjera të këtij lloji, që të mos aktojë më. Njëherë, shumë vite më vonë, e pata pyetur për këtë dhe ai, në mënyrë të argumentuar dhe të qetë, më shpjegoi se aktrimi për të është lojë, vërtetë lojë shumë serioze, por ama ai nuk mund të luajë më pas atyre gjërave të tmerrshme që ndodhën. Foli lehtë dhe bukur, sikur dinte të fliste ai, sikur çdo herë ishte duke mësuar këtë gjuhën tonë, e cila për të ishte gjuhë e huaj. Çdo fjalë e trajtonte me shumë kujdes, sikur fjala të ishte njeri. Fliste

<sup>1</sup> Ahmed Nuredini është personazhi kryesor i romanit "Dervishi dhe vdekja" të autorit boshnjak Mesha (Mehmed) Selimoviç (shën. i përkth.)

me një zë të bukur, zë të cilin e ke që nga lindja, por në njëfarë kuptimi edhe duhet ta meritosh. Nuk e kishte atë ngashnjimin prej aktori, i cili gjithësesi është simpatik. Ishte njeri dukshëm dinjitoz, vetëm se nuk ishte ai dinjiteti i atyre serive nga filmat anglezë, apo atyre pamjeve të akullta të jetës qytetare sipas Bergmanit. Dinjiteti i tij ishte i përbërë nga ngrohtësia dhe pranimi.

Me sinqeritet, por ama vetëm një herë, i thashë se sa shumë kishte patur rëndësi për mua kur kam qenë fëmijë. Nuk desha të dukesh si ndonjë adoleshent i cili sapo ka njohur një njeri të famshëm të cilin e ka patur gjithmonë para syve në pllakatin e ngjitur në murin e dhomës së fëmijërisë së tij. Iu bë qejfi kur i thashë se gjyshja ime nuk mund ta shihte atë skenën filmike kur *Beli Bora* (*Beli Bora - Bora i bardhë, personazhi kryesor i filimit "Skupljaçi perja"* - "Mbledhësit e puplave", i luajtur nga Bekimi. Ky film fitoi "Palmën e Artë" në Festivalin e filmit në Kanë në vitin 1967 dhe në vitin 1968 u nominua për çmimin "Oskar". shën. i përkth.) thyen gotën përgjysëm dhe pastaj, nga derti, dridhet sipër copave të qelqit. Disa gjëra në atë film duken shumë më reale se sa mund jenë në jetë.

Bekim Fehmiu e fliste gjuhën serbe si dhe gjuhët e tjera ashtu sikurse i flasim ne. Por do të ishte gabim të thuhej se e tradhëtonte shqiptimi, sepse shqiptimi i tij ishte kurdoherë i saktë. Por intonacioni i tij ishte tjetër, tjetër ishte edhe ritmi i fjalëve të tij. *Staccato*-ja e frazave të tij të shprehura në gjuhën kroate, serbe, malazeze apo boshnjake ka hyrë në kujtesën kulturore të një vendi dhe një kohe. Kështu fliste Bekimi dhe është gabim të mendohet se kjo është kështu sepse gjuhët e mësipërme nuk ishin gjuha e tij amtare. Në mënyrën e të folurit të Bekimit ishte trupëzuar personaliteti i tij, ai prej aktori dhe ai vetjak, kështu që e tërë një epokë, më e madhja dhe më e rëndësishmja nga të gjitha epokat në historinë e njerzimit, epoka e fëmijërisë dhe adoleshencës tonë, nuk do ta kishte atë harmoninë e saj sikur Bekim Fehmiu të mos fliste bash ashtu.

Në filmin "Edukimi special" të rregjizorit Goran Markoviç, ai luante rolin e edukatorit Munixhaba. Po, e di është mbiemër qesharak, kështu shprehet aktori në një nga replikat e para të filmit. Në këtë film luante rolin e një njeriu të çuditshëm, të fuqishëm

dhe në vetvete të ngritur, prandaj nuk është e çuditshme që nekrologët, kur shkruanin për Bekimin, përmendën kaq shumë pikërisht "Edukimin special". Në rastin e tij ishte një film sikurse ndodh edhe me të gjithë aktorët tjerë gjatë karrierave të tyre dhe kjo merret vesh vetëm kur karriera e tyre është pikërisht në fund, në kohën kur mblidhen dhe bëhen përshendetjet e fundit. Filmin testament disa e xhiruan në fund të karrierës disa të tjerë në fillim, ndërsa Bekim Fehmiu e xhirooi diku në mes.

Në vitin 2001, u ktheva në Zagreb me pjesën e parë të prozës së tij biografike "Shkëlqim dhe tmerr". Fillova ta lexoj në tren dhe e lexova me ngadalë për tri netë rresht. Megjithëse në shtypin e Beogradit u shkrua me respekt për këtë libër, dhe mjaft bukur u shkrua dy a tri herë edhe në Zagreb, madhështia dhe intensiteti i tij i brendshëm mbetën jashtë diskutimit publik, për ndonjë kohë të ardhme ndoshta, kohë në të cilën do të jetë e mundur të lexohet

**Bekim Fehmiu ishte seks simbol, ishte shqiptar, megjithëse aktor në gjuhë të huaja, ishte një shkrimtar që u përket të dy popujve. Libri "Shkëlqim dhe tmerr" një ditë ka për të qenë shumë i rëndësishëm dhe i famshëm, ndërsa kultura dhe letërsia serbe kanë për t'u mburrur me faktin që në periudhën e tmerrit të saj, një shqiptar shkroi një vepër shëlbyese. Atëbotë Serbia do të jetë krenare me Bekimin.**



më me shumë qetësi dhe durim. Duket sikur ia njohën rëndësinë dhe prandaj e kanë vendosur në raftin e librave për ta lexuar më vonë.

Bekim Fehmiu rrëfen për jetën e tij që fëmijë, qëkur lindi në një familje shqiptare nga Kosova në gjendje të mirë ekonomike, në vitet e Luftës së Dytë Botërore. Ngadalë, fjalë pas fjale, figurë pas figure, ai stis një mozaik i cili e befason lexuesin para së gjithash me shkallën e lartë të stilizimit. Megjithëse në këtë stilizim nuk ka asnjë që mund të jetë e sëmurë në mënyrën e Marsel Prustit, kjo prozë, për nga finesa dhe ndjeshmëria, por edhe për ambientet e zotërrillëqeve të kohëve të vjetra, është njëfarë rendje kosovare pas kohëve të humbura. Por, përveç që libri "Shkëlqim dhe tmerr", mund të lexohet si një roman i madh për rritjen e një njeriu, e cila ndodh kudo, në cilinëdo pjesë të njohur apo të panjohur të botës, bëhet fjalë për një libër nga i cili lexuesi jugosllav, e në veçanti ai serb, për shqiptarët dhe jetën familjare në Kosovë, merr informacion më shumë se sa ka marrë gjatë nëntëdhjetë viteve të kaluara, vite në të cilat kanë jetuar në të njëjtin shtet dhe ku kanë patur mundësi të lexojnë nëpër gazeta, revista apo libra të botuar në gjuhët tona. Dhe të gjitha këto me vetëdije mbi dinjitetin, si të njeriut ashtu edhe të tekstit letrar. Sepse kjo për Bekimin ishte i njëjti moralitet, sepse ai thjesht nuk mund të kishte dy morale. Prandaj edhe e pati aq të vështirë.

Rrëfimi përfundon në kohën para se personazhi kryesor të bëhet aktor. E pyeta nëse do ta vazhdojë. Oh, po, sigurisht! Dhe sa herë që i takoj, atë dhe Brankën, ose vetëm Brankën, sepse atë pa Brankën nuk e pashë kurrë, gjë e cila është për mua shenjë e një dashurie të lartë, i pyesja sepse më interesonte, por edhe se nga ana tjetër e dija se për shkrimtarin ka shumë rëndësi kur i bëhen pyetje të



Me bashkëshorten, Branka Petriq

tilla. Duhej të ishte shenjë e respektit tim ndaj shkrimtarit tek Bekimi. Me të vërtetë shkrimtar i madh.

Duke vendosur të mos luajë më, Bekim Fehmiu e dënoi veten me vetmi. Botët dhe identitetet që lindën rreth tij në kohën e luftës dhe pas saj nuk ishin më të tijat. Jetoj në dashuri dhe vetmi. Kush e mer vesh se kur dhe cila nga këto të dyja është më e madhja. Problemet e mia me mospërkatësinë dhe së bashku me këtë edhe identitetin tim, shumë herë më pak dramatik se i

tij, dhe rolin moral, i cili në krahasim me të të tijin është i parëndësishëm, të cilët më shpinin pikërisht tek njëshi dhe vetmia, shpesh i kam zgjidhur duke patur në mendje Bekimin. Nuk duhen kritikuar ata të cilat vazhdojnë të luajnë pavarësisht nga rrethanat, por ama për njeriun ka rëndësi jetësore kur është në gjendje të mrekullohet me aktorin që e refuzoi një gjë të tillë.

Ditët e para të pranverës së vitit 2009 në adresën time elektronike erdhi një mesazh nga Branka dhe Bekimi ku

bashkëngjitur më dërgonin dorëshkrimin e pjesës së dytë të librit "Shkëlqim dhe tmerr". Më luteshin ta lexoja, ti ndihmoj në lidhje me një dyshim të natyrës private, dhe tu them sinqerisht se çfarë mendoj për tekstin. Librin e printova dhe e lexova shumë shpejt, por mu deshën dy muaj që tu kthej përgjigje. Një histori e madhe, krejt ndryshe nga e para, por gjithsesi e shkëlqyer dhe e tmerrshme u derdh tek unë, dhe prandaj u shkruajta se duhej ta publikonin sa më shpejt. Ishte i lumtur. Shkrimtari i vërtetë, për fat të keq, kurrë nuk e di se ka shkruar një libër të bukur, prandaj edhe duhet që dikush t'ia thotë këtë.

Në fund të romanit përshkruan se si filloi lufta: "Parambrëmje. Qielli është ngjyrë portokalli gri. Kisha në Graçanicë. Njerëzit hyjnë e dalin nga ajo në kolonë. Puthin ikonat. Në kupolën e kishës fluturojnë sorrat e zeza. Sipër tyre, një tufë tjetër sorrash, duke fluturuar dhe krakaritur, vinë përqark, bëjnë që qielli të duket edhe më i zi. Në horizont një brazdë e kuqe e përgjakur ndan tokën nga horizonti. Krakarritja e sorrave mbi Graçanicë është mbytëse.

Natë. Qëndroj në tarracën e gjërë të shtëpisë së Dijes. Asnjë gjeth nuk lëviz. Atje poshtë, tek bahçja e Taukut, pesë pjestarë të njëjësive speciale. Shoh vetëm gacat e cigareve të tyre që ndriçojnë kur thithin tymin. Nga larg vjen një aromë squfuri. Fabrika e azotit. Mbi qytet shtrihet një heshtje e rëndë dhe e çuditshme! Shkëlqimi u shurdhërua!"

Ka diçka hyjnore e cila një ditë do të merret vesh, e unë e di shumë mirë se ka për tu marrë vesh, sepse ndryshe nuk ka si të jetë, se dy librat më të mëdhenj shëlbyes të letërsisë serbe të fillimit të këtij shekulli i ka shkruar pikërisht një shqiptar.

Bekim Fehmiu vdiq me dëshirën e tij. Dëshira e tij ishte shumë më e fortë se sa kjo botë. Dhe ne përsëri duhet ta respektojmë këtë dëshirë të bekimit. E gjithë vetmia e tij u derdh në dashuri.



Me aktoren Irene Papas



## NJË LETËR NGA PIKTORI I MADH FATMIR HAXHIU

Nga Enver Kushi

**Miku im i shtrenjtë dhe i paharruar, ndërroi jetë, më 10 mars të vitit 2001. Ai u largua nga kjo botë, me pengun më të madh të jetës së tij: mosrealizimin e pikturës murale për Betejën e Fushë Kosovës, që do t'ia dhuronte Muzeut të Prishtinës.**


Kjo letër, që botohet për herë të parë, kmban datën 25 gusht 1997 dhe është dërguar nga Fatmir Haxhiu dhe Leti (Farzileti), bashkëshortja e piktorit të madh. Ata në atë periudhë të trazuar dhe nga më dramatiket e tranzicionit shqiptar ndodheshin në Bilbao, ku prej vitesh jetonte Artani, djali i tyre, bashkë me Karminën, bashkëshorten e Tanit dhe Olisën dhe Editn, vajzat, që unë i kisha njohur fare të vogla, kur shkoja në familjen e tyre. E gjeta këtë letër në mesditën e 2 majit 2021, kur u ktheva nga varrezat e Sharrës. Mëngjesin e kësaj dite, që kishte shenjtërinë e Pashkës së Madhe, mora rrugën për në Sharrë. Mëngjesi ishte i lagësht, nga shiu i padukshëm, ardhur siç dukej nga qiej mistikë. Dhe teksa hyra në qytetin e të vdekurve, befas qielli u kthjellua. Kisha ardhur në këtë qytet të përjetshëm, të të vdekurve, për vizitë e për të biseduar me miqtë e mi, shkrimtarin Ylli Xhaferri, varri i të cilit është në krahun e djathtë, jo shumë larg nga hyrja e këtij qyteti, regjisorin Kujtim Gjonaj, shkrimtarin dhe kurturologun Moikom Zeqo... Qëndrova gjatë pranë tyre, u fola, duke vështruar portretet e ngrira në pllakat e mermerta të varreve. Rrallë më ka ndodhur, që të ngarkohem me ca emocione krejt të veçanta, që nuk di sesi t'i quaj, siç më ndodhi kur u ngrita nga banesa e përjetshme e mikut tim të paharruar Moikom Zeqo. Atje lashë një letër, fshehur nën një gur, që disa javë më pas e gjeta vajza e tij Kleitja. Dhe kur dola në një nga rrugët e qytetit të të vdekurve, hodha vështrimin lart, ku ca re të bardha lëviznin si me përtim në qiellin blu.

Kërkova në parcelën, ku mesa mbaja mend, ishte varri i Vath Koreshit, njeriut të mrekullueshëm dhe shkrimtarit, që më ka ndihmuar në hapat e mia të para si prozator. U enda gjatë por nuk e gjeta. Edhe prof. Dhimitër Shuteriqin nuk e gjeta. As prof. Alfred Uçin dhe as shkrimtarë e artistë të tjerë që kisha njohur.

Pastaj këmbët më çuan në parcelën, ku ishte varri i Fatmir Haxhiut: një varr

i thjeshtë, punuar bukur nga miku i tij, skulptori Mumtaz Dhrami. Përkëdhela autoportretin e Fatmirit dhe më pas edhe portretin e bukur të Farziletit, vepër kjo e Fatmirit. Në heshtje dhe më pas me zë, u thashë se u jam mirënjohës të dyve për mikëpritjen, miqësinë, që më kanë falur në vite, se e ndjeja shumë mungesën e tyre dhe se vazhdonin te jetonin gjallë në kujtesën time. E ndërsa po largohesha, i dërgova sms Arianës, vajzës së tyre, ku i shkruaja, se u çmalla me ta. Ora ishte 11. Dielli digjte, ndërsa nga lugina e Erzenit, erërat dukej sikur sillnin hingëllimat e ngrira të kuajve, që piktori i madh Fatmir Haxhiu, ka hedhur në tablotë e tij të papërsëritshme. Këto hingëllima kuajsh më shoqëruan, kur hyra në shtëpi, bashkë me një ngarkesë të çuditëshme emocionesh, ose më saktë re malli, që dyndeshin vullshëm, ardhur nga varrezat e Sharrës.

E dija që e kisha ruajtur si sytë e ballit,




letrën që më kish dërguar Fatmir Haxhiu, nga Bilbao e largët. Dhe kur e hapa dhe nisa ta lexoj, nga fjala në fjale dhe përmes rreshtave, më dukej sikur dëgjoja zërin e Fatmirit dhe të Farziletit. Letra është shkruar në dy faqe. Dallohet kujdesi i mikut tim, jo vetëm në kaligrafinë dhe saktësinë e shkrimit të shqipes, por edhe dëshira për të dhënë sa më shumë informacion, për Artanin, Karminën, mbesat, që "janë rritur e zburuarur dhe janë bërë zonjushë", për Bilbaon, "qytet i madh dhe i bukur, ndërtuar mbi nje terren të thyer, me kodra gati malore, që së bashku me arkitekturën e bukur të ndërtesave, u japin larmi peisazheve befasuese..." Për t'i bërë më konkrete këto imazhe, bashkëngjitur me letrën, është edhe një kartolinë, ku janë 4 foto të vogla me ngjyra. Në pjesën e pasme të saj, poshtë emrit me gërma të mëdha BILBAO, janë këto diçitura për fotot: Ria, Teatro Araga, Casade Juntas (Garnika), y Basílica de Nuestra Señora de Begona).

Nuk po ndalem në hollësira të tjera, që Fatmiri shkruan në këtë letër, që kanë të bëjnë me jetën e gjallë artistike e kulturore, në Bilbao, por dua të nënvizoj dy konstatime që do t'i lexoni në këtë letër

Së pari, atij i kanë bërë përshtypje, jo vetëm kultura e ndërtimit në Bilbao, Madrid, Gernika, San Sebastian etj, por edhe muzetë e pasur dhe kujdesi që tregohet për trashëgiminë kulturore në Spanjë, vend që i ka dhënë Europës dhe botës, shkrimtarë, piktorë, artistë, arkitektë të jashtëzakonshëm. Pas këtij konstatimi, vjen një frazë që nuk ka nevojë për koment! "... ndjej keqardhje për vendin tonë, që edhe pas pesëdhjetë vjetëve pune e djerse të lodhshme që bëmë, këto vitet e fundit, siç e di ti, e larguan Shqipërinë edhe më shumë nga bota e qytetëruar".

Së dyti, piktori i madh Fatmir Haxhiu, siç shkruan në këtë letër: "Që kur kam ardhur, pothuaj çdo ditë kam punuar edhe pikturë, që t'i lë Artanit disa kujtime, sepse nuk dihet, jeta bën të vetën dhe ma merr mendja, do ta kemi të vështirë të vimë përsëri", ai ka vazhduar punën e tij krijuese, me të njëjtin ritëm, si në Shqipëri.

Ishte viti 1997, një nga më dramatikët dhe të mbrapshtët për Shqipërinë postkomuniste. Në qytetin e bukur të Bilbaos, ai atë vit, ishte në prag të 70 vjetorit të lindjes dhe punonte pa pushim, duke jetuar dhe me hallet e Shqipërisë dhe ngjarjet tragjike, që përjetonte Kosova martire, në atë periudhë. Mbaj mend, që kur u kthye në Shqipëri, në shtator të 1997, më foli gjatë për qytetërimin e madh ispanik dhe dhimbjen, që përjetonte Shqipëria. Tre vite më pas, në fundvitin 2000 dhe fillimvitin 2001, piktori i madh Fatmir Haxhiu, do të vizitonte Kosovën e çliruar nga pushtuesi mbi një shekullor serb. Ai ishte i mbushur me emocione dhe po hidhte bocetet e një pikturë murale, për betejën e Fushë Kosovës të vitit 1389.



*Të dashur Neta dhe Enver,  
Dëshirojmë të jeni të gjithë mirë me shëndet dhe me punë!*

*Neve këtu po e kalojmë mirë. Po ç'mallemi me Artanin-Karminën dhe mbesat. Ato janë rritur e zburuarur dhe janë bërë zonjushë.*

*Qyteti është i madh dhe i bukur, i ndërtuar mbi një terren të thyer, me kodra gati malore, që së bashku me arkitekturën e bukur të ndërtesave u japin larmi peisazhesh befasues Bilbaos. Jeta është tepër intensive, fillon në mëngjes gati dy orë më vonë se në Shqipëri (pasi këtu dielli lind dhe perëndon dy orë më vonë nga tek ne), por vazhdon deri në ora dy mbas mezzit të natës, sidomos në këtë periudhë, që janë dhe festa e gushtit, njerëzit dëfrenjë, kërcenjë e këndojnë në mënyrë massive, të shoqëruara me aktivitetet të gjera artistike e kulturore në shumë pika të vendit.*

*Artani është përpjekur të na argëtojë dhe të na kënaqë. Përveç Bilbaos, kemi parë dhe qytete të tjera, si Madridin, Gernikën, San Sebastianin e të tjera qytete, të cilat na kanë lënë mbresa të mëdha, për kulturën e ndërtimeve, pastërtinë shembullore, për muzetë e pasura dhe kujdesin që tregojnë për mirëmbajtjen e tyre. Bashkë me kënaqësinë ndjej keqardhje për vendin tonë, që edhe pas pesëdhjetë vjetëve, pune e djerse të lodhshme që bëmë, këto vitet e fundit, siç e di ti, e larguan Shqipërinë edhe më shumë nga bota e qytetëruar.*

*Që kur kemi ardhur, pothuaj çdo ditë kam punuar edhe pikturë, me qëllim që t'i lë Artanit disa kujtime, sepse nuk i dihet, jeta bën të vetën dhe ma merr mendja, do ta kemi të vështirë të vimë përsëri. Më 3 shtator do të shkojmë në Venecia. Do Zoti ta kalojmë mirë. Në Shqipëri do të kthehem më 21 shtator, pasi edhe vizën ma dhanë deri në këtë datë.*


*Urojmë t'u gjejnë shëndoshë e mirë. Të fala të gjithëve.*

*Të fala keni nga Artani-Karmina dhe mbesat.*

Ju përqafojmë  
Leti, Fatmiri  
Bilbao, 25 gusht 1997

Miku im i shtrenjtë dhe i paharruar, ndërroi jetë, më 10 mars të vitit 2001. Ai u largua nga kjo jetë, me pengun më të madh të jetës së tij: mosrealizimin e pikturës murale për Betejën e Fushë Kosovës, që do t'ia dhuronte Muzeut të Prishtinës.

Tiranë, dhjetor 2021





1.

Patriotët, u bënë botë në vete. Një rrëmujë e vërtetë për interesa personale. Blejnë çdo gjë. Shesin çdo gjë. Ka njerëz që ende e duan lirinë për ta parë nga larg. Bota reale s'ka kohë shtesë. Koha shtesë e ka humbur orientimin. Unë po mendoj se dëgjova diçka. Kjo pritje është një premtim. O Zot, prite Njeriun! Prite dhe kuptoje Njeriun. Nuk e ka ende të qartë pse jeton. Në rregull. Ditën e mirë. Shihemi kur të del hëna e re. E kur poetit i kujtohet gjysma e hënës së humbur, prandaj njeriu me njeriun kurrë nuk e ka të sigurt. Do të kalojë. Ishte e padrejtë. Mendova se dëgjova diçka. Ky qëllim është një premtim. Bota reale nuk e kupton.

2.

Tani e kaluara nuk e ka asnjë vlerë. Ëndrra dhe fotoja e Evës me gjarpër në dorë e me kërbizë të humbur, për një puthje të vërtetë ka edhe shumë gjëra të tjera, për të cilat më shpijnë të mendoj, por edhe fjalët më kanë humbur. Mjegulla dhe unë dhe fotografia artistike e Evës me gjarpër në dorë, jemi si moskuptim që vjen nga keqkuptimi. Si jemi bërë njerëz publik. Patriotët e të famshëm. Janë edhe shumë gjëra të tjera për t'i thënë, por nuk dua t'i them dhe nuk po mund të gjej njeri që t'ia them të gjitha. Para kësaj befasi nuk mjafton bota e kësaj befasi. Kalimi nga lufta në luftë për ngjarjet e panjohura na dolën më shumë se fjala dekorative. Duhet të mësohemi dhe të qeshim. Mjaft kemi qarë. Historinë nuk e dua, sepse në emër të Zotit njeriun e ka keqtrajtuar. Gjithçka e panjohur përsëritet. Nuk kemi se ku të shkojmë më larg. Çmenduria është bërë mesele. Për të kaluar krizën kaq! Sa për çështjen që na doli pas veshi, prapë keq! Çaraveshja po ashtu po na pengon. Oj çikë, prit pak! Ndal! Çka je hapë si bretkosë?!

3.

Në oborrin mbretëror ka shumë fjalë të mërzitshme, të tepërta. Pamjet e panjohura ilustronë shfrenimin e patriotizmit mashtrues. Më në fund besohet se do të bëhet mirë. Sipas traditës mungon vetëm plumbi i gjuetarit. Mbretin e ulur në fronin e mbretit e ka kapur shqetësimi. Kësaj radhe të gjithë shpresuam më shumë, por liria na erdhi si vizion i egër. Po ku je nisur, më pyeti një plak. S'e di babush. Jam nisur. Vetëm jam nisur. Nuk të pyeta ty, po këtë që po thotë se ka ardhur nga lufta. Nga na doli kjo fjalë më shumë se fjalë. Asgjë tjetër e mirë nuk po më kujtohet. Realiteti emocional nuk ofron asgjë. Mos po harrojmë se kush jemi. Historisë nuk i besoj. Edhe në emër të Zotit na ka keqtrajtuar me vite e shekuj. Në oborrin mbretëror ka shumë fjalë mashtruese. Më në fund besohet se do të bëhet mirë. Mungon vetëm figura e gjuetarit. Prit o njeri!

# SËMUNDJA E ZJARRIT

Nga Rexhep FERRI

Ku po shkojmë? Unë nuk e kam nëpër mend për të shkuar kurrkund, as për të bërë diçka, Gabimi njerëzor është i pafalshëm. Mos i tregoni askujt. Kur ta gjeni një njeri, një njeri me fat, kur të gjithë jemi pak të çmendur. Nuk po e dimë si shkohet në luftë pas luftës së humbur? Unë i thashë besoj se po. Jo, ma kthen pas luftës ajo duke u ndalur pak në degën e muzikës kur shkoj pak më larg çfarë pëlqimi për ëndrra që i vizatova.

4.

Për të kaluar krizën përtej mitologjisë, fytyra e maskës ndërrohet gjatë çdo lufte e pas çdo lufte. Me kufij e pa kufij. Po thonë se kanë kaluar 6000 vjet qytetërim. Të gjithë e tradhtuam vetveten. Liria është zogu i natës. Gjithkujt iu dha mundësia: të çelë gojën, ta mbyll gojën. Pse nuk na ecën fati, nuk e di. Pas gjithë këtyre poshtërsive nuk vlejnjë asgjë... Pashë se po mendohet. Pa ndarje në ideologji. Miti për lirinë i takon mikut dhe armikut. I mungon figura e gjahtarit. Pas luftës i mungon figura e gjarprit, kjo shpresë na erdhi si e panjohur, me shikim të egër. Ajo që del në shpinë të pasqyrës ndoshta e di. Kur del në shpinë të pasqyrës sigurisht se e di. Më larg se largësia e kohës së tashme. Çdo kohë e ka djallin e vet. Pse e kemi të vështirë ta kuptojmë vetësinë e jetën në "Farmën" e Orvellit. Mjegulla e një rrumpalle të panjohur na e ka ndryshuar besimin më shumë se besimi i çmendur i hazreti Hitlerit, hazreti Leninist dhe hazreti Stalinit. Krijimi i iluzioneve mori kohën e vet dhe jetën e qorrfermanit të njerëzve.

S'ka mbetur gjë tjetër veç lotët e nënave dhe baballarëve dhe i grave për burrat e humbur. Ka edhe lot zhgënjimi. Kush e di përgjigjen? Për lakuriqësinë e moralit nuk po na vjen keq. E kush e ka shkruan, pyeta, këtë histori që nuk po e pëlqen. Prapë pyeta: djalli. Kush tjetër pos djallit.

5.

Ku do të shkojmë. Çka kemi humbur e çka kemi fituar. Nuk kemi përgjigje! Para se ta shohim fytyrën e njeriut, para syve e kemi një boshllëk. Në çdo hap mund të zbulohet jeta e çmendurisë. Nga drita në terr e nga terri në dritë, e vetmja dritë që shihet është drita në dritë nga e cila dritë nuk shihet asgjë. Nga çaraveshja për nesër ndoshta na mjafton bota e kësaj bote. S'kemi ku shkojmë më larg. Në këngë e kemi më shumë vdekjen se jetën. E vetmja gjë që mbeti prej legjendave janë Bjeshkët e Nemuna.

6.

Nga syri frontal në profil kam shumë kujtime me faraonët e Piramidave të Egjiptit. Bashkë me diellin kush e ka përgjigjen? Si ta shohim realitetin? E kemi harruar realitetin. Zgjasim duart dhe presim të na vie edhe e panjohura. Ato mite që i kemi ruajtur, me një mjegull të kaltër i mbyllim sytë dhe i harrojmë. Mjegulla e një civilizimi botëror e njohur si Lufta e Dytë Botërore e ka ndryshuar botën. Tani nuk kemi asgjë për të parë, ashtu siç ka qenë.

Më në fund historia u shpall fajtoare. Lufta u bë e nevojshme për çdo gjë. Nuk më pëlqen të flas nëse nuk ka kush të të dëgjojë. Jeta nuk ka pse të fshihet. Kush do ta mbrojë njeriun. Me ndihmën e Zotit duhet të bëjmë diçka. Njeriu i fundit. Dhimbja e fundit. Po kthejnë diçka që dihet se ka humbur. Prapë më vie mos ta them. E kam të qartë. Nuk kam pse të shqetësohem. Çdo gjë më e bardhë se e bardha; më e zezë se e zeza. Pa zbukurime artificiale.

7.

Të shohim përsëri se sa jemi larg. Tani jemi vetëm. Nuk kemi as kthetra, as gëzof e as miq... Si do të jetojmë e mbijetojmë nuk e dimë. Vetëm Zoti që është larg nesh e di. Biri im, shumë gjëra kanë ndryshuar. Për të shpëtuar ëngjujt nga ëngjujt, jemi ku jemi. Për të gjetur një kuptim. Edhe gjysma tjetër e jona, që nuk e dimë ku ka shkuar, ndoshta do të mbetet gabim që do të na përcjellë edhe gjatë kohës së ardhshme. Amanet, o amanet!... Ndoshta po më kupton. Me kohë e kanë ndryshuar pamjen edhe majat e maleve. Prandaj mbaje distancën dhe prit. Fati më ka ndihmuar dhe më ka nderuar. Ujku që këndon këngën e jetës, ku drejtin shkoi? Çdo errësirë ka një dritë. Sot e tutje çdo ditë ndryshe. Çdo dreqë ndryshe. Çdo darkë ndryshe. Po jetojmë si ëngjuj. Kjo është e ardhmja.

8.

Përveç meje Zoti do ta dijë të bëjmë punë të çmendur për të shkuar në anën tjetër të botës. Duhet të kalojmë nëpër rrezet iks. Mbaroi gjithçka... Filloi gjithçka. Të flasim edhe pak. Ky është fati ynë. Nga kjo anë flitet për rrëmujë. Për ata që e dinë fort mirë për çka jemi duke folur nuk kanë nevojë për famë. A ka njerëz të famshëm e të panjohur. Pas luftës ka më shumë se shumë. Në fund të tunelit njeriu e pa një dritë për një kërbizë që di të luajë. Ku po i di të gjitha këto marifete? – Eva me gjarprin pyeti. Mos e ngatërro gjuhën. Kështu e kupton më mirë.

9.

Do të përballemi. Për pak harrova. Do të harrojmë dhe do të harrojmë. O njeri, u vonove shumë. Mjaft me kaq. Mos e gënje veten. E humbe edhe fillimin. Nuk jemi më për terapi artistike. A nuk po i sheh lotët mes nesh? S'ka rëndësi sa do të zgjasë. Rruga më e gjatë që na kujtohet. Të shohim deri ku mund të shkojmë me këto çmenduri. Mirë që është sëmundje kaluese. Kur na lëshon, na lëshon. Me hijen e rëndë të Zotit u tremba dhe u frikësova si ujku nga vetëtimat...



Poezinë e Lindita Ahmetit e kam lexuar me vëmendje, kërshëri e kënaqësi të veçantë, që nga libri i parë, "Mjedra dhe bluz", botim i Flakës, Shkup, 1993. Pas botimit të librit të pestë poetik "Nga mështeknaja e babait", Portalb, Shkup 2015, sfondi ku ngjizet dhe përshfaqet natyra krijuese e saj, mbetet i njëjti, por tani në mozaik-për-bërjen përfshin univers, kohor e hapësinor sidomos, më të gjerë, me depërtim më të thellë, tutje në horizont, si një penetrim përtej, në përmasa të pakapshme; nuk të shqitet ndjesia e përmasave të veçanta që sjell poezia për ekzistencën, për jetën, për hadin, për dashurinë, për at' e atësi, për etni, ngarkuar mitologji e histori, tjera raporte yllësi-botë, tjetër komunikim mes perëndive dhe tokësorëve, fate e fatalitetet; tjetër kontekst simbolik i kopshtit, i pyllit, mështeknajës së babait emblematik, tjetër perspektivë përgjërimi për të nesërmen, - pezull, jo të sigurt të tij, të atmesë..., në këtë hark kohor - fundshekulli njëzet dhe fillim shekulli në rrjedhë; me mallëngjim brengosës, shqetësues, përthith vizonin e babait për të sotmen, për të nesërmen e kërcënuar pas shpinës, larg patetikës dhe shtirjes; ndryshe vigjilojnë me dhjeta engjëj perëndish mitologjike mbi kokën e hapësirës ku rritet e çel lulja iris illyrikum, i ndryshëm familjarizimi me to, me natyrshmëri të përsosur komunikimi, jep e merr, i përcjell e ndan me to shqetësimet, makthin përballë orakujve fatkob dhe, mbi të gjithë, është kurdo e kudo një vetmi planetare e zërit poetik të Linditës, vetmi e pangushëllueshme; tërë këtij universi poetik ajo i bie pashmëpashë, i bën bashkë në pleksje e çpleksje me lehtësi dhe natyrshmëri estetike të përkryer; ajo përgjon penetrimthi, përmes refleksit ndriçues, të brendshëm, përtej tavaneve, iluminohet oreçast duke mëtuar të marrë përdore fanar-perënditë zeusiane sferave ku tokësorët e kanë të ndaluar hyrjen...; zë e zemër, imagjinatë e refleks që vërvitet përtej thellësive dhe mistereve tokësore, përftojnë e prijnë drejt përmasave kohore dhe hapësinore, tjera tërmetesh të brendshme, tjera makthesh për pasigurinë e qenies së babait, të kopshtit atëror, të lulës iris illyrica, të etni-familjes, të universit njeri, duke shijuar edhe hapësira homerike dhe danteske nëpër të cilat përftojnë shtresa qiellore të hapura pafund... Mbase, vetëm kur bëhen një fuqia krijuese dhe vetmia kësi përmasash, si arti i këtij zëri, artikulumit arrin maja poetike që vihen edhe në shërbim e vigjilim të mështeknajës së rrezikuar të atësisë, në mburojë engjëllore të babait, simbolik, qendror, tërë universit lirik dhe ilirik, universal...

Mos vallë sëmundja e bashkëlindur që ia kufizon lëvizjen fizike tek poezia në këtë rast shndërrohet në fuqi shtesë talenti, mos vallë ajo koprraci natyre kompensohet në dhunti krijuese? Siç dihet, shkenca pranon se një shqisë e penguar për aq fuqizon një tjetër, përkatësisht ajo e lëvizjes fizike dyfishon pushtimin e hapësirave përmes imagjinatës, dyfishon përmasat e hapësirave të ndriçuara, sidomos në çaste përfundim iluminizimi të brendshëm. Poetët me këtë shkallë dhuntimi, krijues dhe metafizikë, tërhiqen nga prirjet drejt vizonit kërkimor, pa synuar dhe pa u kënaqur nga një objektiv, cak i pushtuar, por pas tij synohet ai i radhës, proces që rri i hapur në mënyrë konstante. Lexuesi këtë lloj poezie e përfjeton ndryshe nga ajo që artikulon dhe përcjell imazhe tokësore në sfond, konfiguracion, topose reale dhe që, përmes kësaj poetike përkapin lëvizjet e brendshme të botës së njeriut; përkundrazi, pamjet që sfondojnë fluturimet e imagjinatës komunikojnë, përpleksen dhe plotësohen a përjashtohen duke bërë bashkë tokeqijll, duke e nxitur lexuesin të vërë vesh e të përgjojë tërmetet e brendshme të poetes.

Sytë e brendshëm të poetes, në përfitime teheshe të mprehta, qëndrojnë fanarë mes mirësisë dhe ligësisë, mburojë e së parës nga e dyta. Lidhur përjetë pas karrocës, fron emblematik i krijimtarisë së saj, tani e njëzet vite, Lindita Ahmeti, e struktur në një kënd të hapësirës-odë mysafirësh të babait, në shtëpinë bujare të tij, përkap e përthith tërë atmosferën mes të pranishmëve, zbërthen, zhvesh dhe vesh çdo fjalë e frazë, të secilit e për seci-

## RREZATIME KUPTIMORE DHE ESTETIKE TË "MËSHTEKNAJËS..." SË LINDITA AHMETIT

Nga Ali ALIU

lin, peshon në rëntgen drite nuancat më të holla të lëvizjeve, shkëndijime e trazime të brendshme, hije-dritat e shpërfaqura në timbër dhe shikim, rrezatim mrroljet dhe hapje dhe, në fund përshfaq në dritë të diellit miqtë dhe "miqtë" e babait... I alarmohet tërë qenia, sidomos kur e ka fare të qartë se njëri nga ata që në kthesën e parë të sokakut do t'ia kurdisë kurthin... Është shqetësim i parë i zërit, prandaj, mbrojtja e babait, e mështeknajës atërore është vigjilimi konstant i alarmuar, artikuluar art poetik; është përgjërimit-lutje perëndive për t'i ardhur në mbrojtje kopshtit atëror, për t'iu bërë mburojë lulës iris illyrica, lulës të cilën, që nga fillimet e ka shtyllë frymëzimi, krahas ëndrrës intime, asnjëherë të shuar, që përfton qiejve sa karrocash pegaziane sa flatra apollonësh dhe paridësh që poezisë lirike shqipe i sjellin frymë fare tjetër.

Vigjilimi trazues i zërit lirik është konstant valë të pashkëputura gjithë me synim të rehatojë babanë dhe mbi këtë sfond, në ecje e sipër të shkëputet fluturimthi ëndrrave afroditiiane, sa në shoqëri me zana, sa në shoqëri me birin e Kadmit, sa me çunin e gjitonit; në komunikim të përherëshëm është sa me perëndi të yllësisë antike, që ja behin në çdo thirrje të saj, sa nga mbi deti Jon dhe Mediteran, sa nga ai pers dhe mesopotamik apo egjiptian, i atropomorfizozon duke formuar bashkësi personazhesh me lehtësi dhe natyrshmëri të besueshme sa nga më të çuditshmet në poezinë tonë; shumica e këtyre dhjetëra e dhjetëra personazheve qiellorë vijnë miqësorë e ogurbardhë për mështeknajën e babait, për dallim nga ata që vijnë bubullimthi e ogurzi. Të rralla janë shkëputjet përfutuese të zërit, edhe pse, në poetikën artikuluese të poetes, janë fluturime prehëse e lumturore sa nuk do të përfundonin kurrë; siç është ai i karrocës pegaziane që noton mbi blunë e Liqenit të Ohrit, ngarkuar krushq drejt Shën Naumit, noton zog qielli e nuk do të mbërrijë kurrë...

Nuk i shpëton asgjë, asnjë lëvizje, rrotull e në ajër, asnjë dridhje e brendshme në hapësirë syrit të saj të brendshëm. Arti i saj poetik ngjizet dhe starton në fillim të decenies së fundit të shekullit njëzet dhe shtrihet brenda dy decenieve të shekullit vijues, sado duket, kjo poezi, ky zë lirik se është i shkëputur nga koha dhe hapësira, sado poetika e saj vjen univers mitologjik, perëndish e engjëjsh qiellorë, tabani ngjizës i frymëzimit është fuqishëm i pranueshëm. Fjala është për 30 vitet e fundit, hark kohor historikisht nga më të rëndësishmit në hapësirën shqiptare. Mështeknaja e babait, apo gështenja atërore, kulla e babait ku ka lindur ajo është rrëzë malit Sharr, bri Pollogut, mbi pullazin e të cilës, në kapërcyell të shekujve, shpërthenin gjyle topash në faqemalin prej nga rezistonin luftëtarët e lirisë... tërë atmosfera, përthithur nga shpirti dhe mendja e poetes fare të re, atmosferë ngjeshur me pasiguri për qenien... trazira që në hapësirën shqiptare janë ende të pambyllura... Sa debate, të shkruara a të shqiptuara ka thithur bota krijuese, super e ndjeshme e poezisë së saj, gjatë këtyre viteve.

Bota krijuese e Lindita Ahmetit përngjan në një çark prorre të ngrehur që vigjilon përthithshëm vibrimet e dukshme dhe të fshehta, nga më të hollat, krijon ngarkesën e sampos poetike të saj..., lundruese mes syprinave sa te qeta, sa valëve të frikshme dhe thellësive të errëta përfu-



i të gjitha teorive narratologjike, ndër shekuj, sa herë ndërrohen, me të drejtë, perspektivat perceptuese. Relacioni realitet-mimesis mbetet bosht referencial, ai thelb i poetikës antike.

Poezia arrin të kalojë përtej hapësirave realisht të pushtuara, të njohura të mendjes, të dijës e të ndërdijës, ajo, poezia, që nga fillimet, arrin të vërvitet lartësive përtejqiellore, të shfaqë udhë të pashkeluara, të parrahura, por të ëndërruara të njeriut, njësoj siç ndodh edhe me poezinë e Lindita Ahmetit. Poezia e saj qartë, natyrshëm dhe me kreacion, i bën të besueshëm edhe imazhet ngarkuar me tisin magjik, mistik bashkë. Zëri lirik në këtë botë krijuese, e ndjen dhe parandjen të sotmen dhe të nesërmen e babait, gëzimin, shpresën, vuajtjen; veshyri i brendshëm i saj dëgjon monologun e brendshëm të tij, dialogun me botën përreth dhe në gjithësi gjatë ecjes, gjatë përhumbjeve të tij përasiatëse, gjatë ecjakeve si somnambul korridoreve të errëta e pafund, gjatë prehjes shtrirë në kënd divani...

Libri më i fundit i Linditës, siç e thashë, mban titullin "Nga mështeknaja e babait". Është pylli atëror, i mështeknës, drurit që rritet në klimë të ftohtë, trupdrejtë, lëvere të bardhë, të lëmuar, gjethe të dhëmbëzuar, dhe që, nga pamja që kanë, në popull personifikohen si të kreshpëruara, si flatrat e shpendit kur u bën mburojë zgogje nga grabitqarët; acarimi i tyre stinor, i gjetheve, bashkë me tiparet e tjera të drurit, artikulojnë një figurë metaforike nga më ekspresivet në poezi; e përplotëson gjeturia e brendshme e drurit mështekne, që ka të palosura, palimpsest rrahët e lashtësisë atërore; mjeshtri nxjerr dërrasat nga ai trup, orenditë e shtëpisë së babait, dekor hijeshie, të mështeknajës së babait, metaforën e zgjeron në hapësirë dhe kohë rrezatimin kuptimor dhe estetik diç vështronte në gjysmëterr përmbi shkretëtirë, unë e hetoja praninë e ftohtë të një frymë,



por s'mund të shihja gjë përveç dridhmave të natës që rënkonte. e hapa dritaren e kullës që ta pikas syrin përgjimitar, sërish nuk pashë gjë përballë meje. pastaj ia dha era dhe e hoq pluhurin e harresës që mbante peng të kaluarën, hijen e dyshimit dhe gjysmëterrën që rëndonin mbi të tashmen, duke zbuluar një dru me kurorë të madhe i cili, ndonëse jepte përshtypjen e diçkaje joreale, ishte krejtësisht i vërtetë dhe këtë e kuptova nga lulet

iris illyrica

që kishin çelur dy-tri hapa përtej rrethit që e kap kurora, nga poleni që ma solli era dhe nga oaza që shkëlqeu.  
(Gështenja)

Krahas mëshëknës, poetja sjell edhe simotrat apo sivëllezërit, gështenjën dhe rrapin, që, në poezi dhe bimësi janë familje e gjerë, në strehën e përbashkët të mëshëknajës, simbol etnie. Vendosur brenda këtij konteksti hapësinor bie fjala, Gështenja, poezia me të njëjtin titull, vjen rrëfim poetik, përfshirë brenda 15 shkallëve lëvizëse. Me lëvizje të kursyera ajo sjell pamje mes ëndërr-zhgjendrrës, vendosur surrealisht tokeqiell, brenda një nate të trazuar të zërit lirik; në gjysmë terr, diku mbi shkretëtirë, intuïta krijuese ndjen një si prani, pranë e gjithandej që përgjon, - ndihet fryma e gjësë së pranishme, si drithërime terri, ajri, pezull, e padukshme; e hap dritaren, kot, se mos mund të dallojë gjë zëri lirik dhe, s'mungon shfaqja e re: nga thellësitë e harresës, një dru kurorëmadh, aty pranë edhe lulja, tanimë emblematike iris illyrica; shenja që, duke qenë në krahët e ëndërrës, zëri e bind veten se është brenda realitetit. Druri dhe gjithë pamja madhështore i zgjon kujtim-gjelbërimin nga femëria...; është gështenja, simbol i lashtësisë që e gjallëron, i jep shpirt visit (atëror) në evokim e në prani të këngës së nimfave... nga krejt pamja mahnitëse, zëri lirik, për një çast mbetet pa fjalë - krejt nën hijen madhështore të drurit, mbi dhe në qendër të një hapësire thuaja të thatë, shtrirë e mbuluar rërë... Ja edhe prania e Drijadës, gjysmëperëndia antike që i jep gjallëri gjithësisë gjelbërim, tani e plagosur e mbështetur në hijen e drurit, në përpjekje për të rrezatuar krenari. Në këtë mozaik, pamjet lëvizin me shpejtësi, shkrepte të befasishme, ndër të cilat edhe grimca femërie, ja beh erosi - në shaminë mbështjellëse të fytyrës së zërit. - gjest erosi për t'ia larguar vetminë, djali i fqinjëve, i ëndërrave, me një tufë lule iris illyrica dhe një vërvitje nga ëndrra në ikje tek ajo e radhës, tani artikulluar përmes vargjeve, në hyrje me një pyetje (bosht i poezisë); a thua i ka për mua?

Në një pjesë të krijimtarisë së saj, fare i veçantë tek ne, i vetmi ku autorja shërbehet edhe me shenjat e pikësimit dhe, ku frazat brenda pikave zëvendësojnë vargjet, të shtrira horizontalisht, kjo pjesë tek poezia Gështenja, që në hapje shfaq vetminë planetare të zërit; në mbërthim acari të brendshëm me rathë shtrëngues pas ikjes shtegut të djalit duke lënë pas daravitje ëndërrash, baule ngarkuar kujtime, që do thahen bashkë me lulen iris...

Çdo gjë merr rrokullimën humnerisht, rrjedhë stuhi që rrëmben përpara çdo shpresë duke lënë vetminë planetare, nën një yllësi pafund, pa frymë njeriu; treti çuni i bukur i fqinjëve, çdo gjë përfshihet në shtjellë universi - edhe filizat fluturues të gështenjës, boçat, kokrrat, çuni e sekush kokë më vete, pa ku, pa pse, dorëzuar stuhisë së verbër brenda një hapësire pafund... në këtë rrëmujë trishtuese, çudia; të jetë i pranishëm Kupidoni (variant i mitologjisë egjiptiane i erotit...), nën hijen e gështenjës, nën madhështinë e tij a në qëndismën e shamisë së bardhë; a mund ta përballojë ai, Kupidoni, visin në rërë e thatësi...

\* \* \*

dita ka dalë e zezë  
rënkon ujëvara e përroit kristal  
furtuna e pushton pyllin me krahjeta  
shtohen drithërimat e linit  
dhe fundoset zëri i tij i papërsëritshëm  
(Tregimi i zi)

Ja pse ka shumë zi në hapësirën e përditshmërisë të këtij zëri poetik, përditshëri në të cilën, zëri përjetë mbërthyer në karrocën e gurtë, është në përbashkë të pandërprerë me personazhe perëndish, që i sfidon dhe e sfidojnë pa ndërprerë, ditenatë e nateditë, nga të gjitha statuset dhe perspektivat...; aterojnë në fronin suprem të poetes herë të ngarkuara bubullima e gjëmime kërcënuese, për atmen e saj sidomos, herë për të kurdisur gjëma, e shpesh, e më shumë, për të qëndruar engjëj mbrojtës të atmes dhe për të ndërhyrë drejtpërdrejt... në të mirë të mëshëknajës së babait, për fatin e saj për të cilën e ka dhuntuar qielli atë, poeten.

Krejt ky mozaik poetik është dëshmi se kemi të bëjmë me një shfaqje, prurje fare ndryshe në poezinë tonë; fatprerët e Olimpët, një zot perëndi a gjysmë perëndi, i kanë caktuar, prerë asaj të bëjë përpjekje për t'i zbutur meritë, zemërimet e tyre, për blatim të merituar dhe për të vënë në mburojë të kauzës poetike; herëpashere edhe për të tërhequr vëmendjen e Adonisëve, Erosëve, të paktën sa për të hedhur ndonjëherë shikimin këndej...; betejë titanike, sa për t'ia bërë të qartë kurdisjen e pas-shpinave babait, sa për ta vetëdijësuar shenjash e sinjalesh ngarkuar shqetësim e frikë, sa për t'u bërë syevëshë vigjilimi, për tu shndërruar engjëj vigjilues, krah e në shoqërim të perëndive ogur-bardha.

## Pyetësori "Librat e jetës sime"

NURIE EMRULLAI

### Libri që mendoj se është i nënvlerësuar? "Mosmarrëveshja" e Kadaresë - është vepër që duhet patjetër të lexohet

#### Libri që po lexoj ndërkohë

*Qielli i rremë* nga Julio Cortázar-i. Edhe pse rutina ime e leximit, tashmë prej një kohe të gjatë përfshin më shumë libra. *Te Leksione amerikane* Calvino-ja thotë se *fantazia është një vend ku gjithnjë bie shi*. Po e mendoj se arsyeja pse lexoj disa libra përnjëherë, është se dua të përjetoj shira të ndryshëm në po të njëjtën kohë.

Këtë kohë kam në duar dhe librin *I pangjyri Tsukuru Tazaki dhe vitete e tij të pelegrinazhit* nga Haruki Murakami.

(poezinë e Eliot-it dhe Pessoa-s i kam ngushëllim të kohës që nuk na kursen.)

#### Libri që më ka ndryshuar jetën

Libri që më ka ndryshuar jetën, do të them pa asnjë hezitim se është përmbledhja me drama e Josip V. Relës. E kam lexuar në moshë mjaft të hershme. Momenti kulminant që më përballoi me drama të cilat nuk i kisha lexuar apo përfytyruar. Qe një lloj rritje për mua. Ky libër ma ka ndryshuar jetën, se sigurisht duhet të jetë filli që më zgjoi kureshtjen të vazhdoj e të gërmoj letërsinë. Edhe sot më kujtohet kopertina ngjyrë kafe, mbi të gdhendur me shkronja të arta titulli dhe emri i autorit. Sa për kthjellimin tim dua të shtoj se *Dosja H* nga Ismail Kadareja, lexuar po në moshë të njomë, më ka bërë të thuash, më të *ndjeshme* në lidhje me çdo raport që kam krijuar më vonë me botën tonë kulturore e letrare.

#### Libri që pati ndikimin më të madh në shkrimet e mia

*E shenja dhe profania* nga Mircea Eliade. Ai më plotësoi shumë hapësira që i kisha bosh, pikërisht momentin që nisa të shkruaj. *Mbi heronj dhe varre* nga Sabato-ja dhe *Shakaje* e Kunder-ës patën ndikim në shprehjen e mendimit.

#### Libri që më ndryshoi mendjen

Nuk e di, i pari m'u kujtua *Mjeshtri dhe Margarita* i Bulgakov-it. Aty mësova shumë. Ai libër thjeshtë është i paharrueshëm dhe identifikuesi i shumë çasteve. Akoma më i hershëm është *Metamorfoza* nga Franc Kafka.

#### Libri që do të doja të kisha lexuar

Nuk më kujtohet për momentin asnjë. Mbase do të doja ndonjë libër ta harroja dhe ta lexoja prej fillimi që të përjetoj po ata ndjesi kur e lexon herën e parë.

#### Libri i fundit që më bëri të qaj

Mendoj se kam qarë me *Përçmimin* e Alberto Moravi-së, edhe pse gjatë gjithë librit personazhet më jepnin një lloj irritimi dhe paretatie dhe me tregimin *Patriotizëm* të Yokio Mishima-s. Akoma jam e dëshpëruar për ata personazhe.

#### Libri i fundit që më bëri të qesh

Më vjen keq, nuk më kujtohet.

#### Libri që më vjen turp që s'e ka m lexuar ende

*Emri i Trëndafilut*- Umberto Ecco. Do të doja ta kisha lexuar. Edhe pse jam me parimin se çdo libër e ka kohën e tij, mendoj se për disa libra kam bërë mirë që i kam lexuar më në moshë të pjekur, sepse nuk e kemi luksin që t'i kthehem secilës vepre nga dy herë.

#### Librat që kam dhuruar

Zakonisht, dhuroj libra që i kam lexuar dhe vetëm në raste shumë speciale ose njerëzve shumë të afërt. Libri i fundit që kam dhuruar është *Mos më lër të shkoj* nga Kazuo Ishiguro. Një histori tronditëse që mbahet nga dashuria.

#### Libri me të cilin dua të mbahem mend

*Guri i diellit*- Octavi Paz

#### Libri që me bën të ndihem mire

*Një dhomë më vete*- Vigena Woolf

#### Libri që mendoj se është më i nënvlerësuar

*Mosmarrëveshja* e Ismail Kadaresë- është vepër që duhet patjetër të lexohet. Se akoma kemi shumë mjegull nëpër sy.

Dhe të nënvlerësuara janë të gjithë ato vepra që gjeneratat e reja nuk i kanë në programin e tyre mësimor.



Njohja me historitë e të burgosurve në burgjet e regjimeve komuniste pavarësisht nga vënde dhe gjuhë të ndryshme tregojnë se një elementë ato histori e kanë të përbashkët: instiktin natyror të të burgosurit për të mbijetuar brenda një universi që të mohon, Truri është pa dyshim pasuria më e vlefshme e individit, mjeti ose arma më e mirë për t'i shpëtuar dehumanizimit dhe humbjes së identitetit nën presionin e vazhdueshëm të mekanizmit represiv shtetëror.

Mënyra të dukëshme të zhdukjes së identitetit ishin ato nëpërmjet krijimit të tufës njerëzore uniforme. Shenja të humbjes së unikalitetit human pasoheshin nga qethja demonstrative e kokës, veshja njëngjyëshe standarte dhe diabolizmi depersonalizues i përzjerjes me të burgosurit ordinerë.

Disa përpiqen që të provojnë se jeta në atmosferën antinjerëzore të burgut komunist stimulon kreativitetin artistik në forma të ndryshme. Por e vërteta është se jeta në burgjet politike realisht i ngjan në vetvete trillimit.

Atëhere më mirë sesa një poet e shkrimtar i burgosur askush tjetër nuk mund ta përshkruante këtë trillim absurd real. Trillimi artistik i përmban edhe skenat e tmerrit, edhe groteskun, edhe meditimin serioz.

Te libri "Dorëshkrimet e fshehta të burgut" ashtu si edhe te "Ferri i çarë" (Burgologjia e V. Zhitit) gjejmë absurdin ekzistencial, tmerrin por dhe groteskun sidomos që të kujtojnë fjalët e Mark Tvvain se: "Burimi sekret i humorit në vetvete nuk është gëzimi, por hidhërimi. Nuk ka humor në parajsë".

Kur themi se komunizmi është logjika përfundimtare e dehumanizimit të njeriut nënkuptojmë se dehumanizimi

## Libri i ri i Visar Zhitit

# TË GJALLËT QË JETOJNË SË BRENDSHMI NË "DORËSHKRIMET E FSHEHTA TË BURGUT"

Nga Minella Aleksi



nuk është një mënyrë për të folur. Është një mënyrë të menduari që mbi shtypësin vepron si një lubrifikant psikologjik. I largon atij frenimet logjike duke i ndezur pasionet shkatërruese që e shtojnë atë fuqishëm për të kryer veprime të cilat, në rrethana të tjera do të ishin të paimagjinueshme.

Për çdo rishtar që bie në burgim politik, në BRSS apo në Hungari, në Shqipëri apo në Poloni, Çekoslovakia, Rumani etj, gjëndet gjithmonë një i burgosur më i vjetër i cili i mëson atij një Dekalog. "Dekalogu universal i mbijetesës" i ndërtuar nga eksperiencat më antinjerëzore të burgjeve politike. Nga ky "Dekalog i mbijetesës" ose "Urdhëresat e shenjta të jetës në burg" po sjell vetëm dy prej tyre:

1. Në burg ka vetëm dy kategori njerëzish: të vdekurit së jashtëmi dhe të gjallët që jetojnë së brendshmi. 2. Në burg Zoti mund të fshihet nën çdo uniformë

rojeje dhe djalli nën uniformën e çdo të burgosuri. Një situatë ferri e vërtetë mbi tokë.

Janë fare pak ata të burgosur politikë që brenda burgut e bënë temë të krijimtarisë së tyre artistike këtë jetë ferri "trillim". Sigurisht artisti me talent gjen dhe zotëron aftësinë që këtë tmerr shpirtëror dhe torturë fizike t'a veshë artistikisht me vlerë estetike. Mendoj se te "Dorëshkrimet e fshehta" instikti e nxit poetin që të mendojë estetikisht mbi konfliktin midis prirjes njerëzore për të kërkuar kuptimin e natyrshëm të kësaj jete "fiction" dhe përgjigjes së heshtur të universit shoqëror.

Mungesa e përmbushjes intelektuale dhe dëshpërimi çon progresivisht vetëm në përkeqësim psikologjik dhe fizik. Në burg për zotërimin e shpirtit të tij individit poet lufton me dehumanizimin.

E kuptoj se ku e gjenin qëndrueshmërinë stoike klerikët e burgosur në komunizëm të cilët kanë aderuar në një sistem të ndërtuar, të trilluar besimesh dhe idesh, të cilat shërbejnë për vetmashttrim shmangës nga banaliteti dhe e vërteta e ashpër e ekzistencës. Ndryshe ndodh me poetin i cili ndjek një tjetër sistem mbijetese, atë të rebelimit estetik kundër absurditetit të urryer të ekzistencës në burg. Revolta poetike kundër ekzistencës është ajo që i jep vlerë jetës në absurdin egzistencial dhe vet krijimit të tij estetik. Jo duke e mashtruar veten me iluzione shpresëdhënëse por mbi të gjitha duke e analizuar dhe përshkruar artistikisht atë tmerr. Poeti, shkrimtari, artisti gjithmonë krijon duke imagjinuar audiencën. Në burgun komunist, ku nuk ke dhe as nuk pret të kesh audiencë, ku nuk shpreson që ndonjëherë të marrësh vlerësim, poeti i talentuar duhet të zotëroj forcë shpirtërore të jashtëzakonshme për të krijuar poezi dhe tekste letrare. Në këtë moment, është e nevojshme të kuptohet se ekziston gjithmonë një bërthamë shpirtërore që ushqen lirinë e brendshme e cila nuk mund të shkëputet, as mund të hiqet në skutat më të errëta të një burgu apo të një rrethi të hekurt internimi. Ndërsa krijon art rifiton një ndjenjë qëllimi ku krijimi artistik ndihmon autorin në mjerim që të kanalizoj emocionet në dobi të vetes dhe të të tjerëve, për të jetuar jetë më të përmbushur.

Krijimtaria poetike në burgje dëshmohej si mekanizëm për t'i rezistuar presionit të jashtëm të paktën "së brendshmi". - për të kompensuar me pasurinë e jetës krijuese mjerimin e ekzistencës së përditshme fizike. Duke qenë se çdo fjali e ka një folje, ndjehet se fjala është një krijim i orientuar nga veprimi. Brenda kësaj bote fjalësh poeti

kapërcen heshtjen e izolimit. Jo se me këtë i shpëtoi fatit të destinuar të vuajtjes apo të çfarosjes por duke përdorur fjalën e orientuar nga veprimi, së brendshmi izolimin e transformon në liri. Mendoj se ky transformim i brendshëm ka qënë mekanizmi nëpërmjet të cilit autori ka përcjellë në poezitë dhe tekstet letrare përshtypje të qëndrueshme të përvojave njerëzore, me shumë qartësi, aq sa imazhet e depërtojnë armaturën mendonjëse të lexuesit. Është një karakter, një frazë ose ngjarje që jo vetëm të çpon por të hap një vrimë në mendje dhe të mbetet atje - mbase për një jetë të tërë - sepse godet një akord, por jo vetëm, sepse të ka bërë që të të ndryshoj një vizion.

Një mënyrë ekstreme e aftësisë për të lënë një mesazh mendonjëse estetik nga "zemra e burgjeve komuniste", për të shprehur veten, identitetin e vërtetë artistik. Në librin "Dorëshkrimet e fshehta të burgut" komponenti letrar i teksteve jep të dhëna që ndihmojnë në ndriçimin e përpjekjeve të Visar Zhitit për t'u dhënë konsistencë njerëzore instikteve më misterioze dhe kontraktore që çfaqen në nënvetëdijen e një të izoluarit nga gjithëçka, jep të dhëna në deshifrimin e vet autorit dhe të kuptimit të historisë prej tij. shtë shumë domethënëse çka ish i dënuarit politik, Ilir Malindi në përshtypjet në libër nëpërmjet alegorisë ka shprehur shumë bukur nevojën e përshkrimit të jetës në burg: "Rënia e Visarit në burg ishte një bekim i madh. Gabimisht, monstrat e Sigurimit bënë gjënë e duhur. Ç'është e vërteta, Visari e kishte hak burgun. Më shumë se ne. ...Vuajtjes sonë të shurdhër dhe mamece ai i dha, me elokuencë dhe lakonizëm, dinjitetin e tragjedisë".

Dorëshkrimet e fshehta të burgut është një vepër letrare, është një përvojë e jetuar e një poeti në rrethanat ekstreme të izolimit në burg që hap një dritare drejt kuptimit të së vërtetës për natyrën njerëzore. Kjo e vërtetë nuk është statike pasi përjetohet sipas ndjesive të çdo lexuesi. Diçka të ndryshon duke i shtuar jetës së lexuesit një jetë të re si një përvojë dinamike.

Krahas një dokumenti si kujtesë kulturore, poezitë dhe tekstet letrare në libër artikulojnë një histori arratisjeje. Burgosja u bë si pedanë për një jetë të dytë të ndryshme, të fshehur, ku trupi "u varros" dhe fryma fiton, duke u endur më e lirë nga sa mund të imagjinohet. Kjo nuk do të thotë se trupi u shpërfill, por që ai, nga ana tjetër, iu nënshtua shpirtit të krijuesit: "Trupi im nuk mund të jetë askund tjetër. Me shpirt mund të jem kudo. Këtë pohim egzistencial ka përcjellë poeti Zhitit me librin "Dorëshkrimet e fshehta të burgut".



Studimi “Pikëllim në një foto të vjetër” i fotografit dhe studiuesit të fotografisë Qerim Vrioni është një libër mjaft interesant për lexuesin shqiptar. Objekti kryesor i këtij studimi është fotografia “Gjon Pali dhe e bija” e fotografit shkodran Kolë Maca. Vetë Vrioni shprehet kështu në hyrjen e këtij punimi: “Nga hulumtimet gjeta foton që paraqet një vajzë përkulur mbi të atin e plagosur që po jep shpirt, në një faqe të shtojcës kulturore “La Domenica del Corriere” të gazetës së njohur italiane “Corriere Della Sera”. Ajo ishte brenda një shkrimi me titull “La fine della Guerra Balcanica”, poshtë shënonte edhe emrin e autorit, Kol Maza (gabim, duhej Mazza). Më vonë e pikasa foton në ballinën e librit të botuar në Itali (Milano) në qershor 2013 me titull “Lassedio di Scutari” (Rrethimi i Shkodrës), të gazetarit Xhino Berry, madje aty fotoja ishte edhe në ballinën e dytë dhe në faqen 133. Fotoja po më tërhiqte vazhdimisht, kështu rashë në gjurmët e librit të eruditit katolik nga Shkodra, At Justin Rrota, mbi Rrethimin e Shkodrës (1912-1913), botuar në vitin 2010. Brenda këtij libri, midis faqeve 32 e 33, ndodhej fotoja e Macës, po kësaj radhe me shënim tjetër, “Gjon Pali i i varruem në krye e në dorë”. Kështu, profit erudit shënon dhe emrin e të plagosurit që po mbaron (ose ka mbaruar) në krahët e të bijës, e dhënë tepër e çmueshme për historinë e kësaj fotoje”.

Në vazhdim të punimit, Vrioni trajton vdekjen e njeriut dhe pasvdekjen në fotografinë botërore dhe atë shqiptare. Pra siç shohim, përtej studimit të një fotografie të vetme, ky punim ka vlera të qenësishme për lexuesin shqiptar, pasi sjell në vëmendje një temë të trajtuar ndër shekuj në artin e fotografisë dhe jo vetëm. Lexuesi merr informacion të bollshëm mbi fakte të fotografëve me famë botërore, mbi fillesat e fotove me temë pasvdekjen dhe ka të servitura para vështrimit të tij fotot reale. Studiuesi i fotografisë dhe fotografi plotësojnë njëri-tjetrin në këtë punim. Studiuesi zberthen me mjeshtëri elementet profesionale të shkrepjes së fotos, duke interpretuar dhe hedhur hipoteza të ndryshme për çastin kur është shkrepur fotoja dhe plot detaje të tjera profesionale. Bie në sy fakti se Vrioni ndalet gjatë në elementet poetike të fotografisë së Kolë Macës, duke e shtrirë interpretimin e tij në detaje ku shpërfaqet shpirti poetik i fotografit Maca. Për Vrionin fotografi shkodran është një poet i vërtetë i detajeve tragjike shpirtërore. Ja si shprehet ai në lidhje me poezinë e thellë që gjendet në këtë shkrepje të mrekullueshme të fotografit shkodran: “Fotot e pasvdekjes arrijnë edhe në përfundime të kundërta për sa i përket kumteve të tyre. Ato mitizojnë, por edhe çmitizojnë. Po fotoja e Macës a mitizon apo çmitizon kënd? Ajo mund

## Një pietà shqiptare Rreth studimit “Pikëllim në një foto të vjetër” të Qerim Vrionit

Nga Alisa Velaj

të thuhet se mitizon dashurinë e madhe të vajzës për të atin që po largohet nga kjo botë. Madje, ajo, mendojmë edhe se çmitizon vdekjen. Vajza e sheh si diçka të natyrshme vdekjen e prindit (vdekje e rrdhës), veçse jo kaq shpejt dhe jo në këtë mënyrë”.

Studiuesi Qerim Vrioni analizon me detaje forcën shprehëse të fotos dhe analizon me imtësi të gjitha detajet fotografike që e bëjnë këtë shkrepje të Macës një imazh të gjallë dhe në lëvizje përpara syve të lexuesit. Vrioni merret me detajet e mundshme para shkrepjes së fotos, kontekstin rrethanor në të cilën Maca na ka dhuruar këtë kryevepër të fotografisë shqiptare dhe arsyet se pse kjo foto

mund të quhet një *pieta* e vërtetë shqiptare. Vrioni vë theksin te fakti se imazhi fotografik flet vetë, madje dhe shumë. Por nëse në këtë studim, imazhi i flet studiuesit, analiza e mrekullueshme që ky i fundit u bën detajeve të imazhit krijon një dialog plot ngjyra dhe tinguj me lexuesin e tekstit dhe kundruesin e fotos. Vrioni ka ditur ta lexojë kaq bukur trishtimin e fotos së Macës, sa e bën edhe lexuesin të marrë pjesë në këtë trishtim. Fotoja e shpërfaq tragjikën me një efekt të thellë, me një vajtim që nuk mund të shprehet dot me një fjalë të vetme, por përmes imazhit që është gropuar në kraharorin e protagonistëve të saj dhe të fotografit që e ka përjetësuar për ne.



Përjetësimi i pikëllimës së pashprehshme me fjalë është një nga sfidat e çdo arti. Pikëllimat e vërteta fillojnë aty ku mbarojnë fjalët dhe e gjenerojnë vetveten në çdo lulëzim ankthi. Fotoja e Macës ka brenda dashuri, ankth dhe dhimbje fisnike që nuk pranon të gjejë ngushëllim të askush. Pikërisht këtë dimension të tragjikes zberthen Vrioni. Ky i fundit nuk përpiqet të bëjë një interpretim shterues të imazhit fotografik, por përpiqet të na e drejtojë vëmendjen drejt dritëhijëve të “personazheve” të kësaj gjame. Duke mësuar si të feksim vështrimin tonë mbi dritën e dashurisë dhe hijet e vdekjes, ne arrijmë ta përjetojmë këtë imazh si një gjendje që është duke ndodhur përpara syve tanë, çka përbën në fund të fundit qëllimin më të epërm dhe jo vetëm të artit të fotografisë. Të interpretosh poezinë e një imazhi është e domosdoshme një dije që vjen jo vetëm nga studimi i fotografisë, pasi pa lëvrimin e duhur të artit të fjalës, një studim mbi imazhet fotografike do të ish krejt i mangët. Vrioni ia arrin me sukses të depërtojë në poezinë e fotografisë dhe “të fotografojë” plot gjallëri mendimet e fshehura të poetikës së imazheve, në rrethin e tyre ciklik nga jeta drejt përtejvdekjes. Studiuesi e përshkruan pikëllimën e fotos me forcën shprehëse të një poeti, ndërsa shkruan: “Pikëllimi i saj është i thellë dhe i heshtur, ajo sikur nuk po u beson syve duke e parë në çastet e fillimit të heshtjes së tij të përjetshme, por e pagojë dhe e tharë e vështron të atin me duart e mbështetura te njëra-tjetra, në qëndrimin mortar”.

Krahas vlerës tejet të çmuar, pasi sjell në vëmendjen e dashuronjësve të fotografisë, një foto tejet të rrallë dhe të panjohur për publikun e gjerë, duke i dhënë vendin e merituar një fotografi pak ose aspak të përmendur si Kolë Maca, ky studim ka gjithashtu vlerën e padiskutueshme të trajtimit me shumë finesë të poetikes në imazhin e gjallë të një fotoje.



A i u shtri për të fjetur. Por më shumë se Adëshirën për të fjetur, kishte dëshirën për të ëndërruar. Aty, me ëndrën ai mund të bënte ç'të donte. Mund t'a merrte atë, personazhin e tij, i cili ishte vetvetja dhe padyshim, ajo. Dhe mund të bënte ç'të donte. E lozte filmin si të dëshironte. Ishte vetë si regjizor, ashtu edhe aktor. Mund të futej gjithkund. Mund të ishte i ftuar në shtëpinë e saj, dhe i lumtur, mund të ulej fare pranë saj. Tani, me sytë e mbyllur, kruspull nën shtroje, ishte e mundur gjithçka. Mund të bënte dashuri për orë të tëra. Mund ta puthte dhe ta përkëdhelte, sa të lodhej.

Gjithë ajo indiferencë dhe përcimim në botën reale, aty nuk kishte fare pushtet. I pëlqente ta sëmurve personazhin e tij. Ta bënte të plagosur, ndaj ajo, e bukur dhe e shndritshme si dielli, me atë ndjenjën e ëmbël të mëshirës që për vajzat është dhunti natyrale, e merrte dhe e kuronte.

Plaga e tij, më shumë se në trup, nga armët, ajo ishte thellë në shpirt. Aty i dhimbte. Aty tek dashuria që i mungonte. Aty lëngimi i tij arrinte kulmin. Ajo afrohej dhe me dashuri, me përkëdheli i mermëriste ëmbël.

"E di. Shërimi yt është thjesht një buzëqeshje e ime.

E di. Ilaci yt më i mirë, është përkëdhelja ime. Ti dëshiron me zjarr që unë të t'i fshij lotët e dashurisë dhe të të pëshpëris pa fund: - Të dua. Të dua. Të dua - Mbreti im. Ëndrra ime. Shpirti im. Me ato buzët e holla, me vështrimin e thellë, misterioz, me bebet e zeza dhe të ëmbla, poshtë ballukeve të verdha. Asgjë tjetër. E di! E di, por nuk mundem! Ne jemi dy botë që kurrë nuk mund të takohen. Jemi dy paralele që ecin në dy dimensione të ndryshme."

Ajo e hapte derën përherë duke buzëqeshur, dhe ai, për të njëqindën herë rrinte pranë saj, e puthte, e përqafonte. E përkëdhelte. E dashuronte me zjarr.

Ai rrinte brenda shtrojeve. Ishte ftohtë. Dimër, vetmi. Jashtë era plot ngricë fshikullonte xhamat e akullit. Fishkëllente fort era e nëntorit. Ajo ishte larg. Flinte diku mes reve. Në një dhomë mes tokës dhe qiellit. Por ai e dinte që jetonte në të njëjtin qytet. Ndaj e dashuronte atë qytet. Atë rrugë. Ato pemë.

Pastaj, tek mblidhej mes shtrojeve të ftohta, fillonte dhe krijonte filma. Filma abstraktë. Ai ngjitej plot tmerr tek shkallët e saj, dhe ajo i hapte portën. Ç'derë parajse ishte ajo? Ishte e mundur aq shumë dashuri në gjoks?! Buzëqeshja e saj plot diell, ndritja e flokëve ngjyrë gruri të pjekur, sytë e zinj dhe të thellë, zëri i saj plot grimca drite.

Rrinte me orë i kredhur në ëndërrime. Kënaqej me atë sflitje joshëse. Ushqente shpirtin e tij të dashuruar.

Ishte kjo dashuria vallë? E pashë. Më pa, dhe me një shkëndijë dashurore, zemra ndizej krejt?

Ishte kjo dashuria? Kur veç një buzëqeshje e saj, mund të ndizte lumturinë më të egër? Ishte kjo, dashuria?

Pa fjalë, pa prekje, pa puthje, pa premtim? Veç shikime. Dy botë fare të largëta por edhe fare të afërta?

Ishte kjo dashuria?

Sa Dante, Kastadiva dhe sa Tonio e Virgjilë. Sa Laura dhe Anna Karenina. Sa De Muset dhe Haine, e Van Gogh-ë, kishin dashuruar vallë në këtë formë? Dashuronin vallë kaq marrëzisht veç shpirtit e mëdhenj? Sa Petrarka dhe Hugo, sa Lasgushër kishin dashuruar ashtu vallë? Sa Romeo e Xhuljetë, ishin shkrirë vallë nga afshi i ëndërrimeve, ku prekja mashkullore kish qenë veç një dëshirë e zjarrtë? Dashuri pa finale mishi. Veç ëndërr kimike, kimerë në ngritje. Vruull pasioni pa konsumim me ofshama.

Sa të lumtura ishin ato që e njihnin nga afër? Sa i lumtur ishte vallë jastëku ku ajo mbështeste kokën. Të ishte një foto në dhomën e saj, gjatë atyre dhjetë stinëve

# RRËFIMET E NJË DASHNORI

*Tregim nga Artur Spanjoli*

vendimtarë, sa zgjati tmerrin. Derisa ajo iku përgjithmonë. U tret në botën e madhe. Të ishte pjesë muri e dhomës së saj, copë gëlqerje, veç ta shihte pa mbarim. Dante do të dinte ta këndonte, me siguri si e meritonte. Të ishte libri ku ajo drejtonte sytë. Ato sytë e thellë. Të zinj. Tepër të ëmbël. Sy engjëlli prej mishi. Ai vështrim i mprehtë, me vetullat si krahë dallëndysheje. Ishte e çuditshme?! Dashurohej mishi apo shpirti? Dashurohej zëri apo fjalët? Ai i dashuronte të gjitha. Për sytë e tij të magjepsur ai trup, ajo lëkurë, ato forma mishi prej tetëmbëdhjetë vjeçarje, ishin hyjnore. Ishin kozmike. Ishin qiellore. I dëshironte me një zjarr që digjte fort ato forma, atë trup. E dukej diçka absurde. Nuk e njohte fare nga afër. Nuk kishte pasur kurrë rast t'a njohte nga afër. Kish dashur, po. Por e kishte humbur fare toruan, siç mund të dashuronte njeriu veç 19 vjeç. I mungonte në çdo grimcë të trupit të tij të zhuritur. Të tjerët. Ato që asgjë nuk ndjenin? Ato pra, që jetonin rreth saj, si nuk e shihnin atë dritë? Ato mund të lumturoheshin pranë saj. Ato mundeshin. Ndërsa ai, që po digjej i gjallë. Ai nuk mundej. Nuk ishte absurde e gjitha kjo?!

Ishte kjo dashuria vallë?

Martirizimi total, humbja kryekëput e çdo dinjiteti?! Ç'mund të dinte vallë tetëmbëdhjetëvjeçar? Nuk dinte asgjë. Gjithçka është aq naive, por edhe aq e pafundë në atë moshë.

Mendonte këto gjëra tek rrinte duke parë tavanin. I plogësht, i zbehtë, i mbyllur. Me lot ndër sy. Pasiv dhe fare i zhgënjyer. Zhgënjimi e kishte pushtuar gjithkund. Një zhgënjim i thellë, pa skaj. Por ai zhgënjim mishi, në jetën reale, kishte filluar të ishte edhe triumfi i zbulimit të vetvetes. Kishte zbuluar një botë krejt të re. Një botë fantastike. Horizontet e imagjinatës së tij i kishin rritur dimensionet e perandorisë së shpirtit. Ngjyrat e emocioneve të tij ishin shtuar, ishin shumëfishuar. Ishin bërë të thella. Të pafunda. Nuk ishte kjo një rilindje, një prezantim i pafundësisë së njeriut? Nuk ishte kjo një zbulim i madh. Një pafundësi, ku ai mund të lundronte me imagjinatën e tij, pa e gjetur kurrë kufirin. Veç se ishte i rrënuar tërësisht. Tempulli i tij, i trishtë, jehonte me tinguj vaji. Ishte tërësisht i

vdekur brenda. Ecte nëpër rrugë me vdekjen në gjoks. Ishte dashuria e pafatë, e cila nuk kishte pasur as përgjigje dhe as ngushëllim. Askush nuk e kishte ndihmuar. Ndaj qante i vetmuar mes perëndimesh që ulërisnin dhimbjen dhe vetminë. Zëri i dashurisë së errët.

"Ç'do të thotë kjo ndjenjë? Ti as nuk e njoh fare?"

- Nuk e njoh por ja që më kapi. Më zuri në distancë.

- Dashuri e pamundur?

- Dashuri e pamundur.

Si mund të dashurosh aq pafundësisht idenë, imazhin e një femre të cilën as nuk e ke takuar kurrë? Veç e ke parë nga larg, me adhurim, krejt i bërzhitur. Krejt i magjepsur nga bukuria e saj 16-vjeçare.

- Nuk e di. Nuk e shpreh dot. Kush i njeh sekretet e dashurisë. Ndodhi dhe aq!

- Si, ndodhi?!

- Nuk ishte hera e parë. Kisha rënë në dashuri në këtë formë edhe herë të tjera. Shumë herë. Loja fillonte me shikime, nga larg. Më pas filloja të përgjumësha dhe e ëndërroja me zjarr. Si duket është një gjendje natyrale e përbërjes time thelbësore. Veç se kjo, ishte më e tmerrshmeja. Nuk doja. Shkoja drejt saj fatalisht. Pa shpresë. Si i magjepsuri drejt sirenës. Si i droguari drejt dozës së shkatërrimit. Ishte diçka tepër e madhe. Sikur të dëshiroje me zjarr të ishte princ. Fëmijë mbreti, kur e dija mirë se kisha lindur, veç një fëmijë i thjeshtë populli. Vija nga një familje punëtori.

E dije që ishte një iluzion?!

E dija po s'më interesonte. E dija me logjikën rationale. Por pasioni, ndjenja mori dhenë, mori timonin në dorë dhe as nuk e përfilli fare arsyes. I dha shkelmin arsyes, e cila u aneksua dhe nuk kishte më, asnjë farë pushteti në atë simfoni dramatike plot vdekje, e cila po luej në muzgun tim. Kur zemra do, aq i bën. Ajo veç dëshiron të përgjume me lot ndër sy, dhe të ëndërrojë. Ajo do të flijohet. Do të vdesë në emër të dashurisë. Po! Dëshira e saj e vetme është martirizimi total i qënies.

Absurde!

- Sa gjëra absurde ka në jetë.

- Si Dante!

- Po

- E pastaj?

Pastaj pafuqia, dhe dëshira e squllur, mos ta shihja më. Ajo ishte tepër e madhe, por fare e pamundur. Unë, shkoja drejt saj veç me mendimin që të vuaja. Doja veç ta shihja prap. Por, kur zuri atë tjetrin, ate bukuroshin, si u hap fjala. Kur e mora vesh, atëherë, me shumë sforcim. Me shumë mund arrita t'i mbushja mendjen vetes se duhej të bëhesha mënjane. S'kishte më kuptim. Por, ç'kohë madhështore kisha jetuar. Ishte një kohë fare madhështore. Ishte koha më e egër, por edhe ajo me më me plot ndjenjë, që kisha kaluar ndonjëherë në jetën time. Kohë e madhe dashurie. As të gjitha këngët e rruzullit nuk arrinin të më ngushëllonin. As edhe të gjitha poezitë e tokës nuk ma gjenin dot ilaçin. Lexoja si i tërbuar. Pa e mëshiruar veten. Doja të pikasja, të njihja të gjithë fatlumët si puna ime nëpër botë. Doja t'i mbushja mendjen vetes, se nuk isha i vetmi. Se kishte edhe të tjerë që kishin vuajtur si unë. Nuk ishte fundi i botës. Ishte ndoshta fillimi i saj.

- Do ta bëje përsëri një gjë të tillë? Po të kishe mundësinë pra. Do ta përsërisje akoma një eksperiencë të tillë?

- Kurrë! Nuk do kishte kuptim. Nëse do të mbetesh pa dinjtet. Nëse do të poshtërosh vetveten. Nëse do ta humbësh kryelartësinë tënde, rend atëherë mbas një historie të tillë. Kurrë mos ardhë.

Jetoja si i humburi. Si i mbytur në lumë. Si i mpiuri, si i trullasuri nga gjumi. Isha krejt i ngrirë nga frika. U bëra edhe me fiksime. Mu shfaqën disa njolla nën lëkurë. Njolla gjaku. Kisha parë në atë kohë një film. "Pranvera nuk erdhi vetëm" me një aktore. A. Markajan, personazh, e cila ishte e sëmure me leuçemi. Thellë-thellë isha i bindur se edhe unë e kisha atë sëmundje. Shihja njollat e gjakut tek duart dhe u tmerrrova. Edhe aktorja tek filmi kishte pasur një simptomë të tillë. Kam jetuar me këtë frikë të fshehtë për muaj të tërë. Në të vërtetë fiksimi ishte një tjetër. Ishte ajo. Vajza e largët, e cila jo vetëm nuk ma vari kurrë, por filloi të më marrë inat, për të mos thënë që unë, në vend që t'i ngjallja mëshirë, i ngjallja neveri dhe ndoshta urrejtje. Ndërronte rrugë e shqetësuar, sapo më pikaste nga larg. Nuk dilte kurrë vetëm në rrugë. Një herë e ndoqa si idiot. Kisha hedhur në të pastër poezitë e para për të. Ishte shtator. E ndoqa derisa u fut tek pallati i saj me të motrën. Darkave dilnin deri poshtë tek Vollga. U ngjita shpejt si kaproll nëpër shkallët e pallatit të saj, dhe i ndalova në kat të dytë tek ngjiteshin.

"Kam shkruar këto poezitë për ty!", i thashë si idiot, me duart që më dridheshin. "Ik qërohu!", mu kthye ajo me tërë forcën e shpirtit. "Mos të të shoh më me sy!" Kjo ishte përgjigje e shkumbit tim shumëmuajor. Ika i vrarë krejt në shpirt. Nuk e kam menduar kurrë vetëvrastjen edhe pse vuaja si i dënuari në ferr. Ndoshta për mendjen e kokës. Më mjaftonte që ajo jetonte në të njëjtin qytet. Në atë periudhë doli në qarkullim romani i Markezit: "Dashuria....." gjeta vetveten aty. "Zot" mendova. "Nuk qënkam i vetëm!". Më pëlqeu historia, por e kuptova se shkrimtari e kishte shkruar historinë siç e kishte dëgjuar. Nuk e kishte jetuar një gjë të tillë. E kishte përshkruar nga jashtë, jo si Dante, nga brenda. Dukej që ishte shkrimi i një njohësi të shpirtit njerëzor, por veç nëpërmjet eksperiencave të njerëzve të tretë. "Po ta shkruaja unë, do t'a shkruaja më mirë!", mendoja. Por libri ishte një ngushëllim i madh për shpirtin tim dramatik dhe mjeran. Veç ç'mjerim sublim! Më vonë jetova, njoha, dashurova shumë vajza, por kurrë më nuk ndjeva zemërcjerrjen aq ulëritëse të atyre kohërave. Qiejt në perëndim, ishin zemra plot gjak. Mbushur me tmerr të gjallë. Netët, vetmitare. Ishin fare dramatike skulpturat e harresës, zhytur në qiej të panjohur. Sa nuanca ka shpirti vallë? Sa mjerime ka trishtimi? Po dhimbja, e cila me siguri është kozmike?



**JEMI GJALLË GJER  
NË MBRËMJE**

Jemi gjallë gjer në mbrëmje  
dhe të gjallë endim një litar gjer në  
qiell  
mbahemi, kalamendemi lehtë  
mbahemi, shpirtin thurim me diçka  
pastaj në mbrëmje shtrihemi në shtrat  
me kujtesën e qiellit si brengë të pam-  
baruar.

Mandej flemë e shohim një ëndërr  
sikur jemi gjallë gjer në mëngjes.

Aty në ag zgjohemi, e kujtojmë  
dashurinë.  
Se jemi gjallë. Prandaj jemi gjallë.  
Gjer në mbrëmje, sërish.

**SHI I VJETËR**

Bie shi, pluhuri i vjetër bëhet baltë e re  
Bie, mbi kujtesën e vjetër që shkrihet  
me kujtesën e re  
Dhe, kurrë pa qenë të vjetër nuk  
bëhemi të rinj  
Dhe, kurrë pa qenë të rinj nuk bëhemi  
të vjetër.

Bie shi, po ne s'na tret as dheu.

**SHENJË**

Asnjë shenjë s'mbajnë këto rrugë,  
hapin dje,  
hapin sot,  
hapin nesër,  
as pikën e ndryshimit, o Zot.

Asnjë shenjë s'ruajnë këto rrugë,  
kohën dje,  
kohën sot,  
kohën nesër,  
as pikën e nisjes, o Zot.

Asnjë shenjë s'bëjnë këto rrugë,  
jetën dje,  
jetën sot,  
jetën nesër,  
as ahtin prej trupi, o Zot.

Për dashurinë e frymën, jepna një gjur-  
më, o Zot!

**ZEMRA BRINJËSH**

Me zemër mbushen plasaritjet.  
Tinguj e ashte ndijohen  
si një betejë e vogël për frymë.

Shtrengim.

Dhe muskuli ka zaptuar qelën e vet,  
teh më teh.  
Dhe kockat kanë pushtuar prenë e  
tyre,  
rreth e rreth.

Shtrengim.

Dhe koha e ha lirinë e trupit.  
Dhe trupi e ha fuqinë e shpirtit.  
Dhe shpirti e ha palcën e kohës.

Si një betejë e madhe për frymë.



**LUFTA  
PËR FRYMË**

Cikël poetik nga Erina Çoku

**BRINJA**

Në mesnatë ndodh, në mesnatë,  
kruspullohem e shndërrohem në  
brinjë  
në brinjën tënde të munguar,  
atë që humbe  
në marrëveshjen hyjnore kundër vet-  
misë.

Ngadalë hyj turjelë në kurmin tënd,  
dhembje dëshire pa asgjë mangut  
me kujtesën e mishit tim në mishin  
tënd  
me harresën e shpirtit tim në shpirtin  
tënd  
frymë e shndërruar në kockë të pa-  
tretshme  
që filloi botën.

Ngadalë puthitem në fillesë me ty,  
dhe lëkura jote më njeh e para  
dhe mishi yt përletet sa më ndjen ende  
të ngrohtë  
dhe kockat e tua më puthin me mall  
dhe shpirti yt mallëngjehet sërish  
puthje e plagë në kraharor.

Në mesnatë ndodh, në mesnatë,  
jam një brinjë e jotja e pashmangshme  
thellë në kujtesën e trupit tënd të valë,  
jam shpëtimi yt i parë,  
jam njësh me ty,  
jam brenda teje.

**CILËN JETË?**

Çdo ditë jetojmë jetën tonë të vogël,  
duke u pyetur për jetën tonë të madhe  
ndonjëherë ndalemi:  
shohim majtas, shohim djathtas  
ngremë kryet lart, ulim kryet poshtë.  
Jeta jonë e madhe fragmentohet në  
jetën tonë të vogël.

Çdo ditë diçka pa njësi matëse na  
ndodh  
dhe nuk dimë cilën jetë jetojmë vërtet,  
dhe nuk kuptojmë:  
përgjigjet janë të vogla, apo pyetjet të  
mëdha?  
Jeta jonë e vogël nuk na lë të shohim  
jetën tonë të madhe.

Çdo ditë, çdo natë, jetën  
me trupin e frymën tonë e ushqejmë.

**JETË SA NJË PUTHJE**

E gjithë jeta brenda trupit tënd shkon  
E gjithë jeta, një aht në fund.

Në fyt rritet baticë deti yt  
Prej fytit botën ujë ndërton sërish.

E gjithë dashuria në trupin tënd mbli-  
dhet  
Që shpirti prej goje botën të ushqejë.

Nëse të puth, jetën me jetë të kam  
puthur  
Nëse të puth jam fillimi e mbarimi yt.

E gjithë jeta një aht.  
E gjithë jeta një aht.

**MESNATË**

Çdo natë jeta ime mbaron  
e heshtja shtrohet mbi botë  
mbulojë që ndan kufijtë  
lart atje - poshtë këtu.

Çdo natë jeta ime  
mblidhet në kukule  
e s'di në gjallë del  
fluturim me frymë.

Çdo natë  
sytë mbyll në kutinë e kohës  
e nuk e di mbarimin  
e nuk e di zgjimin.

**METRONOM**

Ty që zgjimin lajmon, lajmon  
Ty të urrejmë a të duam më fort?

Thirrja valë-valë na preket në trup  
Zgjohu-zgjohu! Eja me ngut!

E çka më fort nervin e ther?  
Kur zgjimi prej trupi çahet e del?

Zgjohu! Zgjohu! Përse? Përse?  
Ajo që është sot prapë do bëhet dje.

Luhatem ndërmjet, kohën e mas  
Jeta bën tik, vdekja bën tak.

E mbahem fort në një kuti  
Zgjues, armiku im je ti.

Të dua me dritë se drita s'më dhemb  
Por po jetova, e sigurt do vdes.

E nëse vdes do zgjohem sërish  
Se vdekja bën tak e jeta bën tik.

**ZEMRA FORT**

Hesht.  
Dëgjo si shpërbëhesh nën lëkurë.  
Fjalët nuk ndërtojnë asgjë.  
Zemra fort.

Ndiej.  
Valë rrethore mes dy lëkurëve.  
Grimca japim, grimca marrim.  
Zemra fort.

Prek.  
Jeta shket mbi lëkurë.  
Koha e mbledh.  
Zemra fort.

Zemra,  
mbi dashurinë do plasë,  
e kuqe dhe e ngrohtë.  
Fort.

# DOSJA E ORFEUT

Nga Ismail Kadare

Orfeu ishte përgatitur në fshehtësi të plotë. Përveç një ndryshimi që i kishte bërë lirës, asgjë tjetër s'ishte marrë vesh. Ndryshimi kishte të bënte me numrin e telave: nga shtatë i kishte çuar në nëntë. Në krye ishte marrë si diçka e thjeshtë, më pas nisi të pëshpëritej se kishte gjasë të quhej më e madhja risi e shekujve të fundit.

Muzikanti ishte tepër i famshëm, kështu që nuk përjashtoi që lajmi për shpikjen e tij të fundit të zinte një vend në kronikën olimpiane. Orfeu e duam të gjithë, flitej se kishte thënë Zeusi. Megjithatë, s'mund t'i lejojmë gjëra që s'ia lejojmë askujt. Aq më tepër që nuk e ka bërë të qartë përse i duhen ata dy tela të tepërt. Unë vetë mbase jam i shijes së vjetër, por mendoj se të gjithëve na është mësuar veshi me lirën e moçme shtatëtelsh.

Nga e majta e tij, Prometeu, nga i cili nuk pritej veçse miratimi i çdo akti rebelues, rrinte shpërfillës. Ishte Apolloni, për çudi, zakonisht i matur, që i kishte dalë në mbrojtje artistit. Madje, me aq zell, sa që jo vetëm ishte për miratimin e risisë, por kishte shkuar më tej, duke kërkuar që numri i muzave të shtohet gjithashtu nga shtatë në nëntë, për t'iu përshtatur asaj.

Debati, që edhe pa këtë kishte qenë i ashpër, u acarua më fort. Trille artistësh, thoshin kundraorfeianët. Sot duan dy tela shtojcë, nesër kushedi ç'mufka do të kërkojnë. Së paku, të shpjegoheshin, ndërhynte hyu i luftës. Te ne, kur shqyrtohen modelet e reja të armëve, gjërat janë të qarta. E do heshtën dy pëllëmbë a dymbëdhjetë pëllëmbë më të gjatë, se kështu ia bën gropën më mirë kundërshtarit? Okej. Ndryshe, s'kemi kohë për sofizma.

Britmat pro e kundër, lërin artistët në punë të tyre, i lëmë, i lëmë, por pastaj na ndodh hataja, si mijëvjeçarini që shkoi, zotëruan një copë herë, gjersa Zeusi, i lëkundur siç qe atë ditë, e shtyu vendimin. Zeusi dinte, me sa dukej, diçka, që të tjerët ende nuk e dinin.

Vëmendja e të gjithëve u përqendrua në Olymp, në atë javën e paharrueshme, kur nuk flitej veç për hallin e Orfeut. S'ishte vetëm çështje e miratimit ose jo e shpikjes së tij. Ishte diçka tjetër, ajo që e dinte vetëm Zeusi: sëmundja e së fejuarës së re të muzikantit. Ajo zbehej çdo ditë, kishte dhembje gjithkund, sidomos në gjoks. Ajo që askush, duke përfshirë edhe Zeusin, nuk e dinte ishte se ç'lidhe mund të kishte sëmundja e vajzës me dy telat e shtuar të lirës.

U desh një kohë e gjatë, që e vërteta të pikonte, sidomos pas vdekjes së Euridikës. Orfeu nisi të kërkonte diçka të pamundur: kthimin e saj nga përtejvarri. Artin që gjer atëherë e kishte shpenzuar për famë dhe për dërim, tani po e përdorte veç për nxjerrjen e lejes së vështirë. Iu desh të mallëngjente me këngëtimin e tij ministrat e Ferrit, gjersa të dëgjohej prej Hadesit vetë. I verbri ishte prekur nga zëri i artistit, po aq sa nga sajdisja që iu bë. Të mësuar me Olympin luksoz, artistët rrallë kujtoheshin për sketërrën. Por Hadesi s'ido të hakmerrej për shpërfilljen. Përkundrazi, do të bënte çmos ta ndihte. Madje, pa i kërkuar asgjë nga ato që pëshpëritnin gojë e liga, një himn kushtuar sketërrës, për shembull, a ndonjë koncert falas për të vdekurit. S'ishte nga ata Hadesi, dinte të tregojë xhentëlmen, ndonjë çështja nuk ishte e lehtë. Asnjë banor i ferrit nuk kishte dalë kurrë prej tij. Megjithatë, Hadesi kishte bindjen se pengesat, sado të rënda, ishin të kapërcyeshme, me përjashtim të Cerberit, qenit të portës. Jo, nuk shtruhej çështja që Orfeu i famshëm të këndonte apo jo përpara një qeni. Edhe po të bindej ta bënte, për hir të Euridikës, s'dihej a do të arrinte një përfundim. Qeni ishte i një race të panjohur, i pandjeshëm ndaj çdo ndërhyrjeje tokësore a hyjnore.

Ndoshta kishte një shpresë, kishte thënë Orfeu. Dhe i kishte folur për risinë që kishte dashur t'i sillte muzikës, me ata dy telat e famshëm. Hadesit diçka i kishte zënë veshi, por turbull.

Në kohën që Orfeu kishte parandier se fati po i përgatiste ditët e këqija, pa e shpallur se do të ngrihej kundër tij, si njeriu që kërkonte të pajisej me një vegël shpëtimi, po shtyhej drejt kërkimit të një muzike të paarrishme.

Enigma e dy telave, ajo që kishte torturuar atë verë kureshtarët e Olympit, ç'ishin vallë ata dy tela, përse, për çfarë hynin në punë, do të zgjidhej më në fund.

Hadesi tundte kryet krejtësisht mosbesues. Qeni Cerber, ai që Orfeu shpresonte të zbutte me këngën e tij, në jetë të jetëve nuk do të lejonte kurrë askënd të dilte nga porta. Nëse kishte ende një shpresë, ajo s'lidhej kurrë me zbutjen, por me vënien në gjumë të shtazës.

Orfeu kishte bindjen se mund ta bënte. Paç fat, i kishte thënë Hadesi, përpara se t'i shpjegonte kushtin e fundit. Ishte një pakt i detyrueshëm midis Orfeut dhe atij vetë, Hadesit, thënë ndryshe Mortit. Një pakt, në dukje i thjeshtë, përmbushja e të cilit nuk varej veçse prej atij vetë, Orfeut.

Nëse varet prej meje, do ta përmbush, sado mizor të jetë.

Do ta shohim, tha Hadesi dhe me fjalë të pakta ia tha paktin...

Ashtu si për dy telat e shtuar, ishte folur gjatë për të. Kishte a s'kishte pakt të fshehtë? E nëse kishte, përse nuk tregojë?

Siç pritej, zhurma u fashit kur e vërteta doli në dritë. Kishte një pakt vërtet. Dhe si çdo pakt klasik ishte i thjeshtë. Pas vënies në gjumë të Cerberit, Orfeu do të plotësonte një kusht të vetëm: gjatë daljes nga ferri, nuk do ta kthente kryet për të parë të fejuarën, që i vinte pas. Ky ishte thelbi: sado mall të kishte, sado padurim, nuk do ta kthente kryet. E kthente, e humbte. Në jetë të jetëve.

Shumicës së olimpianëve, pakti iu qe dukur i lehtë. Një moskthim koke vetëm. Të ishte, së paku, që ta kishte nusen në shtrat e mos ta prekte dot, hajde de. Zhurma për lehtësirat që u bëheshin artistëve, në kohën që të tjerëve, për një gabim të vogël, iu thyheshin brinjët, u përtëri kudo. Gjer ditën kur erdhi lajmi se Orfeu e kishte humbur shansin. Kur e fejuara e kishte thirrur me mall, s'kishte duruar dot pa kthyer kryet. Disa ia qanin hallin: i gjori, malli i madh e kishte vënë poshtë, të tjerët e qortonin, si shumë i dobët paskësh qenë, punë artisti.

Një palë e tretë, nga ata që flisnin rrallë, kishin tjetër mendim. Ishin të bindur se pakti kishte qenë i rremë. Kurrfarë Euridikeje nuk i vinte pas, në çastin që Orfeu kapërcente pragun e sketërrës. Kthimi i kokës kishte qenë një si gjetje e djallit. Thelbi i tij përbëhej nga një mohim. Një mos i pafund.

Nga mosvështrimi prej Orfeut, e fejuara e tij mernte jetë. Kurse nga vështrimi mernte mort. Gjithçka ishte mbrapsht në këtë histori. Prej mospamjes, Orfeu bëhej një ringjallës. Prej të kundërtës, një vrasës.



Mund të ishin të dy në këtë botë, por me një kusht: që të mos shiheshin kurrë. Shprehja e famshme, të jesh a të mos jesh, në këtë rast do të ishte: të mos jesh që të jesh. Pra, sido që ta merrje, në të gjitha rastet nuk kishte veç një ngadhënjim të asgjësë dhe Orfeu s'mund të ishte veçse i humbur.

Kurrfarë Euridikeje nuk vinte pas Orfeut në çastin e kapërcimit të pragut të ferrit.

E në rast se Orfeu nuk binte në kurth? mund të pyeste një zë kundërshtues. Me fjalë të tjera, në rast se, duke i besuar paktit, nuk e kthente kryet, ç'ndodhte pastaj? Do të zbulohesh më në fund se Euridike s'kishte pasur dhe se pakti paskësh qenë i rremë?

Kjo ishte e pamundur... Rruga do të ishte e gjatë. Në pakt, me sa dukej, nuk përcaktohej koha e moskthimit të kokës... Dihej, ndërkaq, se për një të mosqenë si Euridikja, pafundësia durohej lehtë, kurse për Orfeu s'ishte ashtu. Do të vinte një çast që do ta kthente kryet... Veç kësaj, s'duhej harruar se nata do të binte mijëra herë, në shumë shekuj rresht... Një zgjidhje tjetër mund të gjendej...

Ndonëse ndërtesa e teatrit nxinte, dramaturgut iu duk se brenda saj, diku në thellësi, regërinte një ndriçim i zbehtë. Iu afrua portinerisë së jashtme, asaj përbri oborrit, prej nga hynin aktorët dhe, për habitje e tij, bashkë me xixëllimën e cigares, dalloi në gjysmëmëter spikamën e njohur të portierit.

I tha mirëmbërës përpara se ta pyeste se a ishte dikush brenda apo i kishin bërë sytë.

Portieri iu përgjigj se hidraulikët po merreshin me një riparim, por ai, po të donte, mund të hynte.

E falënderoi dhe eci drejt hyrjes. Zakonisht, ulej aty nga mesi i sallës, midis radhës nëntë dhe trembëdhjetë, me sytë nga skena. Në fillim ia kishin marrë për trill, pastaj mani, pastaj krizë të krijimit, ndonjë fjalën "krizë" nuk e shqiptonte kurrkush. Ai vetë përpiqej të mos gjente ndonjë shpjegim. Thjesht ndihej mirë. Perden ngjyrë vishnje e kishte lehtë ta përfytyronte si rroben e gjatë të një zonje disi të fyer, s'dihej kur dhe prej kujt.

Ndenjëset kishin të njëjtën ngjyrë dhe kadifeja e lozhave, gjithashtu, duke përfshirë edhe qeveritarin.

Dramat e pakta të tij, përpara se t'i shkruante, ashtu i kishte përfytyruar pak a shumë, në sallën e zbrazët, me sytë nga skena.

Nga të dyja anët e saj, të ndriçuar më pak se vetë skena, ishin dy shkallina të jashtme. Zakonisht, nuk binin në sy, por, kur fenerët e zbehtë anash ndizeshin, spektatorët e dinin se do të kishte personazhe që do të ngjiteshin që andej. Me përjashtime të rralla ishin personazhe negative të krejt realizmit të pafund socialist, nga Berlioni në Shangaj. Ngjiteshin nga qilarët gjithë frikë, nga strehimet kundërajrore, baret e natës plot zvetënim ose nga vetë sketërra. Hidraulikët të dyshimtë, spiunë të NATO-s, komplotistët të zbuluar prej plenumit të tetë, të njëmbëdhjetit, madje të dytit, atij për të cilin shumë njerëz ishin të bindur se nuk ishte bërë kurrë, shfaqeshin pikëllueshëm. Nuk vononin pas tyre priftërinjtë katolikë, horrat me lavret e tyre, madje hija e mërzhitur e mbretit Zog.

Në të vërtetë, më shumë se te skena, dramaturgu e kishte shpresën tek ato shkallina. Natyrisht, nëse fati nuk e kishte braktisur.

Ndriçimi i fenerëve po luhatej si nga një frymëmarrje e fshehtë. Mos u ndal e bekueme, tha me vete, pa e ditur pse, në shqipe të vjetër.

Hija e dikujt që po ngjiste shkallinën, i duk përpara se të shfaqej njeriu vetë. Dramaturgu e kuptoi se ishte pikërisht ai që kishte pritur. Në dorë mbante lirën e moçme, dy telat e shtuar të së cilës, si çdo shtesë metalike e mëvonshme, dalloheshin që larg.

Me frymëmarrje gati të ndalur, ai ndiqte atë që po ndodhte. Do t'i vinte vallë pas e fejuara, ashtu siç dihej nga të gjithë, apo Euridike s'ido të kishte?

Humbjet e mëdha ne i krijojmë vetë, mendoi. Dhe, po në atë çast, disa hapa pas njeriut me lirë të riparuar, u duk vajza. Bëri një mënjanim për të mos shkelur trupin e Cerberit të fjetur, pastaj kokulur, si shumica e nuseve ballkanase, eci pas Orfeut.

Mos, thirri dramaturgu së brendshmi. Ishte një "mos" i njohur miliardash, prej të cilit njerëzimi nuk shkëputej dot: mos kthe kryet, në s'ido që ta humbsh!

Orfé, foli vajza me zë të fikur.

Dramaturgu mbylli sytë për të mos e parë atë që do të ndodhte.



Të gjithë miqtë kishin zënë vend rreth tryezës së shtruar për vaktin e mëngjesit, kur Muriel Arbuthnot u fut në dhomë me hapa të mëdhenj duke mbajtur shtrënguar në dorë postën e ditës. Ajo veçoi një zarf të madh në ngjyrë të bardhë dhe ia dorëzoi atë mikeshës së saj më të mirë.

Një çehre e çuditshme ra mbi fytyrën e Anna Clairmont. Kush mund ta dinte vallë se këtë fundjavë ajo po e kalonte me familjen Arbuthnot? Syri i kapi menjëherë stilin e shkrimit të dorës, ndërsa mendjehollësia e tij e bëri ta vinte buzën në gaz. Atë çast shpresoi se i shoqi, Robert, i cili ishte ulur në fund të tryezës, nuk e kishte vënë re; në fakt, ai po lexonte gazetën The Times dhe ishte zhytur në të.

Teksa vazhdoi t'i hidhte një shikim të kujdesshëm të shoqit, Anna u përpoq ta hapte zarfin duke kaluar gishtin e madh të dorës te cepi i tij, por papritur, Robert hodhi vështrimin në drejtimin e saj dhe i buzëqeshi. Ajo ia ktheu buzëqeshjen, lëshoi zarfin mbi prehër, dhe pasi kapi pirunin, e nguli atë në kërpudhën e vakët. Për aq kohë sa i shoqi vazhdoi të qëndronte prapa gazetës së hapur, ajo e la zarfin të prehej mbi gjunjë. Në momentin që i shoqi iu kthye faqave të biznesit, ajo e vendosi zarfin në dorën e djathtë, ngriti lart thikën e gjalpët dhe e rrëshqiti atë butësisht në cepin e zarfit ku fillimisht kishte vënë gishtin e madh. Pak nga pak, ajo filloi ta hapë zarfin. Me të mbaruar, rivendosi thikën në vendin e saj, anash pjetës së vogël me gjalpë.

Përpara se të bënte lëvizjen tjetër, ajo hodhi rishtazi një vështrim në drejtim të të shoqit për t'u siguruar se ai vazhdonte akoma të ishte i kapluar nga gazeta që mbante hapur. Ishte.

Ajo uli zarfin poshtë me dorën e majtë, ndërsa me të djathtë, me shumë kujdes, nxori letrën që ishte brenda tij. Më pas, zarfin bosh e futi në çantën që kishte aty pranë.

Anna uli sytë nga letra e markës Basildon Bond, ngjyrë krem, të cilën ajo e njihte mirë; ajo ishte palosur tri herë. Vijoi një shikim i shkujdesur në drejtim të Robert dhe meqenëse nuk po rrezikonte, ajo shpalosi letrën prej dy faqesh.

Letra nuk kishte as datë dhe as adresë, ndërsa cilësia e saj, si gjithmonë, ishte speciale.

'E dashura ime Titania.' Nata e parë e Ëndrës ishte përjetuar në Stratford, kurse nata në vijim kishte qenë nata e tyre e parë që ata fjetën së bashku. Dy të para në të njëjtën natë, kishte vënë në dukje ai. 'Jam ulur në dhomën e gjumit, dhomën tonë të gjumit, dhe po hedh në letër këto mendime vetëm disa çaste pas largimit tënd. Është kjo përpjekja e tretë, ngaqë fjalët e duhura për ta shpjeguar se si ndihem realisht, nuk po i gjej dot.'

Anna buzëqeshi. Që të bënte një pohim të tillë një njeri, i cili kishte bërë pasuri me fjalët, vërtet duhet ta kishte pasur mjaft të vështirë.

'Mbrëmë ti kishe gjithçka që një mashkull do të dëshironte nga një e dashur. Një bukuri ngacmuese, e ndjeshme, provokuese, lozonjare, dhe për një moment të përkryer, një zuskë e harbuar.'

'Kaloi një vit që atëherë kur u takuam në mbrëmjen e organizuar nga familja Selwyn në Norfolk, dhe siç ta kam thënë edhe herë të tjera, dëshira ime atë natë ishte që të të merrja me vete në shtëpinë time. Gjithë natën rri zgjuar në shtrat duke të imagjinuar të shtrirë në krah të Kumbullës së Thatë.' Anna hodhi shikimin përtej tryezës për t'u siguruar se Robert kishte kaluar në faqen e fundit të gazetës.

'Më pas erdhi takimi i rastësishëm në Glyndebourne – por u desh të kalonin edhe njëmbëdhjetë ditë të tjera përpara se ti, për herë të parë, ta tradhtojë Kumbullën e Thatë në kohën kur ai kishte shkuar në Bruxelles. Nuk e kuptova se si fluturoi ajo natë.

# LETRA

Tregim nga Jeffrey Archer

Përktheu nga anglishtja Aristidh Shqevi

'Nuk e imagjinoj dot se si do të reagonte Kumbulla e Thatë, nëse do të kishte parë të veshur si një shërbyese dhome. Ai ndoshta do të hamendësonte se ti gjithmonë e pastroje dhomën e ndenjjes në Lonsdale Avenue e veshur me një bluzë transparente të bardhë, pa sutiena, një fund të zi lëkure shumë të ngushtë e me zinxhir përpara, çorape të gjata me kuadrate, taka të larta, pa harruar buzëkuqin ngjyrë rozë dhe vërtet shokues.'

Anna ngriti kokën lart pa qenë e sigurt nëse po përflakej në fytyrë apo jo. Në qoftë se vërtet ai e kishte shijuar atë natë aq shumë, asaj do t'i duhej të dilte dhe një herë tjetër nga shtëpia për të psonisur në Soho, sapo të kthehej në qytet. Ajo vazhdoi leximin e letrës.

'E dashura ime, unë shijoj çdo aspekt të dashurisë tënde, por më duhet ta pranoj se ajo që ma ndez pasionin më shumë se çdo gjë tjetër, është zgjedhja që ti bën për vendtakimet tona gjatë pushimit të drekës që ti merr për një orë nga puna. I kam regjistruar të gjitha në mendjen time. Në ndenjset e prapme të Mercedes-it tim në Mayfair; në ashensorin e shërbimit në Harrods; në tualetin e restorantit Caprice. Sidoqoftë, më emocionuesja nga të gjitha ishte në atë llozhën e vogël në katin e dytë të teatrit në Covent Garden gjatë shfaqjes së operas Tristan dhe Isolde. Një herë përpara intervalit dhe më pas gjatë aktit final – u pa

ajo punë, shfaqja ishte mjaft e gjatë.

Anna qeshi nën hundë teksa vendosi me shpejtësi letrën në prehrin e saj, ndërkohë që Robert mprehu sytë pasi bëri mënjanë gazetën.

'Përse qeshe, e dashur?' pyeti ai.

'Qesh me fotografinë e James Bond, i cili zbret me parashutë mbi strukturën gjigante The Dome,' tha ajo. Robert mori një pamje të habitur. 'Në faqen e parë të gazetës që je duke lexuar.'

'Aha, e kuptova,' tha Robert teksa i hodhi një shikim faqes së parë, dhe pa buzëqeshur iu kthye sërish artikullit në faqen e biznesit. Anna rimori letrën.

'Ajo që më tërbon në lidhje me faktin se ti po e kalon fundjavën me Muriel dhe Reggie Arbuthnot, është mendimi që shtratin po e ndan me Kumbullën e Thatë. Jam përpjekur t'ia mbush mendjen vetes se, meqenëse Arbuthnot-ët kanë lidhje gjaku me familjen Mbretërore, ndoshta ju kanë vendosur në dhoma të veçanta gjumi.'

Anna tundi kokën në shenjë miratimi, sikur të donte t'i thoshte atij se parashikimi ishte i saktë.

'A është e vërtet se ai gërhet si trageti Queen Elizabeth II kur futet në portin e Southampton? E përfytyroj tani të ulur nga fundi i tryezës. Me xhakët Harris prej stofi të lehtë, pantallona gri, këmbishë me kuadrate, kravatë MCC, ashtu siç perceptohej e modës nga firma Hare and

Hound në vitin 1966.'

Këtë herë Anna ia dha një të qeshure me gjithë shpirt, por atë e shpëtoi Reggie Arbuthnot, i cili u ngrit nga ana tjetër e tryezës për të pyetur, 'A ka ndokush dëshirë që të formojmë një katërshë për të luajtur tenis? Sipas shërbimit meteorologjik, shiu do të pushojë së shpejti, ndaj koha është e mjaftueshme deri në mesditë.'

'Unë do të merrja pjesë me kënaqësi,' tha Anna teksa fshehu letrën në mbulesën e tavolinës.

'Robert, po ti?' pyeti Reggie.

Anna vuri re të shoqin që pasi palosi gazetën The Times, e vendosi atë mbi tavolinë dhe tundi kokën në shenjë mohimi.

O Zot i madh, tha Anna me vete. Ai ka veshur një xhakëtë stofi të lehtë dhe një kravatë MCC.

'Do të merrja pjesë me shumë dëshirë,' u përgjigj Robert, 'por për fat të keq më duhet të bëj disa telefonata.'

'Të shtunën në mëngjes?' u hodh Muriel, e cila, e ngritur në këmbë pranë një komodine të gjerë plot me ushqime, po mbushte pjetën e saj për herë të dytë.

'Kam frikë se po,' u përgjigj Robert. 'E dini si është puna, kriminelët nuk punojnë pesë ditë, pra dyzetë orë në javë, dhe as që presin që avokatët e tyre të bëjnë të njëjtën gjë.' Anna nuk qeshi. Në fund të fundit, ajo e kishte dëgjuar atë të shprehej kësajsoj çdo të shtunë në shtatë vitet e fundit.

Robert u ngrit nga tryeza, i hodhi një shikim ngulmues bashkëshortes dhe pastaj tha, 'nëse ke nevojë për mua e dashur, do më gjeshtë në dhomën time të gjumit.'

Anna miratoi me kokë dhe priti derisa ai u largua nga dhoma.

Ajo ishte gati që t'i kthehej letrës, por papritur vuri re se Robert kishte harruar syzet mbi tryezë. Aty për aty mori vendimin që t'ia çonte syzet sapo të mbaronte mëngjesin. Vendosi letrën mbi tavolinë përpara vetes dhe filloi leximin në faqen e dytë.

'Më lejo të tregoj se ç'kam vënë në plan për fundjavën e përvjetorit tonë, për aq kohë sa Kumbulla e Thatë do të jetë në Leeds. Kam porositur një dhomë në hotelin Lygon Arms, bëhet fjalë për të njëjtën dhomë ku së bashku kaluam natën tonë të parë. Këtë radhë kam blerë bileta për All's Well. Kam dhe një plan tjetër që synon shmangien e monotonisë me t'u kthyer në Stratford, dhe konkretisht në dhomën tonë në fshatin Broadway.

'Dua të më lidhësh në një krevat të madh të rrethuar me perde dhe të qëndrosh mbi mua e veshur me uniformën e një polici rreshter; xhore, bilbil, pranga; të veshësh një korse të ngushtë e të zeze me kopsa të argjendta përpara, të cilat do t'i zbërthesh për të zbuluar një palë sutiena të zeza. Së fundi, e dashur, nuk do të më zgjidhësh derisa unë të detyroj të ulërih me gjithë fuqinë e zërit, ashtu siç bëre në parkimin nëntokësor në Mayfair.

'Mirupafshim,

'I dashuri yt Oberon.'

P.S. Jam kureshtar ta di se me se po merret tani Kumbulla e Thatë.'

Anna ngriti kokën lart dhe pa se gotat e Robert nuk ishin më në tryezë.

'Cili horr mund t'i shkruante një gruajë të martuar një letër kaq të turpshme?' pyeti Robert teksa rregulloi syzet mbi hundë.

Anna ktheu trupin dhe u tmerrua kur pa të shoqin që po qëndronte në këmbë prapa shpinës së saj; letrën po e shikonte me ngulm, ndërsa balli i ishte mbuluar me bula djerse.

'Mos më pyet mua,' u përgjigj Anna me gjakftohtësi në të njëjtin çast që Muriel u shfaq krah saj me një raketë tenisi në dorë. Anna palosi letrën, ia kaloi atë mikeshës së saj më të vjetër, dhe duke ia shkelur syrin tha, 'Magjepsëse, e dashur, por për të mirën tënde vërtet shpresoj se Reggie nuk ka për ta marrë vesh kurrë.'



Rrogoshinë. Vjeshtë. Ndaloh në Rqendër. Asgjë nuk ka mbetur nga ëmbëltoja e “Malokut”. E vockël, si edhe vetë kaushi me akullore. Në anë të rrugës. Pranë shkollës sonë fillore. Pranim me padurim të vraponim tek ajo në pushimin e gjatë.

- Takohemi te “Maloku”.

Xhelali, poeti i Rrogoshinës, miku im që nga klasa e parë fillore, foli si të ishim një gjysmë shekulli më parë. Eh, koha pa fillim e fund.

- Djalosh, ku është lokali i “Malokut”?

Pyes një kalimtar. I riu më shikon me habi. Në aeroportin “Nënë Tereza”, kisha marrë një fiat të vogël me qira. Targën e ka italiane.

- Nga Italia vini?

- Jo, nga Amerika.

- Hera e parë?

- Po, në Rrogoshinë.

- Nga jeni?

- Nga këtu.

- Lokali është ky në anë. Parko te benzinata ngjitur.

Pallat madhështor. Modern. Kati i parë ka dyqane dhe një pijetore. Futebrenda, si të jem në rrugën 7, Uashington. Çdo gjë me shije. Arkitekturë moderne. Afrohet kamerieri, rreth të tridhjetave.

- Çfarë dëshironi të merrni?

- Kafe dhe një shishe uji. E njihni Xhelal Toskun?

- Po, i pari demokrat në qytetin tonë. Xhelal Tosku shfaqet te dera.

- Si gjithnjë, korrekt.

Përqafohemi me mall. Të dy të moshuar. Ka rrjedhur shumë ujë. Por, miqësia ka mbetur ajo. E fëmijërisë.

- Marrim nga një pije me ngjyrë.

- Me shumë kënaqësi, por jam në timon. Ti merr ç’të duash.

- Para se ta shkelim, le të bëjmë një foto.

Xhelali ngre në duar librin tim “Në sirtar”. Foton e vendos në “Facebook”. Sikur të ishte pas derës, Ylli Xhaferri komenton: “Sa do të dëshiroja të isha në atë tryezë me ju”.

Me Yllin flas shpesh në “Messenger”. Jeton në Tiranë. Megjithëse më i madh në moshë, disa vite, e kemi ruajtur miqësinë. Na lidhin librat. Ai mbaroi për letërsi. E caktuan mësues në një fshat të Kukësit. Fare i ri shkroi poezi. Pak ditë më parë folëm.

- Rilexova librin e Visarit, “Rrugët e ferrit”. Të ka përshkruar me dashuri. Te sheshi përpara gimnazit duhet të ngrihet bust. Brezat të mësojnë se në bankat e shkollës u formuan dhe heronj në kohët më të errëta. Antijetë. Dhe të ndihen krenarë.

- Visari është heroi i vërtetë. E arrestuan dhe s’foli gjë për asnjërin nga ne. Madje na mbrojti nga përbindëshat. Busti i tij duhet të ngrihet në një park të kryeqytetit.

- Ai shkruan se ti, vetëm ti nga grupi i poetëve, rrethi i shokëve, u thirre dhe e mbrojte.

- Ata më thirrën në ballafaqim. E unë e kam pyetur veten shumë: përse mua?

- U qëndrove. Nuk u theve.

- Të flasësh tani është e lehtë. S’e kam ndjerë veten më të frikësuar. Më futën në një dhomë, që të kallte datën. Më parë ishin përpjekur të më legjendonin.

- S’po të kuptoj.

Ylli fshiu sytë. Iu lagën. Zëri ndryshoi.

# FLETORJA MISTERIOZE

*Tregim nga Muç Xhepa*

Filloi t’i dridhet.

- Të mësojnë çfarë të thuash. Të gënjeshtë dhe të shkatërrosh, jo vetëm një jetë, por një fis të tërë.

Në mendje, menjëherë, më shkoi Shalamovi te “Tregimet e Kolimas”: “... Kuptova se ‘fitoret’ e Stalinit ishin vrasja e të pafajshmëve prej tij”.

Ylli mori një shishe uji dhe kaloi poshtë hidhërimin.

- Sytë e ndezur të mikut tim, Visarit, ishin futur thellë, sikur t’i fshiheshin bisturisë së torturuesve. Ç’i kishin bërë? Dobësuar, qethur...M’u duk se më qëndronte përpara një i burgosur i Mathauzenit. U drithërova i tëri. Frikë. Ky emocion i fuqishëm primitiv më kishte pushtuar të tërin. Çfarë më paralajmëronte? Çfarë rreziku më kërcënohej? “Hë, e njeh këtë? Si e njeh? Shkruani poezi...”. M’u errën sytë. Këmbët po më linin. Shoku hetues, iu përgjigja me zë që dilte nga thellësia e zemrës, jua kam thënë edhe më parë: jemi kolegë dhe e njoh për mësues të talentuar, të përkushtuar... Ma ndërpreu fjalën: “Lëri, lëri këto, s’duam t’ia dimë ne se je djalë komunisti ti. Të plasim brenda, qelia ngjitur me të dhe e sheh mirë i talentuar”. Më lanë të dal, por i ndjeja nga pas, këmba-këmbës, derisa u ra perandoria. Një gjë më mbeti plagë. Shëndeti i babait u rëndua shumë. Nga zhgënjimi i madh që pësoi, u mbyll

brenda. Dënimi i Visarit e lëndoi sa s’thuhej.

Xhelali merr telefonin tim dhe lexon i mallëngjyer komentin.

- Dësh përfunduam në burg. Nuk e di nëse ta kam treguar punën e fletores.

- Jo, kam dëshirë ta mësoj.

- E di që do ta hedhësh në tregim. Prandaj dëgjoje me kujdes.

Porosisim përsëri. Xhelali pije me ngjyrë, unë kola dietike.

- Natën më vjen motra e Yllit dhe më kërkoi Fletoren. Ishte e tronditur. Diçka e rëndë duhej t’i kishte ndodhur shokut tim. Iu luta të futej brenda. Ajo bëri shenjë për jo dhe më kërkoi që të mos tregoja që e pata, nëse pyetesh. Të nesërmen mësova se ishte arrestuar Visar Zhiti.

- Ç’ ishte kjo fletore misterioze?

- Bombë që të plaste ndër duar. Poezi të përkthyer të autorëve të huaj, europianë, nga bota, të pabotuar te ne, emra të ndaluar. Edhe krijime të një grupi poetësh të rinj, që ishin miq. I shtonim. Mes tyre Visari... edhe Ylli, dhe unë. Të tjerë, që u besonim... Për një kohë të gjatë kam jetuar me frikën se më thërrasin sot e më thërrasin nesër.

- Ç’u bë me fletoren?

- E zhduku e motra.

Lexoj në internet se gazetari Kaloshi D. ka gjetur një dokument tjetër, ku hidhet prapë dritë rreth hetuesisë së Visar

Zhiti, por dhe për të tjerët. Një ndjenjë krenarie më pushton të tërin. Miku im Visar Zhiti nuk kishte implikuar askënd gjatë hetuesisë së rëndë. Përkundrazi, i kishte mbrojtur. E kishin dokumentet. Kishte qëndruar. Dhe mendja më shkon te oficeri i “Neronit” - president, që s’lë vend pa u shfaqur në ekranet televizive sot, si një demokrat i madh. “Eh, pjesa e prapme e medaljes” e quan Visari te poezia “Një demon i vogël i stepës”. E pashë edhe anglisht poezinë. Atëherë pa President, Presidenti pa atdhe, poshtërsi e mashtrime, kërkoi t’i vjedhë heroiken, jo Visarit, se nuk ia heq dot, por asaj që përfaqëson Visari, qëndresën, poetin që i mbijetoi ferrit komunist të ngritur dhe nga ai, komandant dje, president sot...

Është orë e vonë. Dua të flas me dikë. Ku është Ylli, ku ndrit? Nata e Uashingtonit vezullon nga dritat pafund, si yje të rënë... Ylli ku je? S’ të flas dot, por më rivjen e gjallë biseda me ty.

- Do t’ më falësh, por s’rija dot pa folur me një mik... të Fletores. E pe ç’shkruhej për Visarin?

- Po. Dhe i dija. Bënë mirë që nxjerrin dokumente. E botuan disa gazeta, një gurë tjetër në themelet e së vërtetës.

- Ylli, dikur më ke thënë se me 2-B ishin të tërë intelektualët që sistemi i piketonte. Ndërsa ata që paraqisnin rrezik i kalonte në 2-A. I bënte gati për burg. Çështje javësh a ditësh...

- Po, po, vërtet. 2-B ishte thjesht dosje përgjimi. 2-A është sulmi, humnera.

- Nëse... dua të mësoj diçka rreth fletores misterioze... Ç’u bë me të, ku e çoi motra?

- Ajo fletore nis me një mikun tonë poet. Plot me përkthime, poezi nga bota, shekullit XX. Visari, pasi e lexoi, me lejen e tij, e kopjoi. Kështu bënim, mes të besuarve. Pa thënë dhe se ku e morëm, as kujt ia dhamë. Ruanim njëri-tjetrit. Por dhe donim të përhapim poezinë e madhe. Mua ma dha Visari. Ishim mësues në fshatrat e Kukësit, shkonim në këmbë te njëri-tjetri, 2-3 orë larg, maleve. Pra, në dijeninë time, tre a katër vetë e kishim lexuar atë fletore... ndërsa nga shokët s’e di se sa e kopjuan.

- Shokë, e ke fjalën për poetë si ju?

- Po, të thashë, ne ishim disa të rinj që shkruanim dhe i besonim njëri-tjetrit. I jepnin ç’kishim, ç’genim...

- Lexova për njërin që s’e kishin kaluar në 2-A.

- S’e di...

- Në libër, Visari ka shkruar se nëna e tij takoi edhe Kryetarin e Lidhjes së Shkrimtarëve.

- Nëna e Visarit u bë copë ta shpëtonte. I shëhu shkrimet e tij dhe fletoren, sigurisht. I futën nën tokë. Kontrolluan shtëpinë, por nuk gjetën gjë. Kryetari i Lidhjes i tha që djali t’i zgjidhte shokët. Edhe në qeli, hetuesi, dëshmon Visari, i bërtiste shpesh: “Fol! Shokët janë si makinat “reportable”, e shkarkuan të tjerët mbi ty. Vetëm ti po e mban ngarkesën. Fol!”.

- Po, Kryetari i Lidhjes e kishte fjalën për poetët?

- Besoj po.

- Më fal që të pyes: pas burgosjes së Visarit në Spaç, çfarë ndodhi me poetët e tjerë?

- Asgjë. Disa u transferuan në Tiranë.

- Po fletorja origjinale?



# LETRAT E M. BULLGAKOVIT DREJTUAR STALINIT

Përgatiti dhe përktheu nga origjinali Agron Tufa

## NGA LETRAT E MIHAILL BULLGAKOVIT DËRGUAR STALINIT

Biseda telefonike e Mihail Bullgakovit me Josif Stalinin u bë me 18 prill 1930. Shkak për këtë bisedë qe bërë letra e shkrimtarit dërguar Stalinin. Kjo letër që një klithje shpirtërore e shkrimtarit, të cilit në fund të viteve njëzetë nuk e lejuan të vërë në skenë asnjë prej veprave të tij dramaturgjike, nuk e lejuan të botonte as dhe një rresht.

Në këtë letër të shkrimtarit drejtuar udhëheqjes së BRSS dhe vetë Stalinin, të datuar me 28 mars 1930, Mihail Bullgakovi ka shkruar, duke rrëfyer gjendjen e vet: "tash unë jam i shkatërruar", "gjërat e mia janë të pashpresa", "pamundësia për të shkruar është për mua e njëjtë me të qenit i varrosur për së gjalli". Duke cituar sulmet shpartalluese ndaj veprave të tij letrare, ai mbrohet:

"Unë ju dëshmoj me dokumenta në dorë që i gjithë shtypi i BRSS-së, e me të bashkë dhe të gjitha institucionet e udhëzuara të kontrollojnë repertuarin, përgjatë gjithë viteve të mia të punës letrare, të gjithë në një mendje e me një tërbim të pa imagjinueshëm, kanë dhënë verdiktin se veprat e Mihail Bullgakovit nuk kanë vend në BRSS.

Dhe unë po e shpall, se shtypi i BRSS-së KA PLOTËSISHT TË DREJTË.

Lufta me censurën, cilado qoftë ajo dhe në çdo pushtet qoftë, është detyra ime prej shkrimtari...

Dhe, së fundi, karakteristikat e mia të mbrame në dramën që më kanë marrë më qafë: "Ditët e Turbinëve", "Arratia" dhe në romanin "Garda e bardhë": paraqitja këmbëngulëse e inteligjencës ruse si shtesa më e mirë në vendin tonë. Më përveçem - paraqitja e inteligjencës së familjeve aristokrate, të hedhur sipas kapriços së fatit historik gjatë luftës civile në kampin e gardës së bardhë, në traditat e "Lufta dhe Paqja". Një paraqitje e tillë është krejt e natyrshme për një shkrimtar që me inteligjencien e lidh gjenetikisht gjaku.

Porse paraqitje të tilla na çuakan në përfundimin se autori, këtë inteligjencë në BRSS, njëllon si me heronjtë e vet, pa marrë parasysh sforcimin e stërmundimshëm PËR TË BËRË ATA TË PAANSHËM NDAJ TË KUQVE DHE TË BARDHËVE - pra autori na bëhet atestat i bjellgardistit-armik, dhe me ta bërë këtë atestim, sikundër gjithkushi e kupton, e shpall veten njeri të mbaruar nën pushtetin e BRSS-ve..

I drejtohem humanizmit të pushtetit sovjet me lutjen, të më lërë mua, shkrimtarin, i cili nuk mund të jetë i dobishëm në shtëpinë e vet, në atdheun e vet, i lutem pra këtij pushteti, ta bëjë shpirtin të gjerë dhe të më japë udhët në liri."

Dhe ja, pas një britme të tillë të shpirtit të datës 18 prill 1930 rreth orës 19 në apartamentin e Mihail Bullgakovit ra zilja

## Parafjalë

E para gjë që të trondit në letrat e Mihail Bullgakovit dhe Evgenij Zamjatinit dërguar Stalinin (ato janë shumë të ndryshme: letrat e Bullgakovit janë plot dyshime, ndwrsa të Zamjatinit janë më drejtvizore), - është fakti që ata nuk kërkojnë ndihmë, ndonëse jetojnë në varfëri, të ftohtë dhe nevojë, por kërkojnë ndërprerjen e persekutimit dhe heshtjes, me të cilat i ka rrethuar pushteti, shtëpitë botuese, shokët e botës së kulturës.

Falë ndërhyrjes së Gorkit Zamjatini arrin të kapërcjë kufijtë e BRSS-së dhe vdes pas pesë vitesh në Paris, ndërsa Bullgakovi mbetet brenda internimit të brendshëm dhe do të duhet të durojë ndalimet, fyerjet, kërcënimet, manipulimet me tekstet e tij, deri dhe vjedhjet e dorëshkrimeve. Bullgakovi i drejtohet Stalinin ta lejojë që bashkë me të shoqen ta lënë BRSS-në, pasi për të "pamundësi për të shkruar është e njëjtë me varrosjen për së gjalli". Në prill të vitit 1930 Stalini i telefonon Bullgakovit në shtëpi, për t'i thënë të fillonte punë në MXAT (Moskovskij Hudozhestvjennyj Akademiceskij Teatr - Teatri Artistik Akademik i Moskës) dhe i propozon për t'u takuar. Porse ky takim nuk ndodhi asnjëherë, ndërkaq që Bullgakovi jetoi ndërmjet depresionit dhe çmendurisë për shkak të torturës shpirtërore që vazhdoi t'i bënte pushteti sovjetik me urdhër të Stalinin.

Disa javë para vdekjes Bullgakovi mbaron së shkruari kryeveprën e tij dhe një prej romaneve më madhështore të shekullit XX "Mjeshtri dhe Margarita", që u botua i plotë në BRSS vetëm në vitin 1989. Nuk qe e thënë që ai të shihte se çfarë efekti shkaktoi tek lexuesit analogjia në romanin e tij ndërmjet Stalinin dhe Satanait.

Disa letra të Bullgakovit nuk arritën kurrë t'i dërgoheshin Stalinin. Shkrimtari ato i ka nënshkruar me pseudonimin "Tarzan" dhe në to ai qe përpjekur të vendoste njëfarë raporti personal me Stalinin. Ky ishte një iluzion naiv me një përzjerje të çuditshme paniku, mazokizmi dhe mahnje. "Lahtari paralizues ka lënë gjurmën e vet në jetën e shumë intelektualëve deri në vdekjen e Stalinin në mars të vitit 1953. Këto letra janë pasqyrimi i frikës dhe nevojës për të ikur prej tij. Këto letra na ndihmojnë të kuptojmë natyrën e stalinizmit dhe banalitetit të së keqes.

e telefonit. Receptorin e mori e shoqja, Ljubova Bullgakova. Me të marrë vesh që telefonata vinte nga Komiteti Qendror, ajo thirri të shoqin. Bullgakovi mendoi se është ndonjë përqeshje, andaj iu avit telefonit i zemëruar.

Sekretari: Mihail Afanasjeviç Bullgakovi?

Bullgakovi: Po, po.

Sekretari: Tash fill me ju do të flasë vetë tovarish Stalinin.

Bullgakovi: Çfarë? Stalini thatë?

...Kaluan 2-3 minuta...

Stalini: Me ju po flet Stalinin. Ngjatjetani, tovarish Bullgakov.

Bullgakovi: Ngjatjetani, Josif Visarionoviç.

Stalini: Letrën tuaj e kemi marrë. E lexuam me shokët. Ju do të keni për këtë letër një përgjigje pozitive... Por, ndoshta,



menjëmend - Ju këmbënuhni për t'ju lënë të ikni jashtë shtetit? Si ta kuptojmë, ne jua kemi sjellë në majë të hundës?

Bullgakovi (i turbulluar dhe jo menjëherë): ...Kohët e fundit kam menduar gjatë nëse ia del dot një shkrimtar rus të jetojë jashtë atdheut të tij. Dhe mua më duket, se e ka të pamundur.

Stalini: Ju keni të drejtë. Edhe unë ashtu mendoj. Ku dëshironi të punoni? Në Teatrin Artistik?

Bullgakovi: Po, do të doja. Por unë kam kërkuar punë aty dhe më kanë refuzuar.

Stalini: Po ju çojeni dhe njëherë kërkesën tuaj atje. Kam përshtypjen, se ata do të pranojnë. Do të doja të linim një takim dhe të flisnim bashkë.

Bullgakovi: Po, po! Josif Visarionoviç, edhe unë kam shumë nevojë të kuvendoj me ju.

Stalini: Po, duhet gjetur kohë dhe të

takohemi, patjetër. E tani ju uroj të gjitha të mirat.

Takimi i Bullgakovit me Stalinin nuk u bë kurrë. Por me 19 prill të vitit 1930 Bullgakovi u emërua asistent-regjisor në Teatrin Artistik. Dhe përveç kësaj, u punësua dhe në Teatrin e Rinisë, por, megjithatë, sado paradoksale, dramën nuk lejua t'ia vënë në skenë.

Me 30 maj 1931 në një letër tjetër për Stalinin Bullgakovi shkruan:

"Që nga fundi i vitit 1930 jam sëmurë me një formë të rëndë neurastenije me ethe frike dhe ankth atrial dhe aktualisht jam i mbaruar.

Unë kam synime, por nuk ka forca fizike, nuk ka kushte të nevojshme për të bërë punën. Shkaku i sëmundjes sime e kam shumë të qartë.

Në fushën e gjerë të letërsisë ruse në BRSS, unë isha i vetmi ujk letrar. Më këshilluan të lyeja lëkurën. Këshilla qesharake. Qoftë një ujk i lyer apo një ujk i prerë, ai ende nuk duket si një pudel. Më trajtuan si ujk. Dhe për disa vite më çuan sipas rregullave të një kafazi letrar në një oborr të rrethuar. Nuk kam keqdashje, por jam shumë i lodhur. Në fund të fundit, bisha mund të lodhet.

Bisha deklaroi se ai nuk ishte më një ujk, jo një shkrimtar. Refuzon profesionin e tij. Bie në heshtje. Kjo është, sinqerisht, shpirtvogëlsi.

Nuk ka një shkrimtar të tillë që do të donte të heshte. Nëse ai ndalon së foluri, do të thotë se ai nuk ka qenë i vërtetë. Dhe nëse i vërtetë hesht, ai do të vdesë"...

Vërtetë, Stalini mori pjesë dy herë në një produksion të shfaqjes së Bullgakovit "Apartamenti i Zojkinës", duke theksuar: "Është një shfaqje e mirë! Nuk e kuptoj, nuk e kuptoj fare pse kjo dramë njëherë lejohet e njëherë tjetër ndalohet. Është një shfaqje e mirë, asgjë të keqe nuk shoh në të". Dhe në shkurt 1932, Stalini, pasi kishte parë shfaqjen "Frika" të e Afinogenovit, të cilën nuk e pëlqeu, u tha përfaqësuesve të teatrit: "Keni pasur një shfaqje të mirë, "Ditët e Turbinëve" të Bullgakovit - pse e keni ndaluar? ... Është një dramë e mirë, duhet ta vini sërish në skenë". U urdhëri për ta rivënë shfaqjen.

Përveç "Ditëve të Turbinëve" të rikthyer në Teatrin Artistik në Moskë, pasoi vënia në skenë e shumëpëritur e shfaqjes së tij "Kabala Shenjtëruese" (e cila megjithatë u hoq shpejt nga repertori). Të lejuara për vënie në skenë janë "Shpirtra të vdekur" të vënë në skenë nga vetë Bullgakovi.

Por gjatë gjithë kësaj kohe Bullgakov po kërkon një takim me Stalinin, duke shpresuar të shpjegojë pozicionin e vet në kuvendim e sipër dhe të kuptojë pozicionin e tij. Në një letër, ai madje i kërkoi Stalinin "të bëheni lexuesi im i parë". Por nuk ka më asnjëlloj kontakti me udhëheqësin.

Në 1934, Bullgakovët u thirrën në komitetin ekzekutiv të qytetit për të plotësuar dokumentet për largimin nga BRSS. Bullgakov është i kënaqur dhe beson se përndjekja ka mbaruar dhe "Kështu, unë do të shoh dritën!" Por pas disa ditësh ai mori një refuzim zyrtar.

Dhe Bullgakov përsëri i shkruan një letër Stalinin duke i kërkuar personalisht ndërmjetësim.

Përgjigje s'ka.

Në vitin 1938, Bullgakovi, në një letër tjetër drejtuar Stalinin, ndërmjetësoi për poetin dhe dramaturgun Nikolai R. Erdman, i cili nuk u lejua të kthehej në Moskë pasi u internua në Siberi.

Dhe Bullgakov përsëri i shkruan një letër Stalinin duke i kërkuar personalisht ndërmjetësim.

Përgjigje s'ka.

Në vitin 1939, Bullgakovit i dhanë një vend si libretist në Teatrin "Bolshoj", ku ai gjithashtu punon si përkthyes. Dhe një herë në shfaqjen "Ivan Susanin" Bullgakovi pa në llozhë Stalinin.

Por Stalini nuk i kushtoi vëmendje

Miqtë e këshillojnë Bulgakovin: "Shkruaj një dramë propagandistike... Sa kohë mund të vazhdojë kjo? Duhet të heqim dorë, të gjithë janë dorëzuar. Ju keni mbetur vetëm. Kjo është marrëzi." Dhe Bullgakovit po përpriqet të bëjë një hap përpara - ai shkruan shfaqjen "Batum" për të riun Josif Xhugashvili.

Por përpjekja dështon.

Kur Bullgakovit me regjisorin dhe aktorët e përfshirë në prodhimin e "Batum-it", nisat për në Gjeorgji për t'u njohur me vendet historike në vend, i vjen një telegram në tren ku i bën me dije se: "nuk ka nevojë për një udhëtim të tillë, kthehu në Moskë!..."

Rezultoni se Stalini, gjatë vizitës së tij në Teatrin e Artit në Moskë, i thotë Njemiroviç-Dançenkos se "ai e konsideron shfaqjen "Batum" shumë të mirë, por ajo "nuk mund të vihet në skenë".

"Lusja," i tha atëherë Bullgakovit gruas së tij, "ai sapo më nënshkroi një urdhër vdekjeje".

Në tetor 1939, Bullgakovit i sëmurë dhe i dëshpëruar shkroi testamentin. Ai tashmë ishte tepër i sëmurë. Kolegjet dhe të njohurit i shkruajtën një letër qeverisë me një kërkesë për lejimin e Bullgakovit në Itali për kurim mjekësor.

Përgjigje s'pati.

Me 10 mars 1940 Bullgakovit ndërroi jetë.

Po atë ditë në apartamentin e tij ra telefoni. Telefononte sekretaria e Stalinit: Sekretari: Si është puna, shoku Bullgakov vdiq?

L. Bullgakov: Po, vdiq.  
Në skajin tjetër ulën dorezën.

### LETËR E BULLGAKOVIT UDHËHEQJES SË BRSS-SË

28 mars 1930, Moskë  
Mihail Afanasjeviç Bullgakov  
(Moskë, B. Pirogovskaja, Pallati 35, ap 6)

I drejtohem Udhëheqjes së BRSS-së me këtë letër, si më poshtë vijon:

**1**

Pasi të gjitha veprat e mia u ndaluan, mes shumë qytetarëve që më njohin si shkrimtar, zunë të më vinin fjalë që përqendroheshin te një këshillë:

të krijoj një "dramë komuniste" (në thonjëza sjell vetëm citatat), përveç kësaj, t'i drejtohem udhëheqjes së BRSS-së me një letër pendese ku përmbajtja të jetë refuzimi i pikëpamjeve të mia mbi veprat letrare dhe besimi se nga ky moment, do të punoj me përkushtim të rrallë për idenë e komunizmit si shkrimtar i angazhuar.

Qëllimi: të shpëtoj nga përndjekjet, varfëria dhe vdekja e pashmangshme si finale.

Kësaj këshille nuk ia vura veshin. Zor se do të dilja përpara Udhëheqjes së BRSS-së si i singertë, duke shkruar një letër mashtruese që përfaqëson një kurbet politik naiv dhe të parehatshëm.

Kurse përpjekjen për të krijuar një dramë komuniste, për këtë as që e vura ujën në zjarr, duke e ditur qysh më parë se këtë gjë nuk dëgjon pena ta shkruajë.

Dëshira që u poq brenda meje për të ndërprerë mundimet e mia prej shkrimtari, më shtrëngon t'i drejtohem Udhëheqjes së BRSS-së me një letër të vërtetë.

**2**

Duke analizuar albumet me ato çka shkruhen për mua, zbulova se në shtypin e BRSS-së përgjatë dhjetë vjetëve të punës sime letrare, janë shkruar 310 artikuj. Prej tyre: lavdërues – 3, kurse armiqësorë-sharës – 298.

Këta 298 artikujt e fundit paraqesin një pasqyrë të jetës sime prej shkrimtari.

Heroin e dramës sime "Ditët e Turbinëve", Aleksi Turbinin, e kanë quajtur, me gërma kapitale në vargje, "BIR KURVE", ndërsa autorin e dramës e kanë rekomanduar si "të pushtuar nga PLEQËRIA E QENIT". Për mua, kanë shkruar si për një "KAZAN PLEHRASH LETRAR" që mbledh kocka e mbeturina, pasi ato i ka "VJELLË një dyzinë gostiarësh".

Kanë shkruar kështu:

"...MISHKA Bullgakov, o nuni im, MË FALNI PËR SHPREHJEN - MENDER ME THANË, GJITHASHTU SHKRIMTAR, ti rrëmih NË FUND TË KOSHIT TË PLEHRAVE... Ç'pallavra i ke këto more vëllam, këto gërthitje prej daci...? Jam një njeri delikat, por merre e përveshja me legen surratit atij debili... Ne rrojmë edhe pa ata Turbinët e tu, të ngjashëm sutjena për cica buçje që s'i hyjnë kujt në punë... Nga na dole more BIR KURVE, MORE TURBIN QË S'I HYN KUJT NË ALET..." ("Jeta e artit" No 44 – 1927).

Kanë shkruar "për Bullgakovin, i cili siç ka qenë, ashtu do të mbetet, një BASTARD I BORGJEZISË SË RE, që hesh cirka qyrresh të helmëta, por të pafuqishme mbi klasën punëtore dhe idealin komunist të saj" ("Komsomolskaja pravda" 14. X. 1926).

Kanë shkruar se mua më pëlqen ATMOSFERA E SHKËRDHIMIT QENÇE përreth e rrotull ndonjë gruaje flokëkuqërremtë të ndonjë shoku (A. Llnaçarskij, "Izvestia", 8/X – 1926) dhe se prej dramës sime "Ditët e Turbinëve" të shpon hundët KUTËRBIMI (Stenogrami i shpërndarë nga agjitpropri në maj 1927), e të tjera, e të tjera...

Nxitoj t'ju bëj me dije se të gjitha

këto që citova, nuk i citoj aspak që t'ju ankojem juve për kritikën e as për të hyrë në ndofarë polemike. Qëllimi im – është shumë e më shumë serioz.

Unë ju dëshmoj me dokumenta në dorë që i gjithë shtypi i BRSS-së, e me të bashkë dhe të gjitha institucionet e udhëzuara të kontrollojnë repertuarin, përgjatë gjithë viteve të mia të punës letrare, të gjithë në një mendje e me një tërbim të pa imagjinueshëm, kanë dhënë verdiktin se veprat e Mihail Bullgakovit nuk kanë vend në BRSS.

Dhe unë po e shpall, se shtypi i BRSS-së KA PLOTËSISHT TË DREJTË.

**3**

Pikënisje për këtë letër u bë një pamflet im me titull "Ishulli i kuqërremtë".

E gjithë kritika e BRSS-së, pa përjashtim, e priti këtë dramë me deklaratën se ajo është "mediokre, pa kockë, beterr" dhe që ajo paraqet një "paskuil mbi revolucionin".

Uniteti që i plotë, por ai u thye papritmas dhe krejt çuditshëm.

Në numrin 12 të "Buletini i repertuarit" (1928) u botua recensionin i P. Novickijt, në të cilin thuhej se "Ishulli i kuqërremtë" është – "një parodi interesante e mendjemprehtë", në të cilën, "del në pah hija e Inkuizitorit të Madh që ndrydh dhe shtyp krijimtarinë artistike që kultivon SERVILIZËM SKLLAVI me shtampa të trasha dramaturgjike, që fshin personalitetin e aktorit dhe shkrimtarit", që në "Ishullin e kuqërremtë" bëhet fjalë për "forcën e zezë të së ligës që mëkon SPEKULATORËT, SERVILAT DHE PANEGJIRIKËT..."

Thënë është edhe "nëse një forcë e tillë e errët ekziston, INDINJATA DHE MENDJEMPREHTËSIA E LIGË E BORGJEZISË SË LËVDUAR NGA DRAMATURGU ËSHTË E JUSTIFIKUAR".


Me lejoni t'ju pyes – ku qëndron e vërteta?

Çfarë është fundja "Ishulli i kuqërremtë"? – "një dramë mediokre, beterre", apo një "pamflet mendjemprehtë"?

E vërteta qëndron në recensionin e Novickijt. Nuk marr të gjykoj se sa mendjemprehtë ishte drama ime, por një gjë e di mirë, që në dramë menjëmend ngrihet një hije e ligë dhe se kjo është hija e Komitetit Udhëheqës të Repertuarëve. Pikërisht ky komitet edukon mediokërrit, panegjirikët dhe "shërbetorë" të trembur. Ai po e merr më qafë skenën sovjetë dhe do ta shkatërrojë përfare.

Unë këtë nuk e kam shprehur me të pëshpëritura qoshove. E kam shprehur në një pamflet satirik dhe e kam vënë në skenë. Shtypi sovjet, duke bërë dalazotësin e Drejtorit të Repertuarëve, shkroi se "Ishulli i kuqërremtë" – është një paskuil, tallje e revolucionit. Kjo është një pallavër jo serioze. Nuk është paskuil mbi revolucionin për shumë arsye, prej të cilave, për ekonomi letre po iu tregoj vetëm një: paskuil mbi revolucionin, për shkak të madhësisë së tij të jashtëzakonshme është e PAMUNDUR të shkruash. Pamfletin nuk është paskuil, sikurse Drejtoria e Repertuarëve – nuk është revolucionin.

Por kur shtypi gjerman shkruan se "Ishulli i kuqërremtë" – është "apeli i parë për lirinë e shtypit në BRSS" ("Molladaja gvardija" No 1 – 1929), - pra shtypi gjerman thotë të vërtetën. Për këtë jam i bindur. Lufta me censurën, sido që të jetë ajo dhe në çfarëdo pushteti qoftë cenzura – është misioni im prej shkrimtari, sikundër se dhe apeli për liri të shtypit. Unë jam një adhurmimtar i zjarrtë i kësaj lirie dhe mendoj se, në pastë shkrimtar që rreht të provojë të kundërtën, që kjo liri nuk i



duhet, ai do t'i shembëllente një peshku që shpall publikisht se nuk ia ka nevojën ujit.

4

Ja pra ku e keni njërën prej karakteristikave të letërsisë time dhe se ka mjaftuar vetëm kjo që veprat e mia të mos ekzistojnë në BRSS. Por lidhur me këtë karakteristikë janë të lidhura të gjitha të tjerat që dalin gjithkund nëpër novelat e mia satirike: ngjyrat e zeza e mistike (UNË JAM NJË SHKRIMTAR MISTIK), ngjyra me të cilat janë paraqitur shëmtira të panumërta nga jeta jonë e bastarduar, helmi me të cilin është nginjur gjuha ime, skepticizmi i thellë në lidhje me procesin e revolucionit që po ngjet në vendin tim të prapambetur dhe kundërvënia e tij ndaj Evolucionit të Madh; por më kryesorja – është paraqitja e tipareve të tmerrshme të popullit tim, të atyre tipareve që shumë më përpara revolucionit i shkaktonin vuajtje të thella mësuesit tim M. E. Sllatikov-Shcedrin-it.

Nuk ia vlen ta themi që shtypi i BRSS-së as e ka çarë kokën të mendojë seriozisht për t'i nënvizuar të gjitha këto, ashtu siç është ai i zënë me komunikatat mendjelehta se, gjoja, në satirën e Mihaill Bullgakov-it kemi të bëjmë me "SHPIFJE".

Vetëmse një herë, në fillim të popullaritetit tim, qe shkruar nënvizueshëm thujse me një habi mendjemadhe se: "M. Bullgakov-i DËSHIRON të bëhet satirik i epokës tonë ("Libërbartësi", No 6 – 1925).

Ajme, foljen "dëshiron" është e kotë ta marrim tani në kohën e tashme. Atë mund ta shpiem të transferuar në pluskuamperfektum: M. Bullgakov U BË SATIRIK, dhe pos kësaj në të njëjtën kohë kur asnjë lloj satire (që përshkon zonat tabu) në BRSS nuk mund të imagjinohet.

Nuk më takon mua nderi ta shpreh këtë mendim kriminal në shtyp. Vetë shtypi e ka shprehur krejtësisht qartë në artikullin e B. Blumit (No 6 "Literaturnaja gazeta"), dhe kuptimi i këtij artikulli saktë e mrekullisht reduktohet në një formulë:

ÇDO SATIRIK NË BRSS ËSHTË NJË ATENTAT MBI REGJIMIN SOVJET.

A kam vallë vend unë në BRSS?


5

Dhe, së fundi, karakteristikat e mia të mbrame në dramën që më kanë marrë më qafë: "Ditët e Turbinëve", "Arratia" dhe në romanin "Garda e bardhë": paraqitja këmbëngulëse e inteligjencies ruse si shtesa më e mirë në vendin tonë. Më përveçëm – paraqitja e inteligjencies së familjeve aristokrate, të hedhur sipas kapriços së fatit historik gjatë luftës civile në kampin e gardës së bardhë, në traditat e "Lufta dhe Paqja". Një paraqitje e tillë është krejt e natyrshme për një shkrimtar që me inteligjencien e lidh gjenetikiisht gjaku.

Porse paraqitje të tilla na çuakan në përfundimin se autori, këtë inteligjencë në BRSS, njëlloj si me heronjtë e vet, pa marrë parasysh sforcimin e stërmundimshëm PËR T'I BËRË ATA TË PAANSHËM NDAJ TË KUQVE DHE TË BARDHËVE – pra autori na bëhet atestat i bjellgardistit-armik, dhe me ta bërë këtë atestim, sikundër gjithkushi e kupton, e shpall veten njeri të mbaruar nën pushtetin e BRSS-ve.

6

Portreti im letrar është tashmë i përfunduar, por ai është portret politik. Nuk mund të them se çfarë thellësie tjetër mund të kërkojë në të kriminalistika, por po ju lutem për një gjë: përtej kornizave



të këtij portreti s'keni ç'kërkoni gjë tjetër. Ai është i mbaruar me ndërgjegje të plotë.

7

Tani jam i shkatërruar.

Ky shkatërrim u përjetua me gëzim të madh nga shoqëria sovjetë dhe i kanë vënë edhe emër "ARRITJE".

R. Pikel, duke festuar shkatërrimin tim ("Izvestia" 15/IX 1929), na thënkësh një mendim liberal:

"Ne nuk duam të themi me këtë se emrit të Bullgakovit i është hequr vizë nga lista e dramaturgëve sovjetë".

Dhe i dha gajret e shpresë shkremtarit të therur me fjalët: "Është fjala për veprat dramatike të mëparshme të tij".

Mirëpo jeta si Drejtor Repertuari, ka treguar që liberalizmi i R. Pikel-it është një kërkim të dhëmbësh.



Me 18 mars të vitit 1930 mora një pusullë nga ky njeri që telegrafikisht njoftonte, se jo dramaturgjia ime e shkuar, por drama ime re "Shenjtnia e Kabalës" NUK LEJOHET TË VIHET NË SKENË.

Po i nie shkurt: me dy rreshta zyrtarë është varrosur puna ime nëpër arkiva, fantazia ime, drama ime që ka marrë nga specialistët e kualifikuar të teatrit vlerësime të panumërta si "dramë e shkëlqyer".

R. Pikel nuk është në vete. U varrosën veprat e mia të deritashme, por edhe vepra më e re, edhe veprat e mia të ardhshme. Dhe vetë me duart e mia, e hodha në zjarrin e sobës dorëshkrimin e romanit mbi djallin, dorëshkrimin e komedisë së vëllimit të dytë të romanit "Teatri"

Të gjitha krijimet e mia janë të pashpresa.

8

I lutem Udhëheqjes sovjetike të marrë në vëmendje që unë nuk jam ndonjë veprimtar politik, por shkrimtar dhe që gjithë produktin tim ia kam dhënë skenës sovjetë.

Ju lutem vini re dy opinionet e dhëna për mua në shtypin sovjet.

Të dy këto opinione vijnë nga armiqtë e papajtuësishëm të veprave të mia, prndaj janë shumë të çmuara:

"Na doli një shkrimtar, që NUK ËSHTË I RRADHËVE TONA MADJE AS NË NGJYRA TË PËRKOHSHME" (L. Averbah, "Izvestia" 20/ IX – 1925).

Ndërsa në vitin 1929:

"Talenti i tij është aq demonstrativisht i spikatur, sakundër dhe forca reaksionare e krijimtarisë së tij" (R. Pikel, "Izvestia", 15/IX – 1929).

Ju lutem të merrni parasysh një gjë, që pamundësia për të shkruar është për mua e njëjlojtë sikundër se vdekja për së gjalli.

9

I LUTEM UDHËHEQJES SË BRSS TË URDHËROJË SIPAS RREGULLAVE TË BRAKTIS KUFIJTË E BRSS I SHOQËRUAR NGA BASHKËSHORTJA IME LJUBOVA EVGENIEVNA BULLGAKOVA.

10

I drejtohem humanizmit të pushtetit sovjet me lutjen, të më lerë mua, shkrimtarin, i cili nuk mund të jetë i dobishëm në shtëpinë e vet, në atdheun e vet, i lutem pra këtij pushteti, ta bëjë shpirtin të gjerë dhe të më japë udhët në liri.

11

Nëse edhe ajo çfarë ju shkruajta është jo bindëse dhe më dënoni sa të kem jetë me heshtje në BRSS, e lus Udhëheqjen Sovjete të me gjejë punë në specialitetin tim të komandoj në teatër si regjizor shtetëror.

Unë ju lutem pikërisht, saktë dhe nënvizueshëm për një URDHËR KATEGORIK, PËR TË KOMANDUAR, sepse përpjekjet e mia për të gjetur punë në atë sferë të vetme ku mund të jem i dobishëm në BRSS, si specialist jashtëzakonisht i kualifikuar, kanë pësuar deri tash fiasko. Emri im është bërë aq gogol, sa lutja ime e natyrshme për punë shkakton gjithandej TMERR, pa marrë parasysh se në Moskë ka një sasi të të madhe aktorësh e regjizorësh, sikundërse dhe drejtorë teatror, të cilët e njohin mirë dijen time virtuoze të skenës.

I propozoj BRSS-së krejt ndershmërisht, pa asnjë hije keqëndashëse, të më gjejë punë si regjizor specialist dhe aktor, i cili me ndërgjegje të plotë do të verë në skenë çdo dramë, duke filluar nga darmaat e Shekspirit gjer në dramën e ditëve tona.

Ose ju lutem të emëroni laborant-regjizor në Teatrin e parë artistik – në shkollën më të mirë, të kryesuar nga K. S. Stanislavski dhe V. I. Dançenko.

Nëse nuk me emërojnë regjizor, atëherë ju lutem për postin shtetëror të aktorit për role të dyta. Nëse edhe kjo s'është e mundur, atëherë ju lutem të punoj si punëtor skene.

Por edhe nëse kjo s'bëhet, e lus Udhëheqjen Sovjete, të bëjë me mua çka të dojë, si ta gjykojë ajo më mirë, por ama, diçka të bëjë, sepse mua, dramaturgut që ka shkruar 5 drama, të njohur në BRSS dhe në Evropë, më mbetet shqeto, NË KËTË ÇAST, - mjerimi, rruga dhe vdekja.

Moskë, Mihaill Bullgakov  
28 mars 1930.

“Emrin e kam Emmanuel. E ndryshova në Man, ndërsa për sa i përket mbiemrit nuk ka ç’t’i duhet njeriu sesi e kam.”  
Man Ray

Emri i tij i vërtetë ishte Emmanuel Radnitzky por e ktheu në Man Ray (1890-1976). Ai u lind në Filadelfia të Amerikës dhe kishte një prejardhje ruso-hebraike. Përveçse shpiku emrin e vet, ky artist amerikan krijoi edhe imazhet më surreale të shekullit të 20-të, si për shembull: një palë buzë gjigande që fluturojnë në një qiell të stuhishëm, të pikturuara mbi një kanavacë dy metra e gjysmë të gjatë; gozhda të vërteta që dalin prej anës së sheshtë të një hekuri për hekurosje; një fotografi e cila tregon faqen e një gruaje mbi të cilën shndrisin lot prej xhami, me sytë e saj të hedhur mënjanë në ekstazë, me qerpikët e saj të bëra plastike me bojë, etj. Por vepra e tij më e njohur, e cila shpalos fytyrën magjike të artit, është *Le Violon d'Ingres*, *Violina e Ingresit*, kjo fotografi surrealistike e cila të mbetet e qartë dhe tunduese edhe gjatë errësirës së shkurtër të mbylljes së qepallave të syrit të çdo njeriu që e sheh atë.


Man Ray ishte një prej artistëve më origjinalë dhe novatorë të shekullit të 20-të. Ai u bë shumë i njohur si piktor, fotograf, kinematograf, poet dhe instalacionist, por ai u bë i famshëm dhe u njoh më shumë nëpërmjet fotografisë dhe teknikave që përdori në fotot e tij. “Nëpërmjet fotografisë e shpreh veten më shpejt dhe më thjesht sesa nëpërmjet pikturës,” u shpreh ai.

Pasi mori me pagesë një fotograf për të fotografuar pikturat e veta (për arsye dokumentimi) dhe pasi mbeti i pakënaqur me rezultatin, Man Ray vendosi ta provonte vetë. Rezultatet ishin magjepsëse. Sipas fjalëve të Marcel Duchamp, “për Man Ray aparati ishte vetëm një instrument i thjeshtë në shërbim të mendjes.”

Kur Man Ray zbuloi këtë dashuri të re për fotografinë ai e la disi mënjanë pikturën. Në vend që të sillte në shtëpi vajza të reja që t’i pikturonte, ai i ulte apo i poziciononte ato e më pas i fotografonte. Ai nuk fotografonte vetëm modele por edhe objekte, për shembull: në një rast ai mori një makinë qepëse, e mbuloi me një leckë prej leshi pastaj e lidhi fort me spango dhe e fotografoi. Ky imazh u quajt *L'enigme d'Isidore Ducasse*, një vepër misterioze që intrigon shikuesin dhe e bën të vrasë mendjen se çfarë ka nën atë leckë prej leshi.

Kur nisi të jetonte në Paris, Man Ray u kërkonte të fotografonte të ftuarit në festat e të pasurve. Ai nisi të njihej menjëherë si një mjeshtër portretesh. Në koleksionin e portreteve të tij nuk ka vetëm portrete femrash të bukura apo njerëzish të kamur por edhe shkrimtarësh dhe artistësh të famshëm të asaj kohe si për shembull Ernest Hemingway, Pablo Picasso, Alberto Giacometti, Max Ernst, Andre Breton, Tristan Tzara, Joan Miro, James Joyce dhe shumë të tjerë.

*La fenom - Integrimi i hijeve, Topa në një kavanoz prej qelqi*, dhe *Hija e llambës* janë ndër veprat e tij të para. Kompozimi i këtyre fotove u krijua prej objekteve të gjetura në rrugë apo të blera tek tregu i mallrave të përdorura, pastaj të fotografuara me një stil dhe dimension të ri. Këto lloj veprash janë të bazuara mbi spontanitetin dhe reflektojnë jetën e



# VIOLINA E INGRESIT

Dr. Bledar Kurti

përditshme të botës moderne. Fotografi të tilla shkojnë përtej një shkrepeje të zakonshme të aparatit fotografik. Ato përmbajnë elemente kubizmi dhe janë një reflektim i Modernizmit Amerikan. Man Ray bëri në fotografi atë që William Carlos Williams apo E. E. Cummings bënë në letërsi, ai mori objekte të parëndësishme, tërësisht të rëndomta, nga jeta e përditshme, dhe i shndërroi në kryevepra.

Fotografite e objekteve të gjetura simbolizojnë fitoren mbi kohën. Dikur ato objekte kishin qenë të vjetra ndërsa tani ata ishin kthyer në një formë të re artistike; dikur ato kishin qenë të

papërfillura prej njerëzve ndërsa tani ato do varehin në muret e ndonjë ekspozite; ato edhe mund të zhdukeshin por imazhi i tyre do mbetej i fotografuar dhe admiruar përtej brezave për një kohë tejet të gjatë.

Fotot e bëra nga Man Ray gjatë viteve 30-të sollën një realitet të ri tek shikuesit. Për shembull, kombinimi i çuditshëm por i thjeshtë i një molle dhe një vidë paraqet një lloj të ri fotografie, një lloj të ri arti, një harmoni të papërsëritshme midis hijes dhe dritës, një konflikt midis natyrës dhe industrializimit, një referencë seksuale e *Kopshtit të Edenit*, brutalizmi mbi pafajshmërinë, dhe një

simbol i vetë aktit seksual.

“Çdo gjë mund të transformohet, deformohet, apo shuhet prej dritës,” u shpreh ai. Man Ray e aranzhonte ndriçimin në mënyrë që negativi të merrte minimumin e kontrastit. Më vonë, ai e sistematizoi dhe e rafinoi më tej këtë metodë duke bërë printime nga negativi në letër të hollë fotografike, pastaj duke e rifotografuar në një letër me kontrast të lartë, pastaj e zhvillonte normalisht, duke e ndaluar procesin përpara se hijet të bëheshin gri. Ai e thante sipërfaqen dhe e fshinte me pambuk të thatë, pastaj e nxirrte negativin në dritë për tre sekonda. Në fund, imazhi printohej në mënyrën e zakonshme. Ai përdori këtë teknikë të njohur si *solarizim* në fotografite që i bëri zambakëve, duarve, vezëve, portreteve, nudove, etj. Duke përdorur këtë teknikë ai ishte në gjendje të theksonte butësisht konturet e trupit dhe paraqiste trupin femëror si një ikonë të bukurisë dhe dëshirës.

Teknika tjetër e rëndësishme e përdorur dhe e shpikur prej Man Ray ishte Reiografia. Një *reioografi* është një fotografi e bërë pa aparat fotografik. Nëse vendos një objekt direkt mbi një letër fotografike, e ekspozon ndaj dritës dhe pastaj e lan, arrihet një imazh i objekteve të bardha me një sfond krejt të zi, i cili në një farë mënyre i ngjason imazheve radioskopike. Man Ray e quajti këtë proces “të pikturosh me dritë.” Në disa reiografe Man Ray përdori sende të ndryshme, për shembull germa, çelësa, madje dhe një revolver pasi ai kaloi një periudhë të jetës gjatë së cilës bëri disa përpjekje për vetëvrasje.


Femrat luajtën një rol madhor në jetën dhe veprat e Man Ray. Përdorimi i hijes së butë në fotografite e tij i bënte femrat të dukeshin si perëndesha dhe qenie tejet sensuale.

Fotografia më e njohur e Man Ray, dhe imazhi fotografik më i njohur në historinë e artit, e cila mund të konsiderohet si ikona e fotografisë surrealistike, por edhe shndërrimi i dybotshëm i një femre në ëndërr është *Violina e Ingresit*, 1924, (*Le Violon d'Ingres*).

Në këtë fotografi torsi i një femre është transformuar në një violinë. Trupi i saj është rrethuar me disa shkallë hijesh. Ky imazh është një iluzion optik që e bën shikuesin të bjerë në dashuri me këtë foto. Trupi i kësaj femre i lyer me bojë shpalos fuqinë që Man Ray kishte mbi të. Është gjithashtu edhe një homazh ndaj idhullit të tij, piktorit francez Jean Auguste Dominique Ingres.

Modelja në këtë fotografi është Kiki de Montparnasse, me emrin e vërtetë Alice Prin, një këngëtare kabaresh në Montparnasse të Parisit. Man Ray kishte gjetur te Kiki më shumë sesa një dashnore që e adhuronte plotësisht, ai kishte gjetur një modele që e frymëzonte shumë, dhe ajo do shfaqej në shumë fotografi të artistit.

Por nga të gjitha imazhet e fotografuara të Kikit nuk ka asnjë më erotike dhe më të fuqishme sesa *Violina e Ingresit*, në të cilën shpina e saj e butë dhe e zhveshur adhurohet me dy shenja ‘f’ gropash violine. Kjo fotografi është bazuar mbi pikturën e Ingresit, *Baigneuse de Valpincon*, por aty figura kryesore shikon nga e djathta ndërsa Kiki i Man Ray shikon nga e majta. Man Ray e adhuronte Ingres, ndaj ai e shndërroi në violinë trupin e Kikit si homazh idhullit të tij. Ingresi i kishte



Man-Ray përballë portretit të Kiki de Montparnasse

bërë vizitorët në studion e tij të uleshin dhe të dëgjonin violinën e tij teksa ai luante në mënyrë skandaloze, dhe nuk i lejonte të shikonin pikturat e tij të cilat ishin kryevepra.

Ingres dhe Man Ray kishin shumë gjëra të përbashkëta në artin e tyre. Piktori i thurte lavdi konkubinave, femrave bukuroshe të haremit, ndërsa edhe fotografi gjente kënaqësi të njëjtë në konturet e trupit. Të dy pëlqenin shumëlloshmërinë. Të dy admironin stilin oriental si edhe aspektet vizuale të Mesjetës. Që të dy iu referuan shumë periudhave të artit për ikonografinë e tyre dhe që të dy u kritikuan për këtë arsye. Të dy patën një shkollim të paktë por s'e lejuan artin e tyre të vuante prej këtij fakti; dhe që të dy mbetën viktime të vlerësimeve të kritikëve se imazhet e tyre ishin tepër enigmatike.

*Violina e Ingresit* është më tepër sesa një foto e një shpine femre. Shtesa e një efekti tjetër mbi një gjë reale, në këtë rast 'f'-ja mbi trupin e femrës, e bën këtë foto një vepër klasike surrealistike. Është një homazh i drejtpërdrejtë, por edhe një shembull i shkëlqyer se si e shkuara e frymëzoi artistin të krijonte të tashmen, duke treguar si ai ishte një heretik pa e humbur besimin, një thyerës tradite por që s'e kishte harruar traditën.

*Violina e Ingresit* është më shumë sesa një fotografi. Ajo përfaqëson dashurinë e Man Ray për të dyja zhanret – fotografinë dhe pikturën. Në autobiografinë e tij, të titulluar "Autoportret" ai shkruan, "Unë fotografoja ashtu siç pikturoja, duke transformuar objektet siç i transformon një piktor, i idealizoj dhe i deformat fotografitë e mia aq lirshëm sikur po përdorja një penel dhe jo aparat fotografik."

Kjo foto është një lojë, me të gjitha kuptimet e kësaj fjale. Man Ray luante me fotografinë. Ai luante me titullin, sepse *Le Violon d'Ingres* është një idiomë për fjalën *hobi*, ose *argëtim*. Ai luante me figurën e gruas por pa e degraduar atë, ai e ktheu atë në një objekt kënaqësie,

një hobi, por duke ruajtur respektin për klasicizmin e formës femërore.

Thirrja e artit kumbon mbi veshin e ndërgjegjshëm dhe të pandërgjegjshëm të çdo artisti, duke fshirë vijën ndarëse

midis realitetit dhe ëndrrës, ndaj edhe Man Ray u shpreh se, "Për mua nuk ka asnjë dallim midis ëndrrës dhe realitetit. Unë asnjëherë s'e kuptoj nëse ajo që bëj bëhet kur jam duke ëndërruar apo



Kiki de Montparnasse

kur jam zgjuar." Ndaj, si përgjigje e kësaj thirrje të artit ai eksploroj shumë zhanre dhe u bë pjesëtar i disa rrymave artistike. Arti i tij shpaloset i errët sikurse ishin edhe veprat e shumë shkrimtarëve modernistë të asaj kohe; është i lirë dhe erotik sikurse shkrimet e Markez de Sade; është surreal si në ëndrra. Në veprat e tij ka poezi, ka dritë që sundon mbi errësirën ashtu siç shpresa triumfoi mbi trishtimin e asaj dekade lufte.

Përmes kësaj fotografie Man Ray përfaqëson shpirtin e modernizmit. Ai vetë jetoi si një njeri i lirë dhe bëri një art të ri i cili theu rregullat e traditës dhe reflektoi artistikisht mbi zhvillimin industrial. Por edhe pse arti i tij ishte i ri dhe unik, Man Ray ishte pjesë e një grupimi. Ky grupim artistësh, apo kjo rrymë artistike quhej Dadaizëm.


Man Ray e kishte mbartur Dadaizmin përpara se kjo lëvizje të pushtonte më vonë Nju Jorkun për pak kohë por fuqishëm. Ndër instalacionet e tij të para ishin pasqyra që s'pasqyronin, butona që s'punonin kur shtypeshin, të cilat i paraprinë një ideje të re të lirisë artistike që si përfundim u bë pjesë e Dadaizmit. Nuk kishte limite në fantazitë e tij. Kishte një liri të shfrenuar artistike. Në një foto të titulluar *Rrose selavy*, Man Ray fotografoi artistin Marcel Duchamp të veshur si femër dhe me paruke, për të paraqitur "egon tjetër" femërore të tij. Kjo ishte një shpikje tipike Dadaiste: nëse femrat do shijonin më shumë liri (mashkullore), përse të mos t'i përkulje gjinitë nga të dyja krahet? Nëse thua me zë të lartë në frëngjisht '*Rrose Selavy*', tingëllon si '*Eros! C'est la vie*', që do të thotë '*Dashuria! Kjo është jeta*.'

"Përse? E kush do t'ia dijë? E kush s'do t'ia dijë? Dada ka vdekur. Apo është akoma gjallë? Nuk mund të ngjallim diçka që është e gjallë ashtu siç nuk mund të ngjallim diçka që është e vdekur.

*A ka vdekur Dada?  
A është akoma gjallë?  
Dada është  
Dadaizëm"*

Pas (vdekjes së) Dadaizmit, Man Ray luajti një rol udhëheqës në rrymën Surrealiste. Temat e fotografive të tij surrealistike ishin të çuditshme, perverse, por tejet të fuqishme. Sigurisht, vendi ku ndodhnin këto gjëra ishte në ëndrra. Të frymëzuar nga zbulimi i Sigmund Freud mbi të pandërgjegjshmen, surrealistët u munduan të shndërrojnë gjërat e fshehta, si për shembull ëndrrat, dëshirat, fantazitë, vuajtjet dhe neurozat, në gjëra dhe eksperiencia të zakonshme. *Violina e Ingresit* ka mbetur në historinë e artit si imazhi më surrealist dhe dadaist, si edhe ngrirja në kohë e një figure të dybotshme në kalimin e saj nga realiteti në ëndërr, por edhe anasjelltas.

Në vitin 1999, revista *ARTnews* e titulloi Man Ray një ndër 25 artistët më me ndikim të shekullit të 20-të. Dhe çdo kritik arti e pranon se *Violina e Ingresit*, kjo fotografi me përmasa fizike vetëm 28.2 x 22.5 cm ka përmasa magjie dhe të një ëndrre të pafund. Puthja e reales me surrealen ndodh vetëm përmes artit, dhe rezultati i këtij bashkimi krijon vepra të tilla të ëndërrta të cilat jo vetëm bashkëbisedojnë me të pandërgjegjshmen tonë, por shpalosnin edhe një prej fytyrave të tjera të artit, atë të së pakapshmes nga receptorët fizikë, por vetëm nga ato mendorë e ndijorë.



ÇDO  
GJËSHITËE  
MUNDUR  
MARRIE  
FORLEO

“Ky libër do të ndryshojë jetë”. — ELIZABETH GILBERT, autore e *Big Magic*